



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



RAPORTI I PUNËS 2025



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

TABELA E PËRMBAJTJES:

- Fjala e Kryetarit të Komunës.....fq.3-5
- 01 Zyra e Kryetarit të Komunës.....fq.6-37
- 02 Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.....fq.38-51
- 03 Drejtoria e Financave.....fq.52-67
- 04 Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit.....fq.68-70
- 05 Drejtoria e Infrastrukturës.....fq.71-75
- 06 Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.....fq.76-84
- 07 Drejtoria e Arsimit.....fq.85-97
- 08 Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.....fq.98-107
- 09 Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.....fq.108-150
- 10 Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastritfq.151-160
- 11 Drejtoria e Bujqësisë.....fq.161-166
- 12 Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.....fq.167-177

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Viti 2025 për Ferizajn u shënua me suksese të shumta të qeverisjes lokale, me projekte të shumta zhvillimore, nisma komunitare me mbështetje institucionale në dobi të ferizajasve, punë e vepra madhore publike që vazhduan ritmin e pandalshëm të transformimit të Ferizajt, duke qenë tashmë Ferizaj, referencë e punës dhe suksesit në gjithë vendin. Të përmbledhura shkurtazi, paraqesim disa nga projektet më madhore që u realizuan gjatë vitit 2025 në Ferizaj, e të cilat ndikuan rrënjësisht në kahet e reja të zhvillimit të komunës sonë.

Në planin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike përruam nënkalimin më të madh në historinë e Kosovës – kryeveprën infrastrukturë – Nënkalimin tek Stacioni Policor në Ferizaj, përruam Stacionin e ri të Autobusëve – më modernin në gjithë Rajonin, për herë të parë lansuam në Ferizaj, Transportin Publik Urban. Ferizaj gjatë këtij viti u bë me Nënstacion të ri të energjisë elektrike, projekt i nisur më 2018 – bashkëfinancim prej 7 milionë euro, rikonstruktua në tërësi disa nga arteriet rrugore kryesore të qytetit, me gjithë infrastrukturën përcjellëse si rrugët: “Brigada 161”, “Besim Rexhepi”, “Bedri Asllani”, “Tahir Sinani”, kryqëzimi i rrugëve “Driton Islami” dhe “Cen Dugolli” etj. Nisëm punimet në rikonstruktimin tërësor të rrugës Ferizaj-Pleshinë, projekt në bashkëpunim me Ministrinë, arterie rrugore kjo 5 kilometërshe, tashmë është e gjitha e përfunduar rruga Pleshinë-Kashtanjevë me gjatësi 11.5 kilometër, mundësi kjo edhe për turizmin malor. Nisëm rikonstruktimin tërësor dhe zgjerimin e rrugës mbi 10 kilometërshe bashkë me infrastrukturën përcjellëse në fshatrat Babush i Ri, Prelez, Surqinë, Mirash e Cërnillë investim ky bashkë me Ministrinë, që shndërron tërësisht këtë zone, asfaltuam dhjetëra rrugë në gjithë fshatrat e Ferizajt si në: Surqinë, Gaçkë, Komogllavë, Dardani, Saraishtë, Kosinë, Zaskok, Pojatë, rruga kryesore në Zllatar në bashkëpunim me Ministrinë.

Në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor nisëm punën për hartimin e Planit të ri Zhvillimor Komunal – Kushtetutës së re Urbane, i shtuam ferizajasve dhjetëra hektarë hapësira të reja të gjelbërta me masivet e gjelbërta si me zgjerimin e Parkut “Liria” me hapësira rekreative-sportive, kënde lojërash, pajisje fitnesi, rregullim i amfiteatrit etj. Vijuam punimet në ndërtimin e Parkut në Kodrën e Sherretëve, në hapësirën e parkut në Grykën e Neredimes, po merr formë çdo ditë, shëtitorja e rivitalizuar, me shtigje të reja të ecjes, fushën sportive, verandat, urat në ndërtim mbi lumin Neredime, po vazhdojnë punimet për ndërtimin e dy parqeve në zonën qendër të qytetit: Parkut tek ish lokacioni i KRM “Pastërtia” dhe tek ish lokacioni i Stacionit të Autobusëve. Rregulluam parqe e hapësira të reja publike si në kurrizin e nënkalimit në sheshin “Ramadan Rexhepi”, në platonë e nënkalimit të ri, parku rrugën “Sali Çeku”, parku i ri në Slivovë, Greme, hapësira e rigjeneruar përkaj rrugën “Gursel e Bajram Sylejmani”, nisëm punimet për rregullimin e parkut në Varosh, furnizuam Ndërmarrjen “Ambienti” me makineri e pajisje të reja që rrisin cilësinë e mirëmbajtjes së hapësirave publike. U shpallëm komunë kampione në Fletë notimin Mjedisor të Komunave, vlerësim ky për përmbushjen e premtimeve nga platforma qeverisëse për projektet e gjelbërta, vijuam me punën për pastrimin e shtretërve të lumenjve dhe hapjen e kanaleve kulluese ujore pranë tokave bujqësore.

Në planin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale përruam qendrën më moderne shëndetësore në Rajon, Qendrën e Mjekësisë Familjare nr. 2, bashkëfinancim me organizatën “Qatar Charity”. Në Qendrën Shëndetësore nr.2 lansuam shërbimet e plota për pacientët si: Emergjencia / 24 orë, Stomatologji / 24 orë, Barnatore doracake / 24 orë, Kujdes palativ/12 orë, Laboratorë/12 orë. Po vijojmë punimet në ndërtimin e objektin e ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. Në fshatin Koshare, po vijojmë punimet për ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Shëndetësore. Bashkëpunuam me organizata të ndryshme për donacione të shumta me pajisje shëndetësore, në blerje të aparaturave më moderne shëndetësore në shërbim të pacientëve, mbështetëm hapjen e qendrës unike të pensionisteve “Zonjat Pensioniste”.

Në fushën e bujqësisë, me mbi 10 milionë euro investime, mbështetëm qindra bujq e fermerë dhe realizuam projekte të shumta të rëndësisë kapitale si: Përruam Tregun e ri e modern të kafshëve – një projekt unik me gjithë infrastrukturën përcjellëse për këtë qëllim, përruam për herë të parë në Ferizaj, e dyta në nivel vendi – Strehimoren për Qentë Endacak, vijuam me punët e angazhimet për rregullimet në projektin e ndërtimit të siloseve dhe për rregullimin e hipodromit në mes fshatrave Prelez i Muhaxherëve dhe Papaz një projekte këto unike. Mbështetëm përmes skemave të subvencioneve të Drejtorisë së Bujqësisë, bujqit e fermerët ferizajas si: 140 bujq përfitues të pajisjeve bujqësore, shpërndamë makineri e pajisje bujqësore për 281 bujq e fermerë, mbështetëm bletarët me 260 koshere me bletë ushqyese dhe 20 pajisje e sistem mbrojtës nga kafshët e egra për bletishte, 86 bletarët ferizajas përfituan 1300 bazamente plastike për koshere të bletëve dhe 13 pajisje speciale për shkrirjen e dyllit, 55 pemëtarë ferizajas i furnizuam me pajisje profesionale mulqerues për traktorë dhe spërkatëse - shpërndarëse profesionale, 29 bujq ferizajas përfituan sistem të ujitjes përbërë nga tubat, pompa zhytëse dhe pompa profesionale, 8 fermerë ferizajas u mbështetën me sistem të ujitjes pikë-pikë, foli të zezë dhe rezervuarë të ujit, 5 shpezëtarë përfituan makina për vulosjen e vezëve.

Në planin arsimor për të 5-tin vit me radhë, ndamë bursa për të gjithë studentët aplikues. Vetëm gjatë vitit 2025 përfituan bursë komunale 1500 studentë ferizajas, rreth 2 milionë euro mbështetje për studentët gjatë gjithë qeverisjes. Gjithashtu, përruam objektin e ri shkollor për dy shkolla të mesme – Gjimnazin “Dr. Shaban Hashani” dhe Shkollën e Mesme të Mjekësisë “Elena Gjika”, përruam objektin e ri shkollor në Talinoc të Muhaxherëve – bashkëfinancim me Ministrinë, vijuam punimet në ndërtimin e objekteve të reja shkollore si në shkollën në Neredime, në Tërrn, në shkollën në rrugën “Sali Çeku”, funksionalizuam kopshtin për fëmijë në fshatin Greme, nisi ndërtimi i kopshtit për fëmijë në fshatin Dardani, rregulluam oborret dhe hapësirat shkollore në shkollat si: “Arsim Rexhepi” në Sazli, “Abetarja” në Softaj, “Vezir Jashari” në Ferizaj, oborri i shkollës në Papaz, oborri dhe fushat sportive në Fshatin e Vjetër.

Në fushën e investimeve për zhvillimin ekonomik dhe turizmin mbështetëm qindra biznese të udhëhequra nga gratë e vajzat për grantet e vitit 2025 nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, përruam atraksionin turistik “Via Ferrata” dhe urën tibetiane në vargmalet e jashtëzakonshme të Jezercit.

Në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit tashmë është nënshkruar kontrata për ndërtimin e Stadiumit të Ri Futbollistik “Ismet Shabani” në Ferizaj, me vlerë prej 17 milionë eurove dhe kapacitet prej 8,415 ulëseve – bashkëfinancim me MKRS, rikonstruam tribunat në Stadiumin e Qytetit, rregulluam tribunat në fushën e futbollit në Prelez të Muhaxherëve, rregulluam fusha të reja sportive si në: Doganaj, Sojevë, Mirash, Surqinë etj, klubet ferizajase të sportit gjatë vitit 2025 i sollën Ferizajt trofe të shumtë kampionësh, suksese këto kulminante sportive, pa lënë anash edhe aktivitetet e shumta tradicionale kulturore si Festivalet tradicionale, aktivitete të ndryshme rinore që begatuan jetën kulturore, artistike të Ferizajt gjatë vitit 2025.

Gjatë vitit 2025, gjithashtu u shpallëm Kampion i Kosovës për Transparencë Komunale për vitin 2024, vlerësim nga Instituti Demokratik i Kosovës si dhe Ferizaj u rangua Komunë Kampione e para nga komunat e mëdha me shkallën 100% të realizimit të buxhetit për investime kapitale në vitin 2024 - Instituti GAP

Nga sa më sipër, të përmbledhura shkurtazi, Ferizaj edhe në vitin 2025, pati investime e punë të palodhshme, vizion e vullnet që karakterizon përkushtimin tonë të përditshme për Ferizajn siç e meritojnë ferizajasit.

Ju faleminderit!

Me respekt,
Agim Aliu
Kryetar i Komunës së Ferizaj



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA LIGJORE

RAPORT I PUNËS PËR VITIN 2025

Për periudhën kohore 03.01.2025 e deri me 31.12.2025, Zyra Ligjore ka kryer punët si në vijim:

1. Pranë Zyrës Ligjore, janë pranuar dhe evidentuar si kërkesa nëpërmjet zyrës pritëse 1257 lëndë të qytetarëve të cilat kanë qenë kërkesa të natyrës së ndryshme, të cilat në bazë të kompetencës janë shqyrtuar apo bartur për shqyrtim në drejtoritë përkatëse.
2. Janë paraqitur gjithsej 842 padi në çështjet kontestimore ku Komuna e Ferizajt ka qenë e paditur.
3. Janë ushtruar 842 përgjigje në padi, në gjykatat kompetente.
4. Janë mbajtur gjithsej 625 seanca në çështje kontestimore, penale dhe administrative pranë gjykatave kompetente.
5. Janë ushtruar 106 ankesa kundër aktvendimeve dhe aktgjykimeve në gjykatat kompetente.
6. Janë ushtruar 121 prapësime të cilat janë ende në procedurë.
7. Janë përgatitur gjithsej 87 shkresa të ndryshme (vendime, autorizime, njoftime etj. që kanë rrjedhur nga Kabineti i Kryetarit).



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E PROKURIMIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

RAPORTI VJETOR PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE

Konform nenit 87.2.12 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së raportit: 23.1.2026.

Viti fiskal: 2025

PJESA I . IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES			
Emri zyrtar i Autoritetit Kontraktues	KOMUNA FERIZAJ		
Lloji i Autoritetit Kontraktues	Qeveritar	Kompani Publike	Tjetër
Kodi buxhetor	656		
Adresa	DESHMORET E KOMBIT		
Kodi postar - Qyteti	70000		
Tel. fiks/ Celulari /Faksi	3820046045		
Emri i menaxherit të prokurimit	Arbene Bekteshi		
E-mail adresa	prokurimi.ferizaj@rks-gov.net		
Adresa e webit të AK	https://ferizaj.rks-gov.net/		

[illegible]

[illegible]

[illegible]

606-35-2462-1-1	8	1	1	45	Nedretni i smodeni filare ne lan Terni-Fala i)	31.07.2025	28.3.2025	29.6.2025	17.6.2025	18.08.2028	Ne realizim	794,097.58	791,142.72				Grup i Operatore Euronext TALA ENGINEERING G S.H.P.K. Xromatir Sestis B.I.; VALI INVEST S.H.P.K.	1				1
606-35-2462-2-1	8	2	1	45	Auditorii i rapeti ne intatin Rakaj,	27.07.2025	27.3.2025	30.6.2025	19.6.2025	18.08.2028	Ne realizim	300,000.00	304,840.00				Ravica Conferia S.H.P.K.	1				1
606-35-6682-2-7	2	4	7	34	Riviste-Autotini fruar per v. 2024 (NPL Stacioni autobusive Sh.A. Fierija)	24.6.2025	-	4.7.2025	27.6.2025	26.07.2025	Ne realizim	700.00	700.00				ECD & COMO S.H.P.K.	1				1
606-35-6082-5-4	1	-	8	02	Furtoiri me perit dhe perme per recidivat ne Shkollja e Komunitetit per personat me Mites te Kufizues Mendore ne Fierija; per personat per o ruajt;	2.5.2024	07.07.2025	21.8.2025	13.8.2025	12.02.2028	Ne realizim	1,300.00	1,494.00			44	BURIM CORPORATIO n SH.P.K.	1				1
606-35-5082-1-7	1	4	7	38	Punetori me shtet per kuzhinat e p. Adreftia per Fierija;	4.7.2025	-	8.7.2025	7.7.2025	12.09.2025	12.09.2025	437.00	437.00				AMAZON HOLDING SH.P.K.	1				1
606-35-6124-2-7	2	4	7	03	Regjistrimi i autobusit bashk Opel 26 QDMF / Fierija	8.7.2025	-	11.7.2025	8.7.2025	19.07.2025	19.07.2025	500.00	418.00				KOMPANIA E SIGURIMEVE PMSIG - SH.A.	1				1
606-35-6823-3-4	2	3	0	03	Shtepitortit Monocordal dhe tjeter per recidivat ne Shkolle e Komunitetit ne Fierija;	30.04.2025	4.8.2025	17.7.2025	2.7.2025	01.08.2025	01.08.2025	5,000.00	4,445.00				Drap i Operatore Ekonomik MAM-Pall Group SH.P.K. HOTEL KROJET SH.P.K.	1				1
606-35-2682-5-2-1	5	2	1	45	Martiri i pamuritit ne lozacione te tjera ne ndemarrja Pogradec.	04.07.2025	2.4.2025	17.7.2025	7.7.2025	06.07.2028	Ne realizim	170,000.00	169,999.47				Drap i Operatore Ekonomik Eco Holding Group SH.P.K. EUROLINDI SH.P.K. ARLADI SHPK BESEA COMPANY SH.P.K.	1				1
606-35-4812-3-4	2	3	8	03	Tendertori me aukcion (interanca dhe jalla vendit) i paritetit te Adreftia Komunitetit, shkollja dhe institucione tjera ne Korunen e Fierija;	19.05.2025	2.8.2025	18.7.2025	8.7.2025	08.07.2028	08.07.2028	9,800.00	9,700.00				* ARDITI TOJAS - SH.P.K.	1				1

686-25-7185-1-1	2	1	1	00	8.8.2025	7.8.2025	4.9.2025	29.8.2025	30.08.2025	Net realizat	2,500,000.00	3,300.10			Grup 1 Operativ Economic ELEKTRO VUL SH P.K.; BEGA COMPANY SH P.K.	1	36	1	2	1
886-25-7185-1-2-1	2	2	1	83	30.6.2025	29.6.2025	17.10.2025	15.10.2025	14.10.2025	Net realizat	70,000.00	8,832.93			Terras Solar Engineering SH P.K.	1			1	1
886-25-6781-1-2-1	1	2	1	14	8.5.2025	29.7.2025	9.8.2025	3.9.2025	02.09.2025	Net realizat	120,000.00	114,879.89			MT, Pindia Contract	1			1	1
886-25-3827-1-1-1	2	1	1	90	8.1.2025	8.5.2025	9.9.2025	5.9.2025	03.09.2025	Net realizat	150,000.00	77.79			KROSA Traffic Signs SH P.K.	1			1	1
886-25-7901-1-3-4	1	2	0	24	21.06.2025	29.8.2025	24.9.2025	18.9.2025	17.09.2025	Net realizat	2,000.00	2,881.35			MESSER MEDICA L.L.C.	1			1	1
886-25-8043-1-3-4	1	2	0	56	04.06.2025	3.9.2025	24.8.2025	19.8.2025	18.08.2025	Net realizat	5,000.00	4,170.00			"LUJBITA LABIA" SH P.K.	1			1	1
886-25-7091-1-2-1	5	2	1	45	20.06.2025	5.9.2025	19.9.2025	17.9.2025	16.09.2025	Net realizat	360,000.00	399,796.93			Bentia Cansary SH A.	1			1	1
886-25-7265-1-3	5	2	5	45	22.05.2025	1	29.9.2025	24.9.2025	14.10.2025	Net realizat	91,750.00	91,750.00			Unia	1			1	1
886-25-6405-1-1-1	1	1	1	07	31.08.2025	19.7.2025	24.12.2025	12.12.2025	11.12.2025	Net realizat	300,000.00	349,755.79			Grup 1 Operativ Economic M.P. Uleri Com. A.T.S.A. NADZ TRAVEL	1			1	1
886-25-8305-1-3-4	1	-	0	00	3.5.2024	1	13.10.2025	3.10.2025	01.10.2025	Net realizat	4,476.00	4,938.50			Dadi Koroni SH P.K.	1	44		1	1
886-25-8311-1-3-4	2	2	0	00	01.05.2025	11.9.2025	29.9.2025	24.9.2025	23.09.2025	Net realizat	6,992.00	8,991.00			Baqant Sakelli B.I.	1			1	1
886-25-8326-1-2-1	2	2	1	60	01.06.2025	11.9.2025	20.10.2025	16.10.2025	14.07.2025	Net realizat	11,000.00	10,840.00			Avant Usmajli B.I.	1			1	1
886-25-7185-1-3-1	2	2	1	01	24.01.2025	7.9.2025	3.10.2025	18.9.2025	17.09.2025	Net realizat	10,000.00	69,795.00			Grup 1 Operativ Economic Cano Pe SH P.K.; A.C.E.S. RET HOME SH P.K.	1			1	1

056-25-9853-3-4	2	3	0	60	Plandem Neurologiser per soccietat re Shqipërie e Komunitet per persona me diferenca mendore ne Fier (Cm)	14.10.2025	29.10.2025	27.11.2025	17.11.2025	18.11.2025	Ne realizem	6,000.00	5,940.00				1	2
056-25-10251-2-2 1	2	2	1	60	Bartja e mësuesve nga Marrësi i Ri deri te shkolla Ari Izatit dhe anëtarët	30.08.2025	11.11.2025	18.12.2025	11.12.2025	10.09.2026	Ne realizem	22,500.00	22,500.00				1	2
056-25-10251-2-3 6	2	3	0	60	Bartja e mësuesve nga 1948 Peshkë e Urd deri te shkolle dhe anëtarët	7.10.2025	13.11.2025	8.12.2025	27.11.2025	26.08.2026	Ne realizem	4,550.00	4,550.00				1	
056-25-10485-2-3 6	2	3	0	60	Marrësi i Bartja e mësuesve te Luma Dajem Curi Izatit Gajet deri te shkolle dhe anëtarët	3.11.2025	18.11.2025	8.12.2025	3.10.2025	02.07.2026	Ne realizem	8,000.00	7,960.00				1	1
056-25-10485-2-4 7	1	4	7	25	Fuzioni me njeur për helikopter për aeropaj te QRM-46 Fier (Cm)	6.11.2025	/	25.11.2025	21.11.2025	24.11.2025	Ne realizem	990.00	990.00				1	1
056-25-10701-2-2 1	2	2	1	60	Fuzioni me ane doqat (pesh) per njeur e instruksioneve aneore dhe instruksione (fira de kurisore ne kuadër te Komunes se Fier (Cm)	03.10.2025	25.11.2025	19.12.2025	12.12.2025	11.12.2027	Ne realizem	25,000.00	17,796.90				1	2
056-25-11362-2-2 5	2	2	3	60	Peshkë dhe mësuesia logjistikë e objektit te Komunitet se Fier (Cm) dhe instruksione (fira de kurisore ne kuadër te Komunitet se Fier (Cm)	15.12.2025	/	30.12.2025	28.12.2025	25.02.2026	Ne realizem	71,571.48	71,571.48				1	1
056-25-11362-2-2 5	2	2	3	60	Sigurimi i kushtetive dhe Komunitet dhe objektit fira de kurisore ne kuadër te Komunitet se Fier (Cm)	15.12.2025	/	30.12.2025	28.12.2025	25.02.2026	Ne realizem	102,075.50	102,075.50				1	1



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA E PERSONELIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

Në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore – NJMBNJ (administrata komunale), gjatë periudhës 1 vjeçare Janar – Dhjetor 2025 janë kryer këto punë dhe detyra:

- NJMBNJ ka realizuar përmbushjen e detyrave gjatë këtij viti dhe ka ofruar mbështetjen dhe konsultat e panumërta, për të punësuarit në administratën komunale;
- Është përkushtuar dhe angazhuar vazhdimisht rreth mbikëqyrjes dhe zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil – publik në institucionet e administratës komunale;
- Gjatë muajit janar 2025, Zyra e Personelit është marrë me procesin e vlerësimit të të punësuarve;
- NJMBNJ gjatë vitit 2025 në vazhdimësi ka mbajtur kontaktet me departamentin për menaxhimin e zyrtarëve publik si dhe është marrë me kërkesat e ndryshme të të punësuarve, bazuar në ligjet në fuqi;
- Janë përgatitur përgjigje për zyrtarët e punësuar rreth kërkesave të adresuara në NJMBNJ;
- Janë mbajtur kontaktet me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, ku janë përgatitur dhe përcjellë materialet e kërkuara nga KPMSHCK-së, konform kërkesave të adresuara (të gjitha brenda afateve ligjore);
- Me kërkesa të ish të punësuarve janë fotokopjuar dokumente të ndryshme nga dosjet pasive të zyrtarëve që nuk janë më në marrëdhënie pune;
- Janë lëshuar vërtetime siç janë përvoja e punës, referenca etj.

- Në Sistem janë miratuar apo refuzuar kërkesat e pushimit për shërbyesit civil;
- 12 punëtorë janë pensionuar gjatë vitit 2025, 2 dorëheqje dhe të njëjtëve iu është lëshuar vendimi;
- Gjatë vitit 2025 është përgatitur 1 vendim për pushim të lehonisë;
- Janë plotësuar formularët si më poshtë:
 - Plani vjetor për trajnime;
 - Regjistri i shërbyesve civil të cilët pensionohen në vitin 2025;
 - Plani i Personelit për vitin 2025 (përmes SIMBNJ);
 - Janë ndjekur trajnime rreth legjislacionit për shërbyesit civil dhe publik si dhe rreth përdorimit të SIMBNJ (versionit të ri të sistemit për menaxhimin e burimeve njerëzore) dhe sistemit të ri të pagave në sistem elektronik;
- Për çdo muaj janë plotësuar formular të ndryshëm për pagat si:
 - Formularët për punonjësit e ri,
 - Formularët e Largimeve,
 - Formularë të ndryshimeve si: ndryshimi i përvojës së punës, ndryshimet për lehonat, ndalesa në pagë, transfere bankare, etj.
 - Formularët retroaktiv për shtesa si dhe
 - Regjistrat Elektronik për Pagesat e Anëtarëve të Asamblesë Komunale, Pagesa e Kujdestarisë për Qendrën Rezidenciale si dhe Kujdestaritë për Zjarrfikësit.

Të gjitha këto dokumente të plotësuara dhe të skanuara janë dërguar në formë elektronike në MEF.

- Janë skanuar dhe janë vendosur në dosje dokumente shtesë të punëtorëve që kanë sjellë në NJMBNJ, janë bërë në përputhje me rregulloren për dosje;
- Janë nxjerrë vërtetime të ndryshme sipas kërkesave të të punësuarve;
- Janë përgatitur vendime për përvojën e punës për punëtorët që kanë sjellë dëshmi shtesë të përvojës;
- Janë nxjerrë nga sistemi regjistrat e pagave për punëtorët e administratës komunale, punëtorët e arsimit dhe shëndetësisë për vitin 2025 (për çdo muaj);
- Janë zhvilluar 17 procedura të jashtme të rekrutimit, të gjitha përmes SIMBNJ;
- Janë publikuar në SIMBNJ konkurset e Drejtorisë së Arsimit dhe të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;
- Për të gjithë këto rekrutime janë krijuar dosjet e punonjësve të rinj.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E KOMUNIKIMIT ME PUBLIKUN DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

SEKTORI PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN

Sektori për Komunikim me Publikun dhe Teknologji Informative, i cili funksionon në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Ferizajt, gjatë vitit 2025 ka shënuar suksese domethënëse në fushën e informimit publik dhe të teknologjisë informative, në shërbim të aktiviteteve të Komunës së Ferizajt.

Gjatë këtij viti, ky sektor ka arritur të siguroj shpërndarjen e rregullt, të saktë dhe në kohë të informacioneve që lidhen me aktivitetet e Kuvendit të Komunës, Zyrës së Kryetarit të Komunës, dhe të drejtorive komunale. Pasqyrimi i drejtë dhe i paanshëm i ngjarjeve që zhvillohen për dhe nga Komuna e Ferizajt është përmbushur si mision themelor i Sektorit për Komunikim me Publikun dhe Teknologji Informative, përmes përcjelljes dhe publikimit të plotë të veprimtarisë së organeve të administratës komunale, pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ.

Sfida kryesore gjatë vitit që lamë pas ka qenë bartja e dokumentacionit nga ueb faqja e vjetër në ueb faqen e re të Komunës, proces i cili është shoqëruar me mungesë të theksuar të dokumenteve të fshira nga ueb faqja e mëparshme. Pavarësisht këtyre vështirësive, Zyra ka arritur të publikoj dhe ri publikoj qindra dokumente me rëndësi të veçantë për qytetarët në ueb faqen e re zyrtare.

Në planin e dokumenteve strategjike, janë përmbushur të gjitha obligimet dhe kërkesat e nivelit qendror, përkatësisht të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), sa i përket miratimit të dokumenteve që kanë për synim rritjen e transparencës komunale.

Gjatë vitit 2025, nga qytetarë, biznese, medime e institucione të tjera janë parashtruar 109 kërkesa për qasje në dokumente publike, prej të cilave 106 janë aprovuar nga Zyrtari për Qasje në Dokumente Publike gjersa 3 prej kërkesave janë refuzuar konform dispozitave ligjore të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Në vitin 2025, Sektori për Komunikim me Publikun ka qenë gjithashtu përgjegjës për procesin e Zvogëlimit të Barrës Administrative. Gjatë këtij viti janë funksionalizuar 30 shërbime komunale

online për qytetarët, me qëllim lehtësimin e qasjes në shërbime dhe shmangien e pritjeve të gjata në sektorë të ndryshëm të Komunës së Ferizajt.

Shërbimet e bëra online janë:

- Ndërrimi i emrit personal
- Ndërrimi i emrit personal për rastet e rikthimit të mbiemrit të vajzërisë/djalërisë pas shkurorëzimit
- Korrigjimi i emrit personal
- Pëlqim për gjurmim/dëmtim të rrugëve dhe sipërfaqeve të gjelbërta
- Taksa për gjurmim/dëmtim të rrugëve me asfalt
- Leje për taksit individuale
- Vazhdimi i lejes për taksit (pagesë vjetore)
- Vërtetimi dhe vazhdimi i rrethave të udhëtimit në transportin urban dhe urbano-periferik
- Leje për hyrje në shesh (vetëm për biznese)
- Regjistrimi i pronësisë në bazë të titullit juridik të organeve administrative dhe gjyqësore
- Regjistrimi i pronësisë në bazë të transaksioneve
- Regjistrimi i pronësisë në bazë të ndërrimit/këmbimit të pronës së paluajtshme
- Përcaktimi i kufijve të parcelave
- Bashkimi i parcelave
- Regjistrimi dhe modifikimi i servitutit
- Fshirja e servitutit
- Regjistrimi i së drejtës së shfrytëzimit – qira mbajtjes
- Identifikimi i parcelave
- Korrigjimi i të dhënave kadastrale
- Lëshimi i të dhënave kadastrale në formë digjitale
- Regjistrimi i pronësisë në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përhjetshme
- Regjistrimi i bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët
- Ndërrimi i kulturave të parcelave
- Historiku për njësinë kadastrale
- Kopja e planit
- Certifikata e pronësisë

- Vërtetim që personi nuk është nën kujdestari (për punësim dhe aplikim në Odën e Avokatëve)
- Vërtetim që personi nuk merr ndihmë sociale
- Aplikimi për ndarjen e subvencioneve për Kulturë, Rini dhe Sport
- Leje mjedisore

Gjatë vitit 2025, Zyra ka organizuar konsultime publike, takime publike, dëgjime buxhetore dhe takime buxhetore me pjesëmarrje aktive të qytetarëve.

Janë mbajtur konsultimet publike si në vijim:

- Konsultim publik për Draft-Rregulloren për Transparencë të Komunës së Ferizajt dhe Draft-Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2025–2028
- Konsultim publik për Draft-Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) dhe Draft-Planin Ndër komunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Regjionin e Gjilanit dhe Ferizajt
- Konsultim publik për Projekt-Rregulloren për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksi
- Konsultim publik për Projekt-Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024–2026

Gjatë vitit 2025 janë mbajtur gjithsej 9 dëgjime publike për përgatitjen e buxhetit të Komunës për vitin 2025, të zhvilluara në sallën e Kuvendit të Komunës, me grupe të ndryshme të interesit, si dhe 3 takime buxhetore shtesë në Komunën e Ferizajt. Janë organizuar gjithashtu dy takime publike me qytetarë, ku Kryetari i Komunës së Ferizajt, z. Agim Aliu, ka raportuar për punën gjashtëmujore dhe njëvjeçare të Komunës, si dhe ka prezantuar Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025–2027. Po ashtu, është mbajtur edhe një takim publik me qytetarë lidhur me zonën turistike në fshatin Varosh.

Të gjitha dokumentet dhe materialet relevante, përfshirë mbledhjet e Kuvendit, procesverbalet, vendimet, marrëveshjet institucionale, raportet financiare, shpenzimet buxhetore, planet, konkurset, njoftimet, ankandet publike, listat e përfituesve të subvencioneve dhe projektet e realizuara apo në planifikim, janë të qasshme për publikun në ueb faqen zyrtare të Komunës së Ferizajt. Në kuadër të sektorit funksionojnë edhe përkthyesit e gjuhës serbe dhe angleze. Gjatë vitit 2025 janë përkthyer gjithsej 2052 faqe në gjuhën serbe dhe 216 faqe në gjuhën angleze, duke përfshirë dokumente strategjike, ligjore, financiare dhe administrative.

Synimet për vitin 2026 përfshijnë krijimin e lehtësirave të reja teknologjike për qasje më të shpejtë në informacione, rritjen e dukshmërisë së ueb faqes zyrtare, forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe përdorimin e zgjeruar të kanaleve alternative të komunikimit me qytetarët.

Zyra e Teknologjisë së Informacionit

Gjatë vitit 2025, zyrtarët e Teknologjisë së Informacionit (IT) kanë qenë përgjegjës për administrimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së IT-së për mbi 300 përdorues dhe pajisje në objekte të ndryshme komunale. Është ofruar mbështetje teknike ditore për stafin komunal dhe është realizuar me sukses mirëmbajtja dhe përditësimi i pajisjeve. Kjo zyrë ka kryer mirëmbajtje të vazhdueshme të infrastrukturës së rrjetit dhe lidhjeve ndërmjet objekteve, pajisjeve të rrjetit dhe kompjuterëve gjithashtu sistemeve operative dhe aplikacioneve zyrtare. Është ofruar mbështetje teknik ditore për stafin komunal, përfshirë instalime, konfigurime dhe zgjidhje të problemeve teknike në terren dhe në distancë.

Kalimi në Windows 11

Gjatë vitit 2025 është realizuar përgatitja dhe azhurnimi i pajisjeve nga Windows 10 në Windows 11, si masë parapërgatitore për përfundimin e mbështetjes së Windows 10 në tetor 2025. Procesi është realizuar me sukses, duke siguruar stabilitet, siguri dhe vazhdimësi në punën e përdoruesve.

Administrimi i sistemeve dhe llogarive

Zyra e IT-së administron Active Directory, ku gjatë vitit janë hapur dhe menaxhuar llogari për shfrytëzues të rinj, përfshirë qasje në: E-mail zyrtar, Intranet, Aplikacionin e personelit SIMBNJ dhe sisteme të tjera institucionale. Gjithashtu është kryer menaxhimi i privilegjeve dhe qasjeve sipas nevojave të punës.

Siguria kibernetike

Gjatë vitit 2025 është punuar intensivisht në rritjen e sigurisë kibernetike, duke zbatuar ndryshime të shumta të udhëzuara nga ASHI. Këto ndryshime kanë ndikuar drejtpërdrejt tek përdoruesit, ku për secilin rast është intervenuar individualisht për konfigurim dhe përshtatje.

Transmetimi i seancave dhe ueb faqja

Zyra jonë gjatë këtij viti ka realizuar transmetimin live në YouTube të të gjitha Seancave të Kuvendit Komunal të cilat janë publikuar në ueb faqe dhe Facebook.

Po ashtu është administruar ueb faqja e Komunës së Ferizajt, ku janë rregulluar dhe përditësuar linqe, përmbajtje dhe funksionalitete të ndryshme, sipas kërkesave të Zyrës së Informimit. Pavarësisht kapaciteteve të kufizuara njerëzore, Zyra e IT-së ka siguruar funksionim të qëndrueshëm të sistemeve teknologjike dhe mbështetje të vazhdueshme për proceset administrative dhe transparencën institucionale të Komunës së Ferizajt.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

INSPEKTORATI I KOMUNËS

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

Gjatë kësaj periudhe të vitit 2025-të, Sektori për Inspektime në Komunën e Ferizajt, ka zhvilluar procesin e punës sipas objektivave dhe planit të punës të parashikuar për periudhën një vjeçare, ku ka kryer një varg inspektimesh: të planifikuara, të paplanifikuara, ri-inspektime, me parashtresë dhe të përbashkëta, në territorin e Komunës së Ferizajt. Të gjitha këto veprime Sektori për Inspektime në Komunën e Ferizajt i ndërmori duke u bazuar në Ligjin Nr.08/L-067 për Inspektimet dhe Ligjet dhe Rregulloret e tjera përkatëse në fuqi.

Sektori për Inspektime përbëhet nga këto njësi:

- Inspektorati komunal i Ndërtimit
- Inspektorati komunal i Tregut
- Inspektorati komunal i Mbrojtjes së Mjedisit
- Inspektorati komunal i Komunikacionit
- Inspektorati komunal i Shërbimeve Publike

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Në realizimin e objektivave të inspektimit në Sektorin për Inspektime, janë kryer këto aktivitete:

- Organizimi dhe planifikimi i punëve të brendshme të sektorit;
- Shqyrtimi i ankesave, kërkesave;
- Inspektimi i subjekteve afariste dhe pajisja e tyre me pëlqim të kushteve minimale teknike;
- Luftimi i informalitetit;
- Mbrojtja e Konsumatorit;
- Siguria e produkteve në treg;
- Inspektimi i subjekteve të ndryshme për leje mjedisore;
- Identifikimi i deponive ilegale;
- Monitorimi i hapësirave publike për hedhjen e mbeturinave dhe ndotjeve të ndryshme;
- Monitorimi i rrugëve të qytetit;
- Monitorimi dhe largimi i shitësve ambulantë nga bulevardi i qytetit;

- Lirimi i hapësirave publike në vend punishte;
- Inspektimi dhe monitorimi i shitësve ambulant;
- Monitorimi dhe kontrollimi i objekteve me ose pa leje;
- Kontrollimi dhe monitorimi i objekteve me leje ndërtimore deri në pajisjen me certifikatën e përdorimit;
- Lirimi i trotuareve nga pengesat e ndryshme, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Kompaninë “Pastërtia”;
- Monitorimi i operatorëve të transportit në kryerjen e shërbimit pa leje pune;
- Kontrollimi dhe monitorimi i parkingjeve publike dhe private;
- Aksione me Policinë e Kosovës – Njësi Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore;

Inspektorati Komunal i Tregut

1. Numri i ankesave, kërkesave (parashtresa) 131

Nga to disa kanë qenë nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit, disa nga qytetarët në adresë të inspektoratit të tregut të Komunës së Ferizajt, kërkesa për pranime teknike të lokaleve, kërkesa për zgjatje të orarit të punës.

2. Numri i inspektimeve të kryera: 301

3. Numri masave korrigjuese të lëshuara: 65

4. Numri i shkeljeve serioze: 2

5. Numri i shkeljeve të lehta: 11 gjoba

Inspektorati Komunal i Ndërtimit:

1. Numri i ankesave (parashtresave) të pranuar: 1267

Gjithsej janë pranuar 1267 parashtresa, ku 1256 janë kërkesa, 14 ankesa. Nga 1267 kërkesa në total, 1203 janë kërkesa për inspektimin e fazave të ndërtimit sipas udhëzimit administrativ të MMPH-së Nr.05/2017, 28 për dalje në vendin e ngjarjes, ndërsa 42 ankesa janë për daljen në vendin e ngjarjes, konstatimin e gjendjes faktike.

2. Numri i inspektimeve të kryera: 167

3. Numri i masave korrigjuese të lëshuara: 52

4. Numri i shkeljeve serioze: 26

5. Numri i shkeljeve të lehta: 34 gjoba

6. Numri i masave urgjente të ndërmarra nga inspektorët: 50 (26-të janë vendime për ndërprerje të punimeve. 10-të janë vendosja e shiritave dhe shenja zyrtare për mbyllje të punishteve, 11 kallëzime penale, dhe 1 kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse).

Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit

- 1. Numri i parashtresave të pranuar (ankesa, kërkesa): 48**
- 2. Numri i inspektimeve të kryera: 313**
- 3. Numri i masave korrigjuese të lëshuara: 62** (për evitim të ndotjeve mjedisore).
- 4. Numri i shkeljeve të lehta: 24 gjoba**

Inspektorati Komunal i Shërbimeve Publike

- 1. Numri i ankesave (parashtresave) të pranuar: 64**
- 2. Numri i inspektimeve të kryera: 239**
- 3. Numri i shkeljeve serioze: 4** (2 vendime për ndërprerje të punimeve, dhe 2 kallëzime penale)
- 4. Numri i shkeljeve të lehta: 18** (gjoba)

Inspektorati Komunal i Komunikacionit

- 1. Numri i ankesave (parashtresave) të pranuar: 30**
- 2. Numri i inspektimeve të kryera: 174**
- 3. Numri i masave korrigjuese të lëshuara: 13**
- 4. Numri i shkeljeve të lehta: 29 gjoba**

Raporti i përgjithshëm i Sektorit për Inspektime

Gjatë vitit 2025 në Sektorin për Inspektime në Komunën e Ferizajt kanë punuar gjithsej njëmbëdhjetë (11) inspektorë duke përfshirë këtu edhe Udhëheqësin e Sektorit për Inspektime, ku janë kryer një mori inspektimesh ashtu siç parashihet me ligjet përkatëse dhe duke zbatuar Ligjin Nr.08/L-067 Për Inspektime. Të poshtëshënuar po paraqesim raportin e përgjithshëm të Sektorit për Inspektime në Komunën e Ferizajt.

- 1. Numri ankesave të pranuar gjithsej:1540**
- 2. Numri i inspektimeve të kryera:1194**
- 3. Numri i shkeljeve të lehta (gjoba mandatore): 116**



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

Raporti i punës është përgatitur nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, i cili përmbledh punët dhe shërbimet e auditimit të brendshëm të kryera gjatë vitit kalendarik 2025.

Raporti pasqyron punën e kryer dhe rezultatet e arritura, krahasuar me objektivat dhe detyrimet e planifikuara vjetore të vitit 2025. Auditimet e brendshme janë të mbështetura dhe të bazuara në Ligjin Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe ligjeve dhe akteve nënligjore të tjera në fuqi.

Njësia e Auditimit të Brendshëm, për vitin 2025 ka përgatitur Planin Strategjik 2025/2027, si dhe Planin Vjetor 2025 e që planifikimi i auditimit është bazuar në rrezikun dhe orientimin e identifikimit dhe përfshirjes për fushat me rrezik për organizatën buxhetore.

Pasi që nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është përgatitur Plani Strategjik dhe Plani Vjetor për vitin 2025, është përcjellë për miratim tek Kryetari i Komunës dhe tek Kryesuesi i Komitetit dhe gjithashtu është dorëzuar një kopje e miratuar në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm.

Në Planin Strategjik 2025-2027 janë të përfshira të gjitha drejtoritë-njësitë buxhetore, duke u bazuar në nivelin e rrezikshmërisë me: rrezik të lartë, rrezik të mesëm dhe rrezik të ulët dhe gjithashtu është hartuar Plani Vjetor në të cilin janë paraparë ditët efektive për çdo auditim.

Për vitin 2025, sipas Planit Vjetor janë paraparë gjithsej gjashtë (6) auditme të brendshme, që janë: katër (4) me rrezik të lartë dhe dy (2) me rrezik të mesëm. Mirëpo, një auditim, auditimi i performancës, të cilin është dashur ta kryejmë së bashku me zyrtar të USAID nuk është përfunduar, ngase zyra e USAID nuk funksionon tashmë. Për vitin 2025 janë kryer këto auditime:

- Grumbullimi i të hyrave vetanake Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Procedurat e menaxhimit të resurseve njerëzore në Drejtorinë e Arsimit
- Procedurat e menaxhimit të shpenzimeve për mallra, shërbime, komunali dhe kapitale në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme
- Procedurat e menaxhimit të prokurimit në Zyrën e Prokurimit
- Grumbullimi i të hyrave nga tatimi në pronë në Drejtorinë e Financave

Niveli i realizimit të Planit Vjetor

Gjatë vitit 2025, zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka arritur t'i kryej pesë (5) auditime të brendshme nga gjashtë të planifikuar.

Pra, gjatë vitit 2025, zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka arritur t'i kryej gjithsej pesë (5) auditime të brendshme dhe t'i hartoj raportet dhe t'i dorëzoj në drejtoritë e audituara, Kryetarit të Komunës, si dhe Kryesuesit të Komitetit nga një kopje të raporteve finale.

Nga gjithsej pesë (5) auditimet e kryera për të gjeturat e konstatuara kemi dhënë trembëdhjetë (13) rekomandime për përmirësim, me qëllim të ngritjes së efikasitet dhe efektivitet gjatë kryerjeve të detyrave të punës nga ana e zyrtarëve të Komunës.

Për rekomandimet e dhëna, të gjitha drejtoritë janë përgjigjur, duke na përcjellë dhe përgatit planin e veprimit dhe datën përfundimtare të zbatimit të rekomandimeve. Bazuar në planin e veprimit të drejtorive, Njësia e Auditimit të brendshëm ka përgatitur oraret e përcjelljes së implementimit të rekomandimeve të dhëna nga kjo zyrë.

Gjatë përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve nga gjithsej trembëdhjetë (13) rekomandimet e dhëna, kemi konstatuar këtë gjendje lidhur me zbatimin e tyre nga ana e drejtorive:

- Tërësisht të zbatuara një (1)
- Proces nëntë (9)
- Të pazbatuara tre (3)

Nëntë (9) rekomandime mbeten për përcjellje gjatë vitit 2026, sipas planit të veprimit të përgatitur për datën përfundimtare të implementimit.

Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për çdo përcjellje të rekomandimeve ka hartuar raporte dhe ua ka dorëzuar drejtorive të audituara, Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Komitetit.

Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për dy (2) gjashtëmujorët e vitit 2025 dhe përmbledhjen e vitit 2025 ka përgatitur raportet përmbledhëse dhe ua ka dorëzuar për njoftim me gjendjen e audituar në drejtoritë e audituara në Komunën e Ferizajt, Njesisë Qendrore Harmonizuese, Kryetarit të Komunës, si dhe Kryesuesit të Komitetit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA E INTEGRIMEVE EVROPIANE

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

Zyra e Integrimeve Evropiane vepron brenda Kabinetit të Kryetarit dhe ka për detyrë koordinimin, monitorimin dhe raportimin tek institucionet përkatëse që trajtojnë çështjet e integrimeve evropiane. Për këtë arsye, mbajmë komunikim të vazhdueshëm me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), konkretisht me Departamentin për Integrime Evropiane. Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025, kemi përmbushur me përpikëri të gjitha përgjegjësitë tona zyrtare, duke siguruar një bashkërendim efektiv, monitorim të rregullt dhe raportim të saktë në institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës që trajtojnë integrimet evropiane.

Zyrtari për Integrime Evropiane ka qenë pjesë e ekipit të Kryetarit të Komunës në procesin e aplikimit për fondet e Bashkimit Evropian, duke mbajtur kontakte të rregullta me organizata ndërkombëtare, përfshirë ato të Këshillit të Evropës dhe institucione të tjera që veprojnë në Republikën e Kosovës. Po ashtu, këto ekipe të përbashkëta vazhdojnë të jenë aktive në përgatitjen dhe aplikimin për thirrjet e reja të BE-së. Gjatë kësaj periudhe, kemi realizuar raportime periodike në MAPL në lidhje me Bashkëpunimin Ndër komunal dhe Ndër komunal Ndërkombëtar.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Zyra për Integrime Evropiane ka kryer raportime të rregullta në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) lidhur me zbatimin e Planit Individual të Veprimit për Komunën e Ferizajt, i cili buron nga Agjenda Evropiane për vitin 2025. Gjithashtu, kemi plotësuar pyetësorët e ndryshëm të kërkuara nga MAPL.

Janë ndërmarrë të gjitha veprimet prioritare për procesin e integrimeve evropiane, duke u fokusuar në krijimin e një mjedisi të favorshëm për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës së qytetarëve, forcimin e sundimit të ligjit, mbrojtjen e pronës, lirinë e lëvizjes, shprehjen e mendimit, promovimin e tolerancës dhe ndërtimin e besimit të ndërsjellë.

Në periudhën Janar–Dhjetor 2025, kemi mbajtur komunikim të vazhdueshëm dhe kemi përcjellë informacionet e kërkuara me Departamentin për Koordinim, Zhvillim dhe Integrime Evropiane të MAPL-së, si dhe me ministritë përkatëse. Po ashtu, kemi marrë pjesë aktivisht në të gjitha takimet konsultative dhe tryezat e punës, duke iu përgjigjur pozitivisht ftesave të institucioneve dhe duke dhënë kontributin tonë në çështjet përkatëse.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim qëllim parësor gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025 ka pasur koordinimin e aktiviteteve me të gjithë faktorët relevant që ndihmojnë në bashkëveprimin, rritjen e bashkëpunimit, integrimin e komuniteteve, procesin e kthimit të qëndrueshëm, procesin e riatdhesimit dhe ri-integrimit dhe ri integrimin e të huajve me qëllim të krijimit të një klime të mirë për zhvillim të komuniteteve, dhe ri-integrimin e tyre, lehtësimin e dialogut ndëretnik dhe ndërtimin e besimit ndërmjet personave të kthyer dhe komunitetit pranues, koordinimin i aktiviteteve me zyrtarët për kthim të qëndrueshëm, zyrtarët për integrim të komuniteteve, me institucionet komunale, ministritë përkatëse si dhe bashkëpunimin e ngushtë me organizatat e tjera lokale dhe ndërkombëtare të angazhuara në fushën e stabilizimit të komuniteteve, kthimit dhe ri-integrimit (shkëmbimi i informatave për personat e zhvendosur dhe personat e kthyer).

Gjatë vitit 2025, ZKKK-ja ka zhvilluar punë dhe aktivitete të ndryshme si:

- Takime e koordinime të veprimeve me drejtoritë komunale si DSHMS, DSHPE, DA, QPS, koordinim me institucionet tjera si Policia e Kosovës, Zyra e Punësimit etj.
- Shpërndarja e pakove ushqimore e higjienike për familjen në nevojë ku janë ndihmuar mbi 150 familje të tilla;
- Shpërndarja e veshmbathjeve për familjet në nevojë dhe nxënësit e varfër nga komuniteti;
- Mbështetje e inkurajim në regjistrimin e nxënësve të komunitetit në shkollat e mesme;
- Takime me prindër, mësimdhënës e psikolog si dhe nxënës të komunitetit për mos braktisjen e mësimi;
- Adresimi i donacioneve të pranuar gjatë vitit për nxënësit e komunitetit jo shumicë me qëllim përmirësimin e kushteve të tyre për vijimin e mësimi;
- Asistencë në nisma komunitare të fushës së shërbimeve publike si rregullimi i ndriçimit publik, rrjetit të kanalizimit dhe pastrimit të deponive ilegale të mbeturinave në vendbanimet komunitare;
- Ofrimi i asistencës për dokumentacion e informacione për familjet në asistencë sociale;
- Organizimi i trajnimeve profesionale dhe mundësitë për punësim përmes Zyrës së Punësimit për të rinjtë e komunitetit jo shumicë;
- Koordinim me institucionet e sigurisë për rritjen e sigurisë dhe shtimin e kontrolleve në lagjet e komuniteteve;

Riatdhesimi dhe Ri-integrim

Të riatdhesuar në vitin 2025 janë: 92 persona prej tyre 17 familje me 88 anëtarë dhe 4 individ (F 39 dhe M 53).

Sipas përkatësisë etnike :

Shqiptarë – 16 persona (7 F dhe 9 M)

Ashkali – 76 persona (32 F dhe 44 M)

Të regjistruar në SMR (Sistemi i Menaxhimit të Rasteve) nga ZKKK – ja 21 raste të vitit 2025.

Komisioni Komunal për Ri-integrim ka mbajtur 4 takime për shqyrtimin e 1 kërkesë e cila kërkesë është aprovuar – akomodim për 12 muaj. Një kërkesë për akomodim ka mbetur në proces deri në kompletimin e lëndës me dokumente. Tri familje janë larguar nga skema e akomodimit pas mbarimit të kontratës për akomodim . Dy familje kanë qenë të akomoduara për 12 muaj ndërsa njëra familje ka qenë e akomoduar një vit e 6 muaj për 6 muaj tjerë i është refuzuar kërkesa.

Për këto lëndët janë përgatitur vendimet për aprovim dhe refuzim, lënda është kompletuar me dokumentet tjera të nevojshme, të cilat paraprakisht janë bashkangjitur në SMR dhe kopja fizike është dërguar tek Koordinatori Rajonal për Ri - integrim pranë MPB – së.

Vizita 72 orësh për plotësimin e Pyetësorit për Vlerësimin e Nevojave të Personave të Riatdhesuar dhe Formulari i Verifikimit në Terren janë 18. Pyetësori dhe Formulari i plotësuar janë bashkangjitur në SMR.

Nga Fondi për Ri-Integrim 1 familje është furnizuar me pako ushqimore dhe higjienike dhe shpërndarja është bërë në koordinim me ZKKK-në.

Tek Zyra e Punësimit janë rekomanduar 7 persona të riatdhesuar, të cilët më pastaj janë rekomanduar në Qendrën për Aftësim Profesional – QAP.

Personat e riatdhesuar nga Gjermania gjatë vitit 2025, janë rekomanduar te organizatat URA 2 (GIZ), organizata AWO dhe Diakonia, disa familje janë përkrahur nga këto organizata, por ZKKK – ja nuk posedon informata për aktivitetet dhe ndihmat e ofruara.

Organizata për Migrim - IOM në partneritet me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, programi i IV për Stabilizimit të Komuniteteve nga Bashkimi Evropian (BE CSP IV) kanë mbështetur themelimin e një kabineti shkencor në shkollën fillore “Naim Frashëri” Zaskok – Ferizaj. Nga ky projekt kanë përfituar edhe 3 familje ndërsa rastet tjera mbeten në proces.

Kthimi

Sa i përket kthimit gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur kërkesa për kthim (dy kërkesa për ndërtim të shtëpive që posedojnë pronë janë shqyrtuar në Komisionin Komunal për Kthim) dhe janë rekomanduar tek Komisioni Qendror për Shqyrtim.

Kërkesat për ndërtim të shtëpive janë shqyrtuar në Komisionin Komunal për Kthim dhe janë rekomanduar te Ministria për Komunitete dhe Kthim. Rastet kanë mbetur në proces.

Ndërsa për Projektin: „Zgjidhje të qëndrueshme për rom, ashkali dhe të kthyerit egjiptian në Kosovë – Faza e I. Janë përfshirë personat e kthyer në periudhën 2015 – 2017 – të kthyer përmes UNHCR – it me projektin “Kthimi alternativë”. Ky projekt po implementohet nga organizata e DRC – së në bashkëpunim me Komunën e Ferizajt.

Parashihet të ndërtohet një objekt banimi me 30 banesa në fshatin Dubravë – Komuna e Ferizajt dhe do të përfshihen 22 për familjet e kthyera dhe 8 familje raste sociale. Si fillim janë vizituar 22 familje kryesisht të kthyer nga Maqedonia e Veriut në Komunën e Ferizajt. Projektin mbetet në proces, deri në hartimin e listës përfundimtare.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



NJËSIA KOMUNALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZI GJINORE

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

Gjatë vitit 2025, Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, zhvilloi aktivitete të shumta ku ndër më kryesoret, veçojmë:

- Zbatimi i aktiviteteve të parapara në PLVBGJ;
- Monitorimi i PLVBGJ nga OJQ Follow Up në bashkëpunim me UN Women dhe drejtoritë e Komunës;
- Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional (takime me institucionet përkatëse si Qendra për Punë Sociale, Zyra e Kryeministrit, MAPL, Gjykata, Policia, QKMF);
- Takime me institucione nga Zyra e BE-së, organizata të shoqërisë civile si: Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale - KLGJ, Syri i Vizionit, KRCT, Women for Women, UN Women etj);
- Mbrojtja nga dhuna në familje (përmes Mekanizmit kundër Dhunës në Familje);
- Fuqizimi i grave dhe përfshirja e komunitetit;
- Pjesëmarrja në punëtori, takime, trajnime, fokus grupe të ndryshme mbi barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut: MAPL, DEMOS, Advancing Together, Save the Children, takimi i KKR, Qendra e Trajnimit të Asociacionit të Komunave të Kosovës;
- Pjesëmarrja në punëtori, takime, trajnime me fokus grupe të ndryshme mbi barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut, përfshirë: Punëtorja “E Drejta e Pronës” në sallën e KK Ferizaj;
- Pjesëmarrje në takimin e radhës të Komisionit Komunal për Ri integrim – KKR për shqyrtimin e kërkesave për akomodim të personave të riatdhesuar;
- Pjesëmarrje dhe mbështetje për gratë sipërmarrëse tek Panairi i Bizneseve Artizanale në Ferizaj në sheshin “Dëshmorët e Kombit” nga 22-25 Korrik 2025- organizuar nga DZHET;
- Pjesëmarrje në procesin e buxhetimit gjinor për vitin 2026: Dëgjimi publik me gratë, me qëllim përfshirjen e kërkesave të tyre në planifikimin buxhetor;
- Pjesëmarrje në takimin përmbyllës të monitorimit të PLVBGJ në bashkëpunim me UN Women, Follow Up, QKMF dhe zyrtarë komunal ku u prezantuan gjetjet, u dha vlerësimi për progresin dhe rekomandime për hapat e mëtejme;
- Takim me përfaqësueset e Caritas Kosova për mundësi bashkëpunimi në projektin për fuqizimin ekonomik të grave ku u diskutua për përfshirjen e institucioneve komunale relevante si DZHET, DSHMS dhe DB në implementimin e projektit;

- Pranimi i raportit preliminar të monitorimit të PLVBGJ nga OJQ “Follow Up” dhe adresimi i tij tek drejtoritë komunale përkatëse;
- Bashkëpunimi me OJQ – UN Women, komunikimi rreth koordinimit për organizimin e trajnimeve mbi gjuhën e ndjeshme gjinore;
- Përgatitja e punëtorisë mbi gjuhën e ndjeshme gjinore, në dakordim me UN Women;
- Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të muajit tetor – Muaji Rozë në bashkëpunim me QKMF, DSHMS, UNICEF dhe AMC u zhvilluan aktivitete sensibilizuese për shëndetin e grave dhe trajnime për personelin mjekësor, në kuadër të PLVBGJ;
- Ligjërata për sigurinë rrugore në shkollat e Ferizajt nga Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor;
- Raportim përmes pyetësorit “*Parandalimi i dhunës me bazë gjinore përmes edukimit dhe ngritjes së vetëdijes*”, i implementuar nga QKSGJ në bashkëpunim me Solidar Suisse dhe i financuar nga Komisioni Evropian;
- Pjesëmarrje në ngjarjen e organizuar nga QKRMT me rastin e 26 vjetorit të themelimit, me temë “26 vjet kujdes, shpresë dhe drejtësi”, në kuadër të përkushtimit institucional për promovimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore;
- Zbatimi i punëtorisë mbi Gjuhën e Ndjeshme Gjinore, në kuadër të PLVBGJ, me përkrahje nga Gender Equality Facility- UN Women;
- Pjesëmarrje në ngjarjen “Asgjë për ne pa zërin tonë” – publikimi i Raportit mbi gjendjen dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;
- Takime të planifikuara me Policinë dhe OSBE në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës në Familje;
- Pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët “Roli i mekanizmave komunal në barazinë gjinore dhe mbështetjen e të mbijetuarve” organizuar nga Medica Gjakova, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave komunal dhe OJQ-ve;
- Pjesëmarrje në konferencën regjionale të ABGJ/ZKM, për shënimin e 20 vjetorit të ABGJ-së dhe 30 vjetorin e Platformës së Pekinit me mbështetje të UN Women;
- 25.11.2025 Hapja e fushatës 16 Ditë të Aktivizimit Kundër Dhunës në Baza Gjinore. Aktivitet i realizuar nga Policia, QPS dhe anëtarët e Mekanizmit Ndërinstitucional me shpërndarje të fletëpalosjeve sensibilizuese në sheshin e qytetit;
- 27.11.2025 Pjesëmarrje në tryezën “Qasja në drejtësi për viktimat e dhunës në familje”, organizuar nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me OSBE;
- 29.11.2025 përcjellja dhe evidentimi i aktivitetit “Këmisha e Lirisë” – Forum Teatër, i organizuar nga QMGF “Shtëpia Ime” në bashkëpunim me RrGK, si pjesë e aktiviteteve në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës në Baza Gjinore;
- 04.12.2025 Pjesëmarrje në hapjen e ekspozitës së Shoqatës Hendifer, e mbajtur në Galerinë e Arteve në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara. Ekspozitë e realizuar nga projekti “Arti për të Gjithë”;
- 09.12.2025 Pjesëmarrje në Konferencën e 2-të të Grupeve Lokale të Grave “Reflektime dhe Angazhime: Përforcimi i udhëheqjes politike të grave në Kosovë. Organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë;
- Bashkëbisedim me OJQ Bran dhe DZHET për nevojat dhe mbështetjen e grave nga komuniteti jo shumicë;
- Pjesëmarrje në prezantimin e Manualit të Antigjepsizmit, organizuar nga OJQ “Voice of Roma, Ashkali and Egyptians”, me qëllim ndërgjegjësimin institucional për luftimin e diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2025

Hyrje

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme është kompetente për ofrimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për administratën komunale dhe për ofrimin e shërbimeve për qytetarë bazuar në ligjet në fuqi si: Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji mbi Shërbimin Civil, Ligji për Gjendjen Civile, Statutin e Komunës, udhëzimet strategjike të Kryetarit të Komunës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet administrative.

DAP është garantuese e funksionimit demokratik të administratës komunale në aspektin e vendimmarrjes:

- E lirisë së shprehjes së mendimit;
- Trajtimit të drejtë të kërkesave dhe shqetësimeve të qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të caktuara të interesit;
- Zbatimit rigoroz të ligjit në procedurat administrative dhe ekzekutive;
- Rritjes së partneritetit ndërmjet administratës dhe qytetarëve;
- DAP do të vazhdoj të ruaj dhe kultivoj marrëdhëniet e mira me komunitetet pakicë, në respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre, sipas parimit ligjor dhe qytetar.

Synimet e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme gjatë vitit 2025 kanë qenë:

- Krijimi i një administrate profesionale, të përgjegjshme dhe të paanshme në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve;
- Infrastrukturë të avancuar profesionale;
- Ofrimi i shërbimeve që lidhen me punët e legjislativit dhe të ekzekutivit.

DAP është angazhuar për të siguruar dhe garantuar:

- Respektim të ligjit (akte ligjore, nënligjore dhe normative);
- Llogaridhënie;
- Profesionalizëm;
- Efikasitet;
- Barazi gjinore;
- Transparencë në vendimmarrje dhe procedura ekzekutive;
- Shërbime publike cilësore dhe të shpejta për qytetarët;
- Frymë të tolerancës dhe të bashkëpunimit e bashkëpjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në përmirësimin e shërbimeve të administratës komunale.

Angazhimi i vazhdueshëm i DAP për ndërtimin e një administrate funksionale dhe efikase bazohet në respektimin e ligjit.

- Gjatë vitit 2025, DAP ka zhvilluar një aktivitet të gjithanshëm duke respektuar ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, duke qenë në funksion dhe në shërbim të gjithë administratës komunale dhe qytetarëve.
- DAP, e organizuar në sektorët e lartpërmendur, ka arritur që me përkushtim të kryej me sukses të gjitha punët dhe detyrat e saj gjatë këtij viti, duke qenë vazhdimisht në shërbim të administratës komunale dhe qytetarëve.

Më poshtë janë disa nga aktivitetet më të rëndësishme të administratës komunale:

- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme gjatë vitit 2025 ka bërë shitjen e inventarit të vjetruar jashtë përdorimit dhe jashtë funksionit (aparate elektrike dhe inventarë nga druri dhe metali) përmes ankandit të shpallur nga Zyra e Prokurimit, me numër 01/04/2025, me datën 10.09.2025.
- Gjatë këtij viti është organizuar dhe mbikëqyrur regjistrimi vjetor i inventarit të gjithë sektorëve të administratës komunale, duke përfshirë institucionet arsimore, shëndetësore, bibliotekat dhe institucionet e tjera nën menaxhimin e Komunës. Pas regjistrimit, është bërë tërheqja e inventarit të demoluar duke e grumbulluar në depo, kurse pjesën që mund të përdorej e kemi riaftësuar dhe dhuruar shkollave sipas kërkesave të tyre.
- Veprimet janë kryer duke formuar komisionet adekuate, si komisioni për vlerësim dhe regjistrim të inventarit.
- Janë ndërmarrë edhe një varg masash të tjera për funksionalizimin dhe efikasitetin e administratës komunale.

Në vazhdim paraqitet puna vjetore e sektorëve dhe njësive të DAP gjatë vitit 2025. Administrata ka zhvilluar aktivitetet e saj përmes këtyre njësive organizative:

1. Asistenti-ja Ekzekutive
2. Zyrtari Financiar
3. Sektori i Gjendjes Civile
4. Sektori i Shërbimeve të Qytetarëve
5. Sektori i Shërbimeve të Përbashkëta
6. Sektori i Arkivit të Komunës

2. Zyrtari Financiar

Zyrtari Financiar është përkujdesur për gjendjen financiare të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, duke ndërmarrë të gjitha veprimet për kompletimin e lëndëve për pagesën e të gjitha faturave që lidhen me shpenzimet e energjisë elektrike, ujit, mbeturinave, riparimin e mjeteve zyrtare, si dhe faturat e tjera që janë barrë e Drejtorisë përkatëse.

3. Sektori i Gjendjes Civile

Të dhënat për dokumentacionin e lëshuar dhe regjistrimet e bëra nga Sektori i Gjendjes Civile

Nr.	Përshkrimi	Përdorim të brendshëm	Përdorim të jashtëm
1.	Ekstrakt nga RQGJC	32977	7464
2.	Certifikata të lindjes	4424	17266
3.	Certifikata të martesës	3549	5609
4.	Certifikata të vdekjes	3256	880
5.	Certifikata të statusit martesor	1886	745
6.	Certifikata të shtetësisë	219	450
7.	Certifikata familjare	8892	1904
8.	Certifikata të vendbanimit	5177	2737
9.	Vërtetim nga arkivi	458	761
		60838	37816
Gjithsej dokumente të lëshuara		98654	

Regjistrime të bëra në Regjistrat e Gjendjes Civile

1	LINDJE	2462
	1.1. Brenda vendit	1672
	1.2. Jashtë vendit	371
	1.3. Me vonesë	419
2	MARTESA	1136
	2.1. E rregullt	897
	2.2. Jashtë vendit	239
3	VDEKJE	728
	3.1. Brenda vendit	529
	3.2. Jashtë vendit	53
	3.3. Me vonesë	146
Gjithsej regjistrime të bëra		4326

Numri i dokumenteve të lëshuara nga Platforma Elektronike E-Kosova

1	Certifikata të lindjes	21140
2	Ekstrakt nga RQGJ	19748
3	Certifikata të martesës	5552
4	Certifikata të vdekjes	591
Gjithsej		47,031

Raporti i adresave të regjistruara

1	Adresat e regjistruara të deklaruara nga AKK	41,871
2	Deklarimi i adresave nga E - Kosova	18,483
Gjithsej		60,354

Numri i kërkesave për fitim dhe lirim të shtetësisë

1	Fitim të shtetësisë së Republikës së Kosovës	43
2	Lirim të shtetësisë së Republikës së Kosovës	8
3	Rifitim të shtetësisë së Republikës së Kosovës	120
4	Refuzim të shtetësisë së Republikës së Kosovës	58
Gjithsej kërkesa		229

Kërkesa për ndërrimin e emrit personal –Emri dhe Mbiemri

1	Ndërrim i emrit personal –Emri	14
2	Ndërrim i emrit personal –Mbiemri	77
Gjithsej		91

Numri i dokumenteve - Shërbime me aktvendim

1	Aktvendime për regjistrime të mëvonshëm në RGJCL- Ri-regjistrim	14
2	Aktvendime për regjistrime të mëvonshëm në RGJCV	102
3	Aktvendime për ndërrim- korrigjim të emrit mbiemrit personal	181
4	Aktvendim për refuzim të regji. të mëvonshëm të lindjes në RGJC	01
5	Aktvendimet për gabime teknike në Prog. Sistem si dhe plotësimi i të dhënave në RTHL	40
6	Aktvendime për refuzimin e ndërrimit të emrit personal	06
7	Aktvendime për anulim të regjistrimit të dyfishtë në RGJC	15
8	Aktvendim për njohjen e vendimit të shtetit të huaj për ndërrimin e emrit personal	06
9	Aktvendime për refuzim të regji. të mëvonshëm të vdekjes në RGJC	02
Gjithsej aktvendime		367

Shkresa të ndryshme

1	Sektori i Verifikimit – ARC-lëndë për verifikim	18
2	Përgjigje kërkesave nga Gjykata dhe Prokuroria	289
3	Departamenti i pensioneve të jashtme	50
4	Përgjigje kërkesave nga qytetarët	31
5	Krimet Ekonomike	01
6	Burgu i Sigurisë së Lartë	02
7	Agjencioni Pyjor	05
8	Kadastra Komune, K. Ferizaj	05
9	Inspektorati Komunal, K. Ferizaj	01
10	Qendra për Punë Sociale (QPS) K. Ferizaj	01
11	Përmbarues Privat	01
Gjithsej shërbime		404

4. ZYRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE

Gjatë vitit 2025 në Zyrën për Shërbim të Qytetarëve janë kryer këto punë, të cilat do t'i paraqesim në mënyrë tabelore si më poshtë, të dhënat për pranimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve drejtuar organeve të Komunës sipas njësive organizative.

Nr. i kërkesave për drejtori - 01/01/2025- 31/12/2025

Nr.	Përshkrimi	Nr. i kërkesave	Përqindja
1	Drejtorja e Administratës së Përgjithshme	65,843	68.00
2	Drejtorja e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit	20,587	21.00
3	Zyra e Kryetarit	2,706	2.00
4	Drejtorja e Urbanizmit dhe Mjedisit	2,113	2.00
5	Drejtorja e Bujqësisë	1,644	1.00
6	Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	1,434	1.00
7	Drejtorja e Financave	711	0.00
8	Drejtorja e Arsimit	628	0.00
9	Drejtorja e Infrastrukturës	299	0.00
10	Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizëm	294	0.00
11	Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	254	0.00
12	Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	60	0.00
13	Kuvendi Komunal	20	0.00
		96,593	

5.SEKTORI I SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA

- Zyrtarët për Çështje të Kuvendit Komunal

Lëndët në Intranet të pranuar

Shkurtesa	Përshkrimi	Lëndët e pranuar	Lëndë në proces	Lëndët e miratuara	Lëndët e refuzuara	Lëndët e hedhura poshtë	Lëndët e pezulluara
KK Ferizaj	Kuvendi i Komunës Ferizaj	130	0	49	78	1	2

Mbledhjet e mbajtura të Kuvendit Komunal (KK)

10 mbledhje të Kuvendit Komunal.

Për secilën mbledhje:

- 10 ftesa për mbledhje,
- 10 lista të nënshkrimeve të anëtarëve,
- 10 procesverbale

Mbledhjet e mbajtura të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)

10 mbledhje të KPF-së.

Për secilën mbledhje:

- 10 ftesa për mbledhje,
- 10 lista të nënshkrimeve të anëtarëve,
- 10 procesverbale

Mbledhjet e mbajtura të Komitetit për Komunitete

10 mbledhje të Komitetit për Komunitete.

Për secilën mbledhje:

- 10 ftesa për mbledhje,
- 10 lista të nënshkrimeve të anëtarëve,
- 10 procesverbale.

Vendimet e Kuvendit Komunal

- **61 Vendime të miratuara**, të cilat:
 - Janë protokolluar dhe regjistruar në shkresën e akteve.
 - Janë dërguar në MAPL për shqyrtim dhe pas kthimit nga MAPL-ja, janë përpunuar dhe publikuar.
- Vendimet e KK-së për vitet 2024 dhe 2025 janë përgatitur për botim si libër arkivor.

1 (një) Rregullore e miratuar:

- Rregullorja për Transparencë dhe Plani i Veprimit për Transparencën Komunale për periudhën 2025–2028.

Proceset shitesë

• **Përgatitja dhe dërgimi i materialeve për mbledhjet e Kuvendit Komunal (KK)** për: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Kryetarin e Komunës, Nënkyetarët, 41 anëtarët e Kuvendit Komunal, 11 drejtorët e drejtorive komunale, 5 (pesë) materiale për mediat, si dhe materialet e Kuvendit Komunal për publikim në faqen zyrtare të komunës.

• **Komiteti Konsultativ për Shërbime Sociale për Persona me Aftësi të Kufizuara**
Anëtarët pjesëmarrës të Komitetit Konsultativ kanë mbajtur gjithsej **6 (gjashtë) mbledhje**, për të cilat janë pranuar dhe arkivuar listat përkatëse të nënshkrimeve.

Statistika e përdorimit të veturave zyrtare

Në tabelën e mëposhtme mund të shihni statistikën e përdorimit të Veturave Zyrtare

Institucioni	Përshkrimi	Të pranuar Kërkesa	Anuluar	Miraturar	Total	Viti
Komuna e Ferizajt	Shfrytëzimi i automjeteve zyrtare	1,528	8	1,520	1,528	2025

Shpenzimet e Derivateve për Automjetet e Komunës së Ferizajt

- Shpenzimet për derivate për automjetet e Komunës së Ferizajt gjatë vitit 2025 janë si më poshtë:

Nr.	Emri i automjetit	Nr. i regjistrimit	Drejtoria	Km. fillim muaji Janar	Km. fund muaj Dhjetor	Km. e kaluara	Shpenzime dizel	% paraparë	Mes. në 100 km.	Vërejtje
1.	Kia	05z-04-25	Komuna e Ferizajt	132708	138842	6134	420,03	5,90%	6,847570916	
2.	Kia	05z-06-25	Komuna e Ferizajt	124373	129665	5292	423,05	6,00%	7,994142101	
3.	Kia	05z-07-25	Komuna e Ferizajt	132747	135650	2903	224,01	6,10%	7,716500172	
4.	Kia	05z-10-25	Komuna e Ferizajt	153345	157924	4579	342,53	5,90%	7,480454248	
5.	Kia	05z-12-25	Komuna e Ferizajt	163175	167365	4190	242,14	6,05%	5,778997613	
6.	Honday 120	05z-13-25	Komuna e Ferizajt	165876	170152	4276	294	5,60%	6,875584659	
7.	Honday 120	05z-14-25	Komuna e Ferizajt	131146	138335	7189	391,01	5,90%	5,439004034	
8.	Honday 120	05z-15-25	Komuna e Ferizajt	173234	179936	6702	529	6,00%	7,893166219	
9.	Honday 120	05z-19-25	Komuna e Ferizajt	212170	218507	6337	495,4	6,10%	7,817579296	
10.	Minibusi	05z-20-25	Komuna e Ferizajt	217397	227380	9983	1297,3	15,00%	12,99509166	
11.	Kia.	05z-24-25	Komuna e Ferizajt	127820	139811	11991	795,02	6,00%	6,630139271	
12.	Kia	05z-27-25	Komuna e Ferizajt	104502	122422	17920	1171,38	6,00%	6,53671875	
13.	Kia	05z-28-25	Komuna e Ferizajt	94063	103286	9223	567,01	6,00%	6,147782717	
14.	Kia	05z-31-25	Komuna e Ferizajt	95427	103213	7786	523,01	6,10%	6,717313126	
15.	Kombi-Merce.	05z-32-25	Komuna e Ferizajt	291809	297822	6013	667,75	12,00%	11,1051056	
16.	Autobusi	05z-38-25	Komuna e Ferizajt	7446976	7446976	0	0			Defekt
17.	Kia	05z-43-25	Komuna e Ferizajt	135617	142219	6602	445,24	5,6	6,744016965	
18.	Toyota	05z-22-25	Shoqata e të Verbërve	574450	576689	2239	250			
19.	Suzuki	05z-26-25	Komuna e Ferizajt	182875	183794	919	144,5			
20.	Ford PJ	05z-29-25	Shkolla "Gjon Serreqi"	418289	421739	3450	304			
21.	Ford PJ	05z-30-25	Shkolla "Ahmet Hoxha"	209688	214509	4821	248			
Total						128549	9774,38	10,32%	7,603621965	

Në tabelën e mëposhtme po japim të dhënat e shpenzimeve (2024-2025)

Numri	Shpenzimet	Viti 2024	Viti 2025 (21 Automjete)	Vërejtje
1	Shpenzimet e administratës me derivate për automjetet zyrtare të Komunës së Ferizajt	8,997.81 litra	9774,38 litra	
	Totali i shpenzimeve me derivate	8,997.81 litra	9774,38 litra	

Shpenzimet me Derivate dhe Menaxhimi i Automjeteve në Komunën e Ferizajt – Vitin 2025

Gjatë këtij viti, në listën e shpenzimeve të automjeteve të Komunës së Ferizajt janë përfshirë edhe dy automjete, të cilat kanë ekzistuar më herët, por nuk kanë qenë të evidentuara në listën e shpenzimeve, si më poshtë:

- Ford PJ2, targa 05Z-29-25, në shfrytëzim nga Shkolla “Gjon Serreçi”
- Ford PJ2, targa 05Z-30-25, në shfrytëzim nga Shkolla “Ahmet Hoxha”

Tabela e Servisimit dhe Riparimeve Teknike për Automjetet

Nr.	Emri i automjetit	Nr. i regjistrimit	Drejtoria	Pajisja me goma, dimërore	Riparimi teknik	Vërejtje
1	Kia	05z-04-25	DI	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
2	Kia	05z-06-25	DSHPE	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
3	Kia	05z-07-25	DRKS.	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
4	Kia	05z-10-25	DZHE	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
5	Kia	05z-12-25	DA	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
6	Honday 120	05z-13-25	DEF	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
7	Honday 120	05z-14-25	QPS	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
8	Honday 120	05z-15-25	DA	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
9	Honday 120	05z-19-25	DEF	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
10	Minibusi	05z-20-25	DKRS	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
11	Toyota HIACE PASS VAN	05Z-22-25		PO	Automjeti i është dhënë në shfrytëzim Shoqatës së të Verbërve.	
12	Kia.	05z-24-25	DSHMS	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
13	Suzuki Jimny	05z-26-25	DSHMS	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
14	Kia	05z-27-25	DAP	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
15	Kia	05z-28-25	Inspeksioni	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
16	Ford PJ 2	05z-29-25	Shkolla e "Gjon Serreqi"	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
17	Ford PJ2	05z-30-25	Shkolla "Ahmet Hoxha"	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
18	Kia	05z-31-25	Kabineti	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
19	Kombi-Merce.	05z-32-25	DAP	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	
20	Kia	05z-43-25	DGJPK	PO	Mirëmbajtje dhe servisim	

Kërkesat e qytetarëve (të shqyrtuara)

Shenja	Shenja DSC	Numri
030/01	Në përgjithësi për punën në zyrë	1
030/08	Shërbimet e teknologjisë informative dhe shërbimet telefonike	7
032/03	Vërtetimet e certifikatave të gjendjes ekonomike	664
032/04	Deklaratat e ndryshme me dëshmitar	-
111/02	Kërkesat lidhur me punësimin e praktikantëve	25
183/01	Stimulimi për rritjen e fëmijëve	18
205/01	Letërnjoftimet, të paraqiturit për vendbanime dhe vendqëndrimin	--
345/02	Shfrytëzimi i mjeteve transportuese	107
404/02	Blerjet, inventarizimi etj.	-
615/03	Kërkesat dhe ankesat e ndryshme	-

Total:**715**



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E FINANCAVE

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

Drejtoria e Financave mbështetur në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin e Financave Lokale, si dhe në të dhënat e gjeneruara nga Sistemi i Menaxhimit të Financave të Kosovës, hartoi raportin vjetor të punës për vitin fiskal 2025 përfshirë të dy sektorët e këtij programi buxhetor, duke paraqitur të arriturat, sfidat si dhe objektivat afatshkurtra dhe atë në fushën e:

1. Të hyrave vetanake dhe
2. Shpenzimet buxhetore

Programi ynë buxhetor në momentin e hartimit të projekt buxhetit për vitin fiskal 2025 përcaktoj në të njëjtën kohë edhe objektivat buxhetore si në fushën e të hyrave dhe në atë shpenzimeve buxhetore gjithnjë duke respektuar në këtë rast qarkoret buxhetore të cilat ishin edhe baza e hartimit të planit të të hyrave vetanake si dhe planifikimit buxhetor të shpenzimeve.


Në të dy segmentet e përgjegjësisë së programit tonë buxhetor treguam performancë të mirë në inkasimin e të hyrave, në të njëjtën kohë ruajtëm stabilitetin fiskal duke ngritur edhe më tej shkallën e efikasitetit të shpenzimeve buxhetore, rezultati i së cilës është shpenzimi i mjeteve të grantit qeveritar në kuotën prej 99.93%. Drejtoria e Financave gjatë vitit fiskal 2025 në vazhden e aktiviteteve dhe rezultateve të treguara u ballafaqua edhe me sfida të shumta sidomos në fushën e të hyrave vetanake.

TË HYRAT VETANAKE

Me mbylljen e vitit fiskal 2025 në kuadër të fushës së inkasimit të të hyrave vetanake dhe të hyrat indirekte organizata jonë realizoj të hyra në vlerë 10,484,565.77€ kurse të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2025 janë 7,974,306.00€ (me buxhetin e aprovuar) ku shihet se kemi arritur ta realizojmë për 2,060,903.97€ më shumë në krahasim me planifikimin e të hyrave shprehur në përqindje kemi 125.84% dhe 130.78% më shumë se në vitin 2024.

Grumbullimi i të hyrave vetanake sipas llojit të të hyrave:

- Të hyrat tatimore - Tatimi në pronë 2,371,732.22€
- Të hyrat jo tatimore - Taksat, Tarifat dhe Ngarkesat 6,260,650.19€
- Të hyrat indirekte- Gjobat e trafikut 1,305,521.00€
- Të hyrat nga dënimet e Gjykatës 90,470€ dhe
- Të hyrat nga Agjencioni i Pyjeve 6.836.56€



Krahasimi i të hyrave vetanake mes viteve 2025 dhe 2024

Kodi ekonomik	Emërtimi	Planifikimi i THV 2025	Realizimi i THV Janar - Dhjetor 2025	Diferenca mes planifikimit dhe realizimit	Realizimi i të HV Janar - Dhjetor 2024	% e realizimit në raport 2025/2024	% e realizimit të THV 2025
40110	Tatimi në pronë	2,946,970.00	2,371,732.22	575,237.78	2,142,214.12	110.71	80.48
50001	Taksa-Regjistrimi i automjeteve	470,000.00	414,460.00	55,540.00	372,320.00	111.32	88.18
50005	Taksa e lejeve të vozitjes	5,870.00	10,456.50	-4,586.50	8,288.00	126.16	178.13
50008	Taksa për parking publik		349.00	-349.00		#DIV/0!	#DIV/0!
50009	Taksa për leje ndërtimi	2,000,000.00	4,843,128.89	-2,843,128.89	2,389,535.68	202.68	242.16
50013	Taksa për certifikatat e lindjes	115,000.00	69,405.00	45,595.00	81,150.00	85.53	60.35
50014	Taksa për certifikatat e kurorëzimit	20,000.00	8,287.00	11,713.00	9,889.00	83.80	41.44
50015	Taksa për certifikatat e vdekjes	15,180.00	1,114.00	14,066.00	2,305.00	48.33	7.34
50016	Taksa për certifikata tjera	30,000.00	1,489.00	28,511.00	1,054.00	141.27	4.96
50017	Taksa për verifikimin e dokumenteve të ndryshme	40,000.00	584.00	39,416.00	1,251.00	46.68	1.46
50019	Taksa tjera administrative	150,440.00		150,440.00	1,495.00	0.00	0.00
50026	Taksa për legalizimin e objekteve	424,280.00	46,598.27	377,681.73	59,010.63	78.97	10.98
50032	Taksa për certifikatë të pronësisë dhe kopje plani	32,660.00	6,142.00	26,518.00			18.81
50045	Leje mjedisore komunale	670,000.00	240,587.56	429,412.44	235,632.50	102.10	35.91
50104	Gjjobat nga Inspektorati	30,000.00	11,129.96	18,870.04	26,657.60	41.75	37.10
50107	Gjjobat tjera	10,756.00	8,612.01	2,143.99	15,315.17	56.23	80.07
50,111	Shitja e pasurisë së konfiskuar			0.00	4,000.00	0.00	#DIV/0!
50114	Gjjoba mandatore - Hedhja e mbeturinave	5,000.00	1,739.30	3,260.70	4,869.40	35.72	34.79
50205	Licenca për pranimit teknik të lokalit	5,000.00	4,310.00	690.00	2,680.00	160.82	86.20

50401	Shitja e shërbimeve	30,000.00		30,000.00		#DIV/0!	0.00
50408	Qiraja nga objektet publike	247,400.00	75,025.40	172,374.60	114,468.07	65.54	30.33
50409	Participimet	353,060.00	289,725.30	63,334.70	349,951.70	82.79	82.06
50413	Shitje e pasurisë publike			0.00	6,678.00	0.00	
50504	Taksa për matje e tokës në teren	372,690.00	227,267.00	145,423.00	362,872.25	62.63	60.98
5055	Inspektimi veterinar brenda vendit		100.00	-100.00			
50507	Inspektimi higjenik sanitar		140.00	-140.00			
61000	Të hyrat nga viti i kaluar			0.00	444	0.00	
	Gjobat e trafikut		1,727,283.00	-1,727,283.00	1,344,792.00	128.44	
	Gjobat nga gjykata		118,035.00	-118,035.00	129,680.00	91.02	
	Të hyrat nga A.P.		6,865.36	-6,865.36	6933.93	99.01	
/	Totali:	7,974,306.00	10,484,565.77	-2,510,259.77	7,673,487.05	136.63	131.48

Raporti i punës për Njësinë e Tatimit në Pronë

Të hyrat nga Tatimi në pronë prej 01.01.2025 deri me datën 31.12.2025 janë gjithsej 2,371,732.22€.

Nr. rend.	Muajt	Viti 2024	Viti 2025	Krahasuar në %	Ngritje-Zbritje %
1	Janar	201,399.53	84,018.04	41.72%	-58.28%
2	Shkurt	130,632.02	204,953.79	156.89%	56.89%
3	Mars	153,340.86	188,318.22	122.81%	22.81%
4	Prill	315,713.50	513,546.66	162.66%	62.66%
5	Maj	183,468.15	280,332.61	152.80%	52.80%
6	Qershor	82,672.71	143,852.50	174.00%	74.00%
7	Korrik	116,891.37	159,949.83	136.84%	136.84%
8	Gusht	227,321.87	223,146.07	98.16%	-1.84%
9	Shtator	223,123.96	174,957.19	78.41%	-21.59%
10	Tetor	151,136.60	127,205.63	84.17%	-15.83%
11	Nëntor	95,574.97	64,127.24	67.10%	-32.90%
12	Dhjetor	260,938.58	207,324.44	79.45%	-20.55%
	Gjithsej	2,142,214.12	2,371,732.22	110.71%	10.71%

Nga të hyrat e Tatimit në Pronë në krahasim me vitit 2024, kemi rritje prej: **10.71 %**.

Të hyrat nga Tatimi në Pronë për vitin **2025** janë **2,371,732.22€**.

Përveç punëve rreth pagesave, në zyrën e tatimit në pronë janë kryer punë tjera, të cilat po i theksojmë në vijueshmëri:

- Kemi kryer edhe punët përgatitore për Inspektimin nga Departamenti i Tatimit në Pronë
- Kemi kryer nga auditorët e brendshëm dhe të jashtëm auditimin për vitin 2024
- Kemi kryer në terren verifikimin e objekteve të reja apo rrënimet ose renovime.

Nga Zyra e Tatimit në Pronë janë kryer edhe këto punë:

Nr. rend.	Emërtimi	Viti 2025
1	Objekte të verifikuara	10021
2	Parcela	4508
3	Objekte të reja	920
4	Faturat lëshuara për pagesë	48276
5	Vërtetime të lëshuar nga inkasantët	403
6	Taksa për automjete	176
7	Taksa të Automjeteve për veteranë	571
8	Lëndë të regjistruara-ndryshuara në kompjuter-stafi TP-në	4740
9	Konsultim me palë	24565
10	Thirrje telefonike	368
11	Ankesave ndaj faturës	368
12	Shqyrtim i ankesave	368
13	Vet deklaram për posedim e pronës	22
14	Shqyrtim i vet deklaramit për posedim e pronës	22
15	Shpërndarja e vendimeve të ankesave	365
16	Letër kujtesë	213
17	Broshura të shpërndara	13200
18	Marrëveshje të lidhura për pagesë	7

Gjatë vitit 2025, nga DTP-në është bërë ndryshimi i zonave për banim nga 29 zona, në 21 zona për banim, po ashtu është bërë vlerësimi për banim dhe industri, si dhe tatimi progresiv për vitin 2026.

Raporti i Buxhetit të Realizuar Komunal për periudhën Janar –Dhjetor 2025

Raporti i Buxhetit Komunal për periudhën Janar – Dhjetor 2025 ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Për vitin 2025 kemi Ligjin e Buxhetit Nr.08/L-332 i aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës ku Komuna e Ferizajt ka buxhetin në vlerë prej 46,013,005.00€ me këto burime të financimit:

- Granti Qeveritar janë 38,038,699.00 €
- Të hyrat vetanake të vitit 2025 janë 7,974,306.00€.

Mirëpo buxheti i Komunës brenda vitit fiskal ka pasur lëvizje gjithnjë në rritje dhe vlera përfundimtare e buxhetit për vitin fiskal 2025 është 49,736,488.99€. Në këtë vlerë buxhetore burimet e financimit janë nga:

- Granti qeveritar 39,459,382.15€
- Të hyra vetanake (viti 2025) 7,974,306.00€
- Të hyrat vetanake të bartura (viti 2024) 2,277,102.28€
- Grant i donatorëve të brendshëm 15,008.30€
- Donacion nga Save the Children 5,902.23€
- Qeveria Zvicerane 1.13€
- Donacion nga Council of Europe 4,786.90€.

Ndërsa shpenzimi i përgjithshëm i buxhetit të Komunës është 49,685,072.85€.

Është bërë shpenzimi i buxhetit prej 99.90%, në krahasim me mjetet buxhetore për këtë periudhë raportuese, pra për vitin 2025. Përqindja e shpenzimit të buxhetit nga të gjitha burimet e financimit është e kënaqshme.

Buxheti dhe shpenzimi sipas kategorive ekonomike Janar-Dhjetor viti 2025

Kategoria ekonomike	Buxheti	Shpenzimi	Diferenca	% e shpenzimit
	1	2	3=(1-2)	4=(2/1*100)
Paga dhe shtesa	22,340,614.30	22,336,274.52	4,339.78	99.98
Mallra dhe shërbime	10,957,077.41	10,944,856.06	12,221.35	99.89
Komunali	870,326.85	869,690.91	635.94	99.93
Subvencione	2,794,000.00	2,793,161.72	838.28	99.97
Investime kapitale	12,774,470.43	12,741,089.64	33,380.79	99.74
Totali	49,736,488.99	49,685,072.85	51,416.14	99.90

SHPENZIMET NGA GRANTI QEVERITAR SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE DHE PROGRAMEVE PËR JANAR - DHJETOR TË VITIT 2025 FB 10						
rogramet	Paga dhe shtesa	Mallra dhe shërbime	Komunal	Subvencione	Investime kapitale	Totali
ZYRA E KRYETARIT	335,273.97	154,414.99				489,688.96
ADMINISTRATA	356,319.75	1,961,314.27	492,744.35			2,810,378.37
ZYRA E PROKURORIT	40,378.14					40,378.14
ZYRA E KUVENDIT	380,080.91	20,583.39				400,664.30
BUXHETI DHE FUNKSIONET	295,224.54	149,445.81				444,670.35
SHËRBIME PUBLIKE	387,001.67	1,799,989.22	4,677.30		929,503.56	3,121,171.75
INFRASTRUKTURA	68,351.78	149,974.61			4,443,063.06	4,661,389.45
ZYRA E KUMUNALIT	119,113.79	10,360.95				129,474.74
BUJQESIA DHE PASHA	44,908.85	499,999.38			120,000.00	664,908.23
ZHVILLIM EKONOMIK	79,583.87	299,735.91			80,000.00	459,319.78
KADASTRA DHE ZEMËRBU	146,732.92	10,361.00				157,093.92
PLANIFIKIM URBAN	89,413.04	199,816.00			629,611.00	918,840.04
SHËNDETSIA	3,372,543.57	1,149,698.93	79,998.78		473,999.00	5,076,240.28
SHERBIMET SOCIALE	109,288.40	42,605.66	4,677.30			156,571.36
SHERBIMET REKREACION	86,550.44	77,363.87	10,394.00		294,893.80	469,202.11
KULTUR, RINI DHE SPORT	503,323.26	171,243.12		37,658.67	35,514.97	747,740.02
ARSIM	15,917,811.58	1,298,329.02	127,199.18	499,927.06	842,119.42	18,685,386.26
GJITHSEJ	22,331,900.48	7,995,236.13	719,690.91	537,585.73	7,848,704.81	39,433,118.06

Buxheti nga granti Qeveritar dhe shpenzimi sipas kategorive ekonomike janar –dhjetor 2025

Kategoria ekonomike	Buxheti	Shpenzimi	Diferenca	% E shpenzimit
	1	2	3=(1-2)	4=(2/1*100)
Paga dhe shtesa	22,334,037.15	22,331,900.48	2,136.67	99.99
Mallra dhe shërbime	8,001,137.00	7,995,236.13	5,900.87	99.93
Komunal	719,694.00	719,690.91	3.09	100.00
Subvencione	537,746.00	537,585.73	160.27	99.97
Investime kapitale	7,866,768.00	7,848,704.81	18,063.19	99.77
Totali	39,459,382.15	39,433,118.06	26,264.09	99.93

Në tabelë shihet se shpenzimet e mjeteve me burim financim Grant Qeveritar janë 39,433,118.06€ apo në përqindje 99.93%, të mjeteve buxhetore, paga dhe mëditje janë 99.99%, mallra dhe shërbime 99.93%, komunal 100.00%, subvencione 99.97 dhe investimet kapitale me 99.77%.

**SHPENZIMET NGA TË HYRAT VETANAKE SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE
DHE PROGRAMEVE PËR JANAR - DHJETOR TË VITIT 2025, FB 21**

rogramet	Paga dhe shtesa	Mallra dhe shërbime	Komunali	Subvencione	Investime kapitale	Totali
ZYRA E KRYETARIT				99974.16		99,974.16
ADMINISTRATA DHE PERSONELI		338,680.45				338,680.45
ZYRA E PROKURIMIT						0.00
ZYRA E KUVENDIT						0.00
BUXHETI DHE FINANCA		299,104.80				299,104.80
SHËRBIME PUBLIKE, M.C. DHE EMERGJENCA		540,474.20		324990	359,993.33	1,225,457.53
INFRASTRUKTURA PUBLIKE		22,510.57			2,939,305.08	2,961,815.65
ZYRA E KUMUNITETEVE						0.00
BUJQESIA DHE PYLLTARIA		99,936.50		499965.04	379,999.00	979,900.54
ZHVILLIM EKONOMIK		158,283.22		199669.75	70,000.00	427,952.97
KADASTRA DHE GJEODEZIA						0.00
PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS		100,000.00			349,908.94	449,908.94
SHËNDETSIA		149,990.73		274984		424,974.73
SHERBIMET SOCIALE						0.00
SHERBIMET REZIDENCIALE						0.00
KULTUR, RINI DHE SPORT		89,998.19		112,213.04	361,584.48	563,795.71
ARSIM		199,968.99				199,968.99
GJITHSEJ	0.00	1,998,947.65	0.00	1,511,795.99	4,460,790.83	7,971,534.47

Buxheti nga të hyrat vetanake dhe shpenzimi sipas kategorive ekonomike Janar –Dhjetor viti 2025

Kategoria ekonomike	Buxheti	Shpenzimi	Diferenca	% E shpenzimit
	1	2	3=(1-2)	4=(2/1*100)
Paga dhe shtesa				
Mallra dhe shërbime	1,999,986.00	1,998,947.65	1,038.35	99.95
Komunali				
Subvencione	1,512,254.00	1,511,795.99	458.01	99.97
Investime kapitale	4,462,066.00	4,460,790.83	1,275.17	99.97
Totali	7,974,306.00	7,971,534.47	2,771.53	99.97

Shpenzimi i të hyrave vetanake të vitit 2025 për nga vlera dhe përqindja janë të përafërta me planin.

**SHPENZIMET NGA TË HYRAT VETANAKE TË BARTURA SIPAS KATEGORIVE
EKONOMIKE DHE PROGRAMEVE PËR JANAR - DHJETOR TË VITIT 2025, FB 22**

Programet	Paga dhe shtesa	Mallra dhe shërbime	Komunali	Subvencion e	Investime kapitale	Totali
ZYRA E KRYETARIT				99800		99,800.00
ADMINISTRATA DHE PERSONELI		249,999.99	150,000.00			399,999.99
ZYRA E PROKURIMIT						0.00
ZYRA E KUVENDIT						0.00
BUXHETI DHE FINANCA		201,174.29				201,174.29
SHËRBIME PUBLIKE, M.C. DHE EMERGJENCË					150,000.00	150,000.00
INFRASTRUKTURA PUBLIKE						0.00
ZYRA E KOMUNITETEVE						0.00
BUJQËSIA						0.00
ZHVILLIM EKONOMIK					241,594.00	241,594.00
KADASTRI DHE GJEODEZIA						0.00
PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS						0.00
SHËNDETËSIA		249,520.00		93980		343,500.00
SHËRBIMET SOCIALE						0.00
SHËRBIMET REZIDENCIALE						0.00
KULTURË, RINI DHE SPORT					40,000.00	40,000.00
ARSIM		249,978.00		550000		799,978.00
GJITHSEJ	0.00	950,672.28	150,000.00	743,780.00	431,594.00	2,276,046.28

**Buxheti nga të hyrat vetanake të bartura dhe shpenzimi sipas kategorive ekonomike Janar -
Dhjetor viti 2025**

Kategoria ekonomike	Buxheti	Shpenzimi	Diferenca	% e shpenzimit
	1	2	3=(1-2)	4=(2/1*100)
Paga dhe mëditje			0	
Mallra dhe shërbime	951,175.28	950,672.28	503.00	99.95
Komunali	150,000.00	150,000.00	0.00	100.00
Subvencione	744,000.00	743,780.00	220.00	99.97
Investime kapitale	431,927.00	431,594.00	333.00	99.92
Totali	2,277,102.28	2,276,046.28	1,056.00	99.95

Nga totali i të hyrat të bartura kemi shpenzime, mallra dhe shërbime 99.95%, komunal 100.00%, Subvencionet 99.97% dhe nga investime kapitale 99.92%, mjetet e pa shpenzuar në vlerë 1,056.00€ barten në vitin 2026.

Buxheti nga të hyrat e donatorëve, shpenzimi sipas kategorive ekonomike dhe % e shpenzimit Janar-Dhjetor viti 2025

Kategoria ekonomike	Buxheti	Shpenzimi	Diferenca	% E shpenzimit
	1	2	3=(1-2)	4=(2/1*100)
Paga dhe shtesa	6,577.15	4,374.04	2,203.11	66.50
Mallra dhe shërbime	4,779.86		4,779.86	
Komunali	632.85		632.85	
Subvencione				
Investime kapitale	13,709.43		13,709.43	
Totali	25,699.29	4,374.04	21,325.25	17.02

Vlera e mjeteve të pa shpenzuara të grantit të donatorëve bartet në vitin 2026.

SHPENZIMET NGA FB 10-22 SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE DHE PROGRAMEVE PËR JANAR -DHJETOR TË VITIT 2025


Programet	Paga dhe shtesa	Mallra dhe shërbime	Komunali	Subvencione	Investime kapitale	Totali
ZYRA E KRYETARIT	335,273.97	154,414.99	0.00	199,774.16	0.00	689,463.12
ADMINISTRATA DHE PERSONELI	356,319.75	2,549,994.71	642,744.35	0.00	0.00	3,549,058.81
ZYRA E PROKURIMIT	40,378.14	0.00	0.00	0.00	0.00	40,378.14
ZYRA E KUVENDIT	380,080.91	20,583.39	0.00	0.00	0.00	400,664.30
BUXHETI DHE FINANCA	295,224.54	649,724.90	0.00	0.00	0.00	944,949.44
SHËRBIME PUBLIKE, M.C. DHE E	387,001.67	2,340,463.42	4,677.30	324,990.00	1,439,496.89	4,496,629.28
INFRASTRUKTURA PUBLIKE	68,351.78	172,485.18	0.00	0.00	7,382,368.14	7,623,205.10
ZYRA E KUMUNITETEV	119,113.79	10,360.95	0.00	0.00	0.00	129,474.74
BUJQSIA DHE PYLLTARIA	44,908.85	599,935.88	0.00	499,965.04	499,999.00	1,644,808.77
ZHVILLIM EKONOMIK	79,583.87	458,019.13	0.00	199,669.75	391,594.00	1,128,866.75
KADASTRA DHE GJEODEZIA	146,732.92	10,361.00	0.00	0.00	0.00	157,093.92
PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS	89,413.04	299,816.00	0.00	0.00	979,519.94	1,368,748.98
SHËNDETSIA	3,372,543.57	1,549,209.66	79,998.78	368,964.00	473,999.00	5,844,715.01
SHERBIMET SOCIALE	109,288.40	42,605.66	4,677.30	0.00	0.00	156,571.36
SHERBIME REZIDENCIALE	86,550.44	77,363.87	10,394.00	0.00	294,893.80	469,202.11
KULTUR, RINI DHE SPORT	503,323.26	261,241.31	0.00	149,871.71	437,099.45	1,351,535.73
ARSIM	15,917,811.58	1,748,276.01	127,199.18	1,049,927.06	842,119.42	19,685,333.25
GJITHSEJ	22,331,900.48	10,944,856.06	869,690.91	2,793,161.72	12,741,089.64	49,680,698.81

Në këtë tabelë nuk janë përfshirë shpenzimet nga të hyrat e donatorëve.

SHPENZIMET SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE FB 10-22 DHE PËRQINDJA

Kategoria ekonomike	Buxheti	Shpenzimi	Diferenca	% E shpenzimit
	1	2	3=(1-2)	4=(2/1*100)
Paga dhe shtesa	22,334,037.15	22,331,900.48	2,136.67	99.99
Mallra dhe shërbime	10,952,298.28	10,944,856.06	7,442.22	99.93
Komunali	869,694.00	869,690.91	3.09	100.00
Subvencione	2,794,000.00	2,793,161.72	838.28	99.97
Investime kapitale	12,760,761.00	12,741,089.64	19,671.36	99.85
Totali	49,710,790.43	49,680,698.81	30,091.62	99.94

Në këtë tabelë nuk janë të përfshira buxheti dhe shpenzimet nga donatorët.



Buxheti , shpenzimi , buxheti i mbetur dhe përqindjet në programe

Programet	Buxheti i miratuar	Shpenzimi i buxhetit	Buxhet I mbetur	% e shpenzimit të buxhetit	% e shpenzimit të buxhetit në total të shpenzimit
ZYRA E KRYETARIT	690,658.97	689,463.12	1,195.85	99.83	1.39
ADMINISTRATA D	3,549,064.10	3,549,058.81	5.29	100.00	7.14
ZYRA E PROKURIM	40,378.14	40,378.14	0.00	100.00	0.08
ZYRA E KUVENDIT	400,802.21	400,664.30	137.91	99.97	0.81
BUXHETI DHE FINA	946,399.82	944,949.44	1,450.38	99.85	1.90
SHËRBIME PUBLIK	4,503,104.97	4,496,629.28	6,475.69	99.86	9.05
INFRASTRUKTURA	7,630,179.78	7,623,205.10	6,974.68	99.91	15.34
ZYRA E KUMUNITET	129,474.79	129,474.74	0.05	100.00	0.26
BUJQSIA DHE PYLL	1,644,908.85	1,644,808.77	100.08	99.99	3.31
ZHVILLIM EKONOMI	1,129,813.87	1,128,866.75	947.12	99.92	2.27
KADASTRA DHE GJ	157,093.92	157,093.92	0.00	100.00	0.32
PLANIFIKIM URBA	1,369,413.04	1,018,840.04	350,573.00	74.40	2.05
SHËNDETSIA	5,846,543.20	5,844,715.01	1,828.19	99.97	11.76
SHERBIMET SOCIA	156,582.57	156,571.36	11.21	99.99	0.32
SHERBIME REZIDE	469,651.94	469,202.11	449.83	99.90	0.94
KULTUR, RINI DHE	1,355,958.26	1,351,535.73	4,422.53	99.67	2.72
ARSIM	19,690,762.00	19,685,333.25	5,428.75	99.97	39.62
GJITHSEJ	49,710,790.43	49,680,698.81	30,091.62	99.94	100.00

Shpenzimi sipas burimit të financimit dhe % në pjesmarrje të shpenzimit

BURIMET E FINANCIMIT	SHPENZIMI	% NË TOTAL TË SHPENZIMIT
GRANTI QEVERITAR	39,433,118.06	79.37
HYRAT VETANAKE	7,971,534.47	16.05
HYRAT VETANAKE TË BARTURA	2,276,046.28	4.58
GJITHSEJT	49,680,698.81	100.00

Krahasimi i shpenzimeve buxhetore të viteve 2025 me 2024 sipas programeve

Programet	Viti 2024	Viti 2025	Diferenca	%
	1	2	3=2-1	4=2/1*100
ZYRA E KRYETARIT	505,752.00	689,463.12	183,711.12	136.32
ADMINISTRATA DHE PERSONELI	2,644,125.19	3,549,058.81	904,933.62	134.22
ZYRA E PROKURIMIT	34,216.96	40,378.14	6,161.18	118.01
ZYRA E KUVENDIT	377,246.35	400,664.30	23,417.95	106.21
BUXHETI DHE FINANCA	600,553.17	944,949.44	344,396.27	157.35
SHËRBIME PUBLIKE, M.C. DHE E	4,953,393.75	4,496,629.28	-456,764.47	90.78
INFRASTRUKTURA PUBLIKE	6,384,041.10	7,623,205.10	1,239,164.00	119.41
ZYRA E KUMUNITETEVE	100,973.54	129,474.74	28,501.20	128.23
BUJQESIA DHE PYLLTARIA	1,725,813.82	1,644,808.77	-81,005.05	95.31
ZHVILLIM EKONOMIK	503,513.69	1,128,866.75	625,353.06	224.20
KADASTRA DHE GJEODEZIA	130,907.73	507,002.86	376,095.13	387.30
PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS	777,863.72	1,018,840.04	240,976.32	130.98
SHËNDETSIA	4,880,820.71	5,844,715.01	963,894.30	119.75
SHERBIMET SOCIALE	120,258.61	156,571.36	36,312.75	130.20
SHERBIMET REZIDENCIALE	354,010.36	469,202.11	115,191.75	132.54
KULTUR, RINI DHE SPORT	1,431,028.41	1,351,535.73	-79,492.68	94.45
ARSIM	17,395,568.55	19,685,333.25	2,289,764.70	113.16
GJITHSEJ	42,920,087.66	49,680,698.81	6,760,611.15	115.75

Krahasimi i shpenzimeve buxhetore të vitit 2025 me vitin 2024 është bërë vetëm me burimet e financimit: Grant qeveritar, Të hyrat vetanake dhe të hyrat vetanake të bartura.

Sektori për Buxhet dhe Financa

Në bazë të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi dhe Ligjit për financat lokale, aktivitetet që ka kryer ky sektor gjatë vitit 2025 përfshijnë:

- Përgatitja e raporteve periodike financiare,
- Përgatitja e Pasqyrës Financiare për vitin 2024,
- Përgatitja e listës së projekteve për bartje të buxhetit në vitin 2025,
- Nënshkrimi i të gjithave pagesave-transaksioneve financiare,
- Zotimi i mjeteve dhe plotësimi i formularëve në sistemin Free Balance,
- Pranimi dhe regjistrimi i faturave (obligim-pagesë),
- Regjistrimi i të hyrave nga inkasimi ditor
- Regjistrimi i të hyrave vetanake në sistemin Free Balance dhe në programin softuerik,
- Barazimet mujore me Departamentin e Thesarit-Ministria e Financave,
- Pranim-dorëzimi i parasë së imët në arkë dhe regjistrimi në ditarin e arkës,
- Pagesa e faturave të imëta me para të gatshme,
- Alokimi i të hyrave dhe balancimi i tyre me shpenzimet,
- Përgatitja e procesit të rrjedhës së parasë,
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028,
- Përgatitja e propozim Buxhetit për vitin 2026-2028,
- Regjistrimi i të dhënave buxhetore në programin BDMS dhe PiP,
- Ofrimi i të dhënave buxhetore për ekipin e auditimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

Hyrje

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit funksionimin e saj e ka të përkushtuar në ofrimin e shërbimeve profesionale në fushën urbanistike dhe mjedisore për të gjithë qytetarët duke vepruar në përputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.

Fokusi gjatë kësaj periudhe kohore në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit, ka qenë në dinamizmin e punëve në mënyrë që mos të kemi ngecje në hartimin e Dokumenteve të Planifikimit.

Plani i punës për vitin 2025 ka pasur këto pika.

1. Fillimi i procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033;
2. Vazhdimi i punimeve për rregullimin e parkut “Liria”;
3. Vazhdimi i punimeve për rregullimin e parkut “Kodra e Sherreteve”;
4. Vazhdimi i punimeve për rregullimin e parqeve në zonën urbane dhe rurale përmes konceptit të pocket park;
5. Fillimi i punimeve për rregullimin e parkut të objekti ekzistues i KRM Pastërtia;
6. Përgatitja e raporteve për leje ndërtimore për palët që kanë bërë kërkesë;
7. Përgatitja e raporteve për kushte ndërtimore për palët që kanë bërë kërkesë;
8. Përgatitja e raporteve për leje mjedisore për palët që kanë bërë kërkesë;
9. Përgatitja e raporteve për leje për legalizim për palët që kanë bërë kërkesë;
10. Shqyrtimi i kërkesave dhe kthimi i përgjigjeve për qytetarët në lidhje me kërkesat tjera që kanë të bëjnë me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit (kërkesat për pëlqime për shfrytëzim të hapësirës publike, pëlqime për gropim, kërkesa për informata etj.)
11. Takime të rregullta me qytetarë.

Raporti i punës

Bazuar në planin e punës, janë realizuar shumica e objektivave të parapara me këtë plan për vitin 2025, edhe pse krahasuar me numrin dhe natyrën e kërkesave Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit ka numër të kufizuar të punëtorëve në të gjitha sektorët.

Në fund të vitit 2025, pas përmbylljes së fazave të tenderimit dhe përzgjedhjes së kompanisë që do të asistoj Komunën e Ferizajt në hartimin e dokumentit, kemi filluar procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2025–2033. Gjatë vitit 2025 është realizuar analiza e gjendjes, e cila përbën fazën e parë të hartimit të këtij dokumenti.

- Gjatë vitit 2025, në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit, për leje ndërtimore kanë aplikuar 193 qytetarë, institucione dhe biznese, janë pajisur me leje ndërtimore 151 qytetarë të cilët kanë paraqitur kërkesë në këtë drejtori, në proces janë 42 lëndë.

- Gjatë vitit 2025 në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit janë dorëzuar 214 kërkesa për kushte ndërtimore, nga të cilat janë pajisur me kushte ndërtimore 138 qytetarë, institucione dhe biznese, nga këto 30 lëndë janë në proces, ndërsa janë refuzuar 46 kërkesa si të pa kompletuara dhe që nuk i kanë plotësuar kriteret dhe normat teknike.

- Me leje mjedisore komunale janë pajisur 53 qytetarë, nga 62 që kane bërë kërkesë pranë Drejtorisë së Mjedisit dhe Urbanizmit.
- Mungesa e stafit ka shkaktuar telashe në procesin e legalizimit, gjithsesi gjatë vitit 2025 me vazhdimin e afatit të ligjit për procesin e legalizimit ka vazhduar pranimi i kërkesave të reja për procesin e legalizimit ku janë pranuar gjithsej 542 kërkesa, ndërsa janë përfunduar 161 objekte me procesin e legalizimit, kryesisht lëndë të cilat janë pranuar më herët.
- Kërkesat për pëlqime për shfrytëzim të hapësirës publike, pëlqime për rregullim të infrastrukturës, kërkesa për informata në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit, kërkesa për vendosjen e paneleve solare janë pranuar 505 kërkesa, nga të cilat janë dhënë informatat për 61 qytetarë, janë lëshuar 97 pëlqime për rregullim të infrastrukturës dhe janë dhënë 182 pëlqime për shfrytëzim të hapësirës publike, ndërsa 165 kërkesa janë në proces.
- Gjatë vitit 2025 janë bërë pranime teknike për 183 objekte që kanë aplikuar pranë DUM nga të cilat 180 janë pajisur me pranime teknike.

Raporti i përfundimit të projekteve infrastrukturore-mjedisore

Ka vazhduar me punime projekti për rregullimin e parkut në Kodrën e Sherretëve, sipas planit të paraparë në fillim të vitit 2025, janë përfunduar punimet e shtigjeve të ecjes-vrapimit si dhe vendosja e strukturës për pikën e vrojtimit, janë përfunduar afërsisht mbi 70% e punimeve të parapara në këtë projekt.

Po ashtu kanë vazhduar punimet në rregullimin e parkut “Liria”, ku është përfunduar hapja e rrugëve, asfaltimi i hapësirave të parkingut dhe është përfunduar vendosja e ndriçimit publik në pjesën e zgjerimit të këtij parku, projekt në cilin janë përfunduar rreth 60% e punimeve.

Kemi vazhduar me konceptin “Pocket Park” në zonat urbane dhe rurale, përmes të cilit janë mbjellë mbi 3000 drunj dekorativ gjatë vitit 2025, gjithashtu kemi filluar një projekt tjetër shumë të rëndësishëm, atë të ndërtimit të parkut të ri të ish objekti i Stacionit të Autobusëve, e po ashtu kemi vazhduar me punime për ndërtimin e parkut të ish objekti i Ndërmarrjes “Pastërtia”.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

Raporti i punës për vitin 2025 – Drejtoria e Infrastrukturës

Drejtoria e Infrastrukturës gjatë vitit 2025 ka zhvilluar një sërë projektsh infrastrukturore me rëndësi strategjike, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e qarkullimit, rritjen e sigurisë rrugore dhe lehtësimin e lidhjeve ndërmjet zonave urbane dhe rurale. Këto projekte përfshijnë ndërtimin dhe zgjerimin e rrugëve, rikonstruktimin e segmenteve ekzistuese, trotuareve, kanalizim fekal dhe atmosferik, ujësjellës dhe ndriçimit publik si dhe përmirësimin e infrastrukturës përcjellëse.

Projektet e realizuara nga Drejtoria e Infrastrukturës:

- Ndërtimi i nënkalimit për vetura dhe këmbësor afër Stacionit Policor, filloj implementimin në vitin 2023, deri më tani janë punuar mbi 80% e vlerës së punimeve. Nënkalimi është lëshuar për përdorim nga qytetarët, është punuar edhe në pjesën e platos, ka mbetur vetëm finalizimi i pllakave në plato, mbjellja e drunjve dekorativ dhe rregullimi i hapësirave gjelbëruese.
- Ndërtimi i Qendrës Multifunkionale – projekti u ri iniciua në vitin 2025, dhe ka filluar menjëherë në instalime të brendshme dhe deri në fund të vitit janë realizuar mbi 20% të punimeve.
- Rikonstruktimi i ndriçimit publik, punët e realizuara gjatë vitit 2025:

Gjatë vitit 2025 ka vazhduar puna me një intensitet të shtuar në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik në rrugët dhe hapësirat ku ka qenë e nevojshme. Më poshtë në formë tabelore gjeni në pozicione të ndryshme të shtyllave dhe trupave ndriçues punët e realizuar në ndriçim gjatë vitit 2025, ku si tërësi janë kryer 19.62km linjë ndriçimi me gjithsej 654 trupa ndriçues.

Në tabelën që vijon, numri i trupave ndriçues LED dhe llojet e kabllave të instaluar:

1	Trup ndriçues LED 50W	541	copë
2	Trup ndriçues LED 80-100W	83	copë
3	Trup ndriçues LED 150W	30	copë
4	Lira njëkrahëshe	618	copë
5	Shtylla metalike 6m	215	copë
6	Shtylla metalike 5.5m	145	copë
7	Kabllo 1x16 (mm ²)	1651	m
8	Kabllo 2x16 (mm ²)	15360	m
9	Kabllo 3x16 (mm ²)	1295	m
10	Kabllo 4x16 (mm ²)	1354	m

- Drejtoria e Infrastrukturës gjatë vitit 2025 nga të gjitha punët që ka arritur t'i finalizoj ka arritur këto rezultate pune, si në vijim: rrugë të asfaltuara 414,396.35 m², rrjet të ujësjellësit 21,828.00 m', rrjet të kanalizimit fekal 8,929.43m' rrjet të kanalizimit atmosferik 15,190.00m', trotuare 6,550.80m' dhe shtigje biçikletash 2,194.50m'.

Të gjitha këto janë të paraqitura në detaje në formë tabelore si më poshtë:

Punët e realizuara në vitin 2025							
Projekti		Ujësjellës në m'	Kanalizim fekal në m'	Kanalizim atmosferik në m'	Asfalt m2	Trotuar m'	Shteg i Bicikletave m'
Asfaltimi i rrugëve ne Pleshinë					16,987.54 m2		
Asfaltimi i rrugëve në Lloshkobare dhe Saraishtë					9,278.00 m2		
Asfaltimi i rrugës "Tahir Sinani"					2,285.00 m2	425.00 m'	
Asfaltimi i rrugës "Cen Dugolli"					2,937.56 m2		
Asfaltimi i rrugës "Brigada 161"	Shtresa e I-rë BZH 22 t=7cm				3,689.00 m2		
	Shtresa e II-të AB 11 t=4cm				3,689.00 m2		
					7,378.00 m2	520.00 m'	254.50 m'
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Zllatar dhe Dardani					19,840.00 m2		
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Sojevë					12,230.00 m2		
Rikonstruimi i rrugës "Besim Rexhepi" në Ferizaj				417.00 m'	2,778.00 m2	480.00 m'	240.00 m'
Asfaltimi i rrugëve Balaj					6,040.00 m2		
Asfaltimi i rrugëve Zaskok					13,053.00 m2		
Asfaltimi i rrugës "Bedri Asllani"	Shtresa e I-rë BZH 22 t=7cm			265.00 m'	660.00 m2		
	Shtresa e II-të AB 11 t=4cm				660.00 m2		
				265.00 m'	1,320.00 m2		
Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Dardani, Sojeve, Komogllave dhe Zllatar			6,496.43m'				
Ndërtimi i trotuarit Dremjak dhe Manastirc						828.00m'	
Asfaltimi i rrugëve në Nerodime					8,857.00 m2		
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Prelez i Jerlive					18,906.00 m2		
Ndërtimi i nënkallimit për vetura dhe këmbësorë afër stacionit policor në Ferizaj		858.00 m'	700.00 m'	2,852.00m'	47,950.00 m2	2,739.80 m'	1,700.00 m'
Asfaltimi i rrugëve në lagjet Nuhaj dhe Hajdari në fshatin Komogllavë					7,221.00 m2		
Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Fshat i Vjeter dhe Bëbaj					10,027.00 m2		
Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në rrugën Sadik Bega			323.00 m'				
Pjesëmarrja në projekte me donator, ujësjellës në fshatin Sojevë, Dardani - Faza - II-		5,450.00 m'					
Rikonstruimi i rrugës kryesore në fshatin Varosh				1,400.00 m'	11,000.00 m2	1,325.00 m'	
Ndërtimi i kolektorit Nikadin - Gerlicë				1,100.00 m'			
Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Pojatë					7,800.00 m2		
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Rahovicë					12,380.00 m2		
Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Talinoc i Muhaxherëve					7,420.00 m2		
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Jezerc					10,850.00 m2		

Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe asfaltimi i rrugëve në zonën I, II, III dhe IV në Ferizaj	Zona e I-rë				3,276.98 m2		
	Zona e II-rë				4,555.00 m2		
					7,831.98 m2		
Asfaltimi i rrugës Pleshinë - Kashtanjevë					29,635.00 m2		
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Mirash					4,000.00 m2		
Rikonstruimi i rrugës Varosh - Gërlaç	Shtresa e I-rë BZH32 t=9cm				2,406.00 m2	233.00 m'	
	Shtresa e II- të BZH 22 t=7cm				2,895.97 m2		
	Shtresa III-të AB 11 t=4cm				54,652.00 m2		
	Rruga "Azem Hoxha" dhe rrugicat rreth saj				7,544.30 m2		
					67,498.27 m2	233.00 m'	
Asfaltimi i rrugës kryesore në Kosiinë					8,500.0 m2		
Rregullimi i ujës-jellësit në fshatin Rakaj		13,770.00 m'					
Zgjerimi i rrugës në fshatin bibaj - kyqja në autostradën "Arbën Xhaferi"	Shtresa e I-rë BZH32			1,886.00 m'	20,140.00 m2		
	Shtresa e II- të BZH 22				14,994.00 m2		
					35,134.00 m2		
Asfaltimi i rrugës Talinoc i Muhaxherëve - Bibaj		1,750.00 m'	1,410.00 m'	1,920.00 m'			
Rikonstruimi i rrugës Ferizaj - Pleshinë				1,450.00 m'			
Asfaltimi i rrugës Babush i ri - Cemillë - Surqinë - Mirash				3,900.00 m'	25,259.00m2		
Totali:		21,828.00 m'	8928.43 m'	15,190.00 m'	414,396.35 m2	6,550.80 m'	2,194.50 m'



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TURIZMIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

Hyrje

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit është kompetente për ofrimin e shërbimeve të përgjithshme për bizneset, për qytetarët dhe për partnerët ndërkombëtar duke u zotuar për ofrimin e shërbimeve dhe mundësive për zhvillim ekonomik dhe turizëm dhe referuar vendit dhe rolit që ka në këtë moment turizmi në Ferizaj.

Përmes:

- Dhënies së pronave të komunës në shfrytëzime afatgjatë dhe afatshkurtër
- Krijimi i zonave industriale
- Krijimi i zonave ekonomike
- Krijimi i zonave turistike
- Bashkëpjesëmarrës në financimin me partnerë ndërkombëtar dhe vendor
- Dhënia e subvencioneve për biznese
- Krijimi i politikave dhe dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik
- Promovimi i turizmit dhe bizneseve

Komuna e Ferizajt, përmes politikave të saj zhvillimore dhe angazhimit të vazhdueshëm institucional, ka ndërmarr një sërë veprimesh konkrete me qëllim të nxitjes së zhvillimit ekonomik lokal, forcimit të sektorit privat, promovimit të turizmit dhe rritjes së përfshirjes sociale. Aktivitetet e realizuara reflektojnë vizionin e qeverisjes lokale për një Ferizaj të zhvilluar, konkurrues dhe atraktiv për investime, vizitorë dhe qytetarë, duke u bazuar në bashkëpunim të ngushtë me partnerë vendor dhe ndërkombëtar.

Aktivitetet e Realizuara

1. Ndërtimi i Via Ferratës dhe Urës Tibetiane në Jezerc

Në kuadër të zhvillimit të turizmit aventuror, Komuna e Ferizajt ka realizuar projektin e Via Ferratës dhe Urës Tibetiane në zonën turistike të Jezercit, në bashkëpunim me organizatën SwissContact. Ky investim strategjik synon të shfrytëzoj potencialin natyror të zonës dhe ta shndërroj atë në një destinacion të rëndësishëm për turizmin malor. Projekti pritet të ndikoj drejtpërdrejt në rritjen e numrit të vizitorëve, krijimin e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin e ekonomisë lokale.

2. Mbështetja Financiare për Bizneset përmes Skemës së Granteve

Gjatë vitit 2025, Komuna e Ferizajt ka vazhduar zbatimin e politikave aktive për mbështetjen e sektorit privat, duke ofruar përkrahje financiare direkte përmes skemave të granteve. Fokus i veçantë i kësaj mbështetjeje kanë qenë bizneset në pronësi të grave, bizneset startup dhe mikro-ndërmarrjet, si kategori kyçe për zhvillimin ekonomik dhe përfshirjen sociale. Në kuadër të kësaj skeme, janë subvencionuar rreth 100 përfitues me nga 2,000 euro secili, mjete këto të dedikuara për blerjen e pajisjeve të punës në sektorin prodhues dhe përpunues. Ky investim ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve prodhuese, modernizimin e proceseve të punës, krijimin e vendeve të reja të punës dhe forcimin e qëndrueshmërisë së bizneseve lokale në Komunën e Ferizajt.

3. Organizimi i Panairit të Bizneseve Artizanale

Komuna e Ferizajt ka vazhduar mbështetjen për bizneset artizanale përmes organizimit tradicional të panairit dy herë në vit. Ky aktivitet ka shërbyer si platformë e rëndësishme për promovimin e produkteve vendore, rritjen e shitjes dhe fuqizimin ekonomik të prodhuesve artizanal. Panairi kontribuon në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe krijon mundësi të reja për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

4. Hapja dhe Mirëmbajtja e Shtigjeve të Reja Malore

Në bashkëpunim me shoqatat bjeshkatore, Komuna ka hapur shtigje të reja malore dhe ka investuar në mirëmbajtjen e atyre ekzistuese. Ky angazhim institucional synon të zhvillojë turizmin malor dhe të promovojë Ferizajn si destinacion për aktivitete në natyrë. Shtigjet e reja krijojnë mundësi për vizitorë vendas dhe të huaj, duke ndikuar pozitivisht në ekonominë lokale dhe në promovimin e jetesës aktive.

5. Organizimi i Takimit B2B

Për herë të parë në Komunën e Ferizajt u organizua takimi B2B mes bizneseve të diasporës dhe bizneseve vendore. Ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt institucionalizimit të bashkëpunimit ekonomik me diasporën. Qëllimi kryesor ishte krijimi i partneriteteve të reja, shkëmbimi i përvojave dhe nxitja e investimeve direkte në komunë.

6. Takimi i Fundvitit me Bizneset e Diasporës

Në kuadër të ruajtjes së marrëdhënieve të qëndrueshme me diasporën, Komuna e Ferizajt ka organizuar tradicionalisht takimin e fundvitit me bizneset e diasporës. Ky aktivitet shërben si shenjë falënderimi për kontributin e tyre ekonomik dhe social, si dhe si platformë për prezantimin e mundësive të reja investuese. Komuna riafirmon përkushtimin për të qenë partnere e besueshme e diasporës.

7. Organizimi i Ecjeve Malore

U organizuan ecje malore në bashkëpunim me shoqatat bjeshkatore të Ferizajt, me synim promovimin e turizmit aktiv dhe natyror. Ky aktivitet ka rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe ka promovuar potencialin turistik të zonave malore. Njëkohësisht, ka ndikuar në përfshirjen e qytetarëve në aktivitete rekreative dhe sociale.

8. Krijimi dhe Publikimi i Videospoteve Turistike

Komuna ka investuar në krijimin e videospoteve promovuese për zonat rurale dhe turistike të Ferizajt. Këto materiale janë shpërndarë në rrjete sociale dhe portale informative, duke rritur dukshmërinë e komunës si destinacion turistik. Kjo qasje moderne e promovimit synon të tërheq vizitorë dhe investitorë potencial.

9. Trajnime për Fuqizimin e Grave

U organizuan trajnime profesionale në fushën e rrobaqepësisë, dizajnit dhe gjuhës angleze, ku përfituan rreth 40 gra nga Komuna e Ferizajt. Këto trajnime janë pjesë e politikave për barazi gjinore dhe fuqizim ekonomik të grave. Përmes aftësimit profesional, gratë përfituese rrisin mundësitë për punësim dhe vetëpunësim.

10. Aktiviteti i Lëshimit me Litar (Rappelling)

Në bashkëpunim me alpinistë nga Ferizaj dhe Prishtina u organizua një aktivitet simbolik dhe argëtues i lëshimit me litar nga objekti i Komunës. Aktiviteti, i realizuar me veshje të super heronjve, kishte karakter promovues dhe social, duke sjellë gëzim për fëmijët dhe qytetarët. Ky organizim dëshmon përkushtimin e komunës për aktivitete kreative dhe përfshirëse.

11. Inspektimi dhe Mirëmbajtja e Via Ferratës

Komuna ka realizuar inspekte të rregullta të Via Ferratës për të garantuar sigurinë e vizitorëve dhe funksionalitetin e saj. Këto veprime tregojnë përgjegjësinë institucionale për mirëmbajtjen e investimeve publike. Siguria dhe standardet e larta janë prioritet në zhvillimin e turizmit aventuror.

12. Tryeza me Odat Ekonomike dhe Shoqatat e Turizmit dhe Bjeshkatarisë

Komuna e Ferizajt organizoi tryeza të përbashkëta me odat ekonomike, shoqatat e turizmit dhe bjeshkatarisë me qëllim të koordinimit institucional për projektet zhvillimore. Ky takim shërbeu për identifikimin e nevojave prioritare dhe për harmonizimin e veprimeve në funksion të zhvillimit ekonomik dhe turistik. Përmes dialogut të hapur u krijua bazë e qëndrueshme për bashkëpunim afatgjatë ndërmjet sektorit publik dhe atij privat.

13. Organizimi i Simpoziumeve Shkencore mbi Zhvillimin Ekonomik

U organizuan simpoziume shkencore me fokus në zhvillimin ekonomik lokal dhe perspektivat e Komunës së Ferizajt. Në këto aktivitete morën pjesë ekspertë, akademikë dhe përfaqësues institucional, të cilët kontribuan me analiza dhe rekomandime konkrete. Gjetjet nga simpoziumet shërbejnë si bazë profesionale për hartimin e politikave dhe planeve strategjike të Komunës.

14. Përzgjedhja e Bizneseve më të Suksesshme të Vitit

Komuna e Ferizajt ka organizuar ceremoninë për përzgjedhjen dhe vlerësimin e bizneseve më të suksesshme të vitit. Janë shpërblyer me mirënjohje eksportuesit më të mëdhenj, bizneset me qarkullimin më të lartë financiar dhe ato me numrin më të madh të të punësuarve. Ky aktivitet synon të motivoj sektorin privat, të promovoj kulturën e suksesit dhe të krijoj modele pozitive për zhvillimin ekonomik lokal.

15. Tryeza me Donatorë dhe Partnerë Ndërkombëtarë

U organizua një tryezë e veçantë me përfaqësues të ambasadave dhe organizatave vendore e ndërkombëtare. Gjatë takimit u prezantua Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Ferizajt, si dhe projektet që rrjedhin nga kjo strategji. Ky aktivitet forcon transparencën, rrit besueshmërinë institucionale dhe hap rrugë për bashkëpunime dhe investime të reja zhvillimore.

16. Vendosja e Tabelave Informuese me QR Code në Lokacione Turistike

Në funksion të përmirësimit të informimit të vizitorëve, Komuna vendosi tabela informuese me QR Code në lokacione turistike të Ferizajt. Përmes kësaj qasjeje digjitale, vizitorët kanë qasje të menjëhershme në informata për atraksionet turistike. Ky veprim pasqyron orientimin e Komunës drejt inovacionit dhe promovimit modern të turizmit.

17. Trajnime për Persona me Aftësi të Kufizuara

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në bashkëpunim me OJQ Handikos organizoi trajnime profesionale për persona me aftësi të kufizuara, me qëllim rritjen e aftësive të tyre dhe integrimin në tregun e punës. Ky aktivitet është pjesë e politikave gjithëpërfshirëse dhe sociale të komunës. Përmes këtyre trajnimeve, Komuna kontribuon në barazi, dinjitet dhe pavarësi ekonomike për këtë kategori të shoqërisë.

18. Krijimi i Data bazës së Bizneseve të Komuniteteve Jo-Shumicë dhe Nxitja e Bashkëpunimit Ekonomik

Komuna e Ferizajt ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm drejt përfshirjes ekonomike dhe barazisë në zhvillim përmes krijimit të data bazës së bizneseve të komuniteteve jo-shumicë që veprojnë në territorin e komunës. Kjo data bazë shërben si instrument strategjik për evidentimin e kapaciteteve ekonomike, nevojave dhe potencialit zhvillimor të këtyre bizneseve. Në kuadër të këtij aktiviteti, janë organizuar takime ndërmjet bizneseve të komuniteteve jo-shumicë dhe bizneseve të zhvilluara në Ferizaj, me qëllim krijimin e mundësive për bashkëpunim, partneritete dhe integrim. Po ashtu, janë mbajtur trajnime profesionale për këto biznese, duke synuar rritjen e kapaciteteve menaxheriale, konkurrueshmërisë dhe përfshirjes së tyre të plotë në zhvillimin ekonomik lokal.

19. Takime me Bizneset e Diasporës dhe të Komuniteteve Jo-Shumicë

Komuna e Ferizajt ka organizuar takime të dedikuara me bizneset e diasporës dhe me bizneset vendore të komuniteteve jo-shumicë, me qëllim përfshirjen e tyre aktive në zhvillimin ekonomik lokal. Në kuadër të këtyre takimeve, Komuna ka prezantuar mundësitë konkrete për investime në Ferizaj, si dhe ka shprehur gatishmërinë institucionale për të ofruar përkrahje dhe lehtësime për iniciativat investuese të këtyre bizneseve.

20. Trajnime për Bizneset Startup në Bashkëpunim me Odën Ekonomike

Në bashkëpunim me Odën Ekonomike u organizuan trajnime për bizneset startup, me fokus në menaxhim, planifikim financiar dhe inovacion. Këto trajnime synojnë të krijojnë një ekosistem të favorshëm për ndërmarrësi dhe ide të reja biznesi. Komuna e Ferizajt mbështet aktivisht gjeneratat e reja të sipërmarrësve.

21. Evidentimi i Hoteleve dhe Bujtinave dhe Publikimi në Ueb faqen e Turizmit

U realizua evidentimi i të gjitha hoteleve dhe bujtinave në territorin e Komunës së Ferizajt. Të dhënat e tyre, së bashku me linkun e lokacioneve, u publikuan në ueb faqen zyrtare të turizmit. Ky aktivitet synon të përmirësojë informimin e vizitorëve dhe të rris transparencën dhe qasjen në ofertën akomoduese të komunës.

Qendra për Regjistrimin e Bizneseve

Gjatë vitit 2025 Qendra Komunale e Regjistrimit të bizneseve është bërë me platformën e re elektronike me numër unik identifikues të bizneseve ku ka pasur rritje të kërkesave dhe kjo do të vazhdojë edhe në vitin 2026. Me këtë platformë pronarët që kanë poseduar me shumë se një biznes individual, atyre ju është mundësuar që bizneset tjera t'i shndërrojnë në njësi, gjatë periudhës Janar-Dhjetor në QKRB dhe këto janë:

- Regjistrime të reja - **1087**
- Ndryshime në biznes - **520**
- Ç' regjistrime biznesi - **41**
- Informata biznesi - **1020**
- Vërtetime - **15**

Në Qendrën e Regjistrimit të Bizneseve gjatë periudhës 01.01.2025 deri me datën 31.12.2025 janë regjistruar gjithsej 1087 biznese të reja dhe gjatë kësaj periudhe janë gjithsej 1003 punëtorë të rinj.

Qendra e Regjistrimit të Bizneseve (QRB) në Ferizaj gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, sa i përket kërkesave të qytetarëve për regjistrimin e bizneseve dhe komunitetit të biznesit për ndërrim dhe shtim të aktiviteteve biznesore apo edhe shuarje të bizneseve. Sa i përket ç' regjistrimit të bizneseve, gjatë kësaj periudhe janë ç' regjistruar gjithsej 41 biznese.

Më poshtë gjeni të bashkangjitur tabelën ku është prezantuar raporti i vitit paraprak, i cili mund të shërbejë për të bërë krahasimin e situatës sa i përket numrit të bizneseve të regjistruara e të ç' regjistruara, përfshirë veprimtaritë si dhe numrin e punëtorëve.

Bizneset e Regjistruar		
Emërtimet	Viti 2024	Viti 2025
Prodhuese	71	209
Tregtare	548	540
Shërbyese	264	193
Ndërtimore	140	145
Gjithsej	1023	1087
Struktura Gjinore	Viti 2024	Viti 2025
Meshkuj	943	1034
Femra	309	300
Gjithsej	1252	1334
Sipas llojit të biznesit	Viti 2024	Viti 2025
SH.P.K.	805	861
B.I.	216	226
SH.A.	1	0
Dega në Kosovë	1	0
O.K	0	0
Gjithsej	1023	1087

Bizneset e ç' regjistruara		
Emërtimet	Viti 2024	Viti 2025
Prodhuese	4	10
Tregtare	41	20
Shërbyese	10	9
Ndërtimore	3	2
Gjithsej	58	41

Struktura Gjinore	Viti 2024	Viti 2025
Meshkuj	44	35
Femra	14	6
Gjithsej	58	41
Sipas llojit të biznesit	Viti 2024	Viti 2025
SH.P.K.	22	8
B.I.	36	33
SH.A.		0
Gjithsej	58	41



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E ARSIMIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

HYRJE

Drejtoria e Arsimit, përkundër sfidave të mëdha, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka, ka realizuar punë dhe detyra të shumta në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim dhe krijimit të kushteve më të mira në nivelin e arsimit para universitar, ku për vitin shkollor 2024/25, ka bërë një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm mbi ecurinë dhe performancën e procesit edukativo-arsimor, duke e analizuar suksesin e nxënësve për rezultatet dhe sukseset e arritura në të tri nivelet e arsimit para universitar, duke krahasuar rezultatet e suksesit me rezultatet e periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Përfundimi i vitit shkollor 2024-2025 është bërë në kushte të rregullta. Ndërsa viti i ri shkollor 2025-2026, ka filluar normalisht.

Drejtoria e Arsimit ka përcjellë nga afër ecurinë e procesit arsimor, duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale nga zyrtarët e arsimit, duke funksionalizuar dhe fuqizuar aktivet profesionale (seksionet), duke bashkëpunuar me institucionet dhe organizata të ndryshme për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe sigurimin e efikasitetit të procesit të mësimitdhënies dhe mësim nxënies dhe njëkohësisht në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim. Po ashtu, janë vlerësuar dhe analizuar rezultatet e testeve të jashtme të Provimit Shtetëror të Maturës si dhe Testi i Arritshmërisë për klasat IX-ta.

Kjo analizë bëhet jo vetëm për të konstatuar gjendjen, por edhe për të përcaktuar objektivat për të ardhmen, që do të reflektojnë pozitivisht në përmirësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve dhe ngritjen e cilësisë së mësimitdhënies në procesin edukativo-arsimor.

Drejtoria e Arsimit po punon në mënyrë të vazhdueshme për krijimin e kushteve më të mira me qëllim që cilësia dhe rezultatet e suksesit në shkollat tona të shënojnë progres dhe të arrijnë në nivelin dhe standardin e shkollave të përparuara, si në mësimitdhënie, mësim nxënie dhe të një vlerësimi sa më objektiv të arritshmërisë së nxënësve.

Raporti i organizimit të punës së Drejtorisë së Arsimit

Organizmi i punëve në Drejtorinë e Arsimit bëhet përmes sektorëve të saj:

- **Spektori i Administratës**
- **Spektori i Financave**
- **Spektori i Arsimit**
- **Spektori i Shërbimit Teknik**

Qëllimi i raportit vjetor është prezantimi i punës njëvjeçare i të gjitha institucioneve edukativo-arsimore, gjegjësisht paraqitet sukcesi, rezultatet, të arriturat, por edhe sfidat dhe vështirësitë që kanë përcjellë shkollat dhe procesin edukativo-arsimor në edukimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë në Komunën e Ferizajt, për vitin shkollor 2024-2025.

Drejtoria e Arsimit me kohë i ka planifikuar punët që duhet të kryhen dhe u ka kushtuar kujdes të veçantë, sidomos prioritetëve duke bërë përpjekje për shfrytëzim sa më racional të të gjitha resurseve të brendshme dhe të jashtme në shkollat tona.

Në raport janë përfshirë: rrjeti shkollor, lokali mësimor, nxënësit dhe paralelet, organizimi i mësimi, suksesi i nxënësve, mungesat e nxënësve, orët e mbajtura, aktivitetet jashtëkurrikulare etj. Pra, janë përfshirë të gjitha segmentet e punës dhe jetës në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Ferizajt.

Materialet bazë për hartimin e Raportit:

- Plani vjetor i punës së DA-së për vitin 2025;
- Raporti vjetor i punës së Sektorëve të Arsimit pranë DA-it për vitin 2025;
- Programet vjetore dhe periodike të punës së njësive pranë DA-së:
- Njësia e Administratës;
- Njësia e Financave;
- Njësia e Shërbimeve Teknike;
- Kalendari për vitin shkollor 2024-2025;
- Raportet tekstuale dhe tabelare të shkollave fillore dhe të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm i lartë;
- Raportet e organizimit të seminareve me mësimdhënës për zbatimin e KK-së dhe KB për nivelet e arsimit (0,1,2,3);
- Informatat rreth organizimit të Provimit të Maturës;
- Bashkëpunimi i zyrtarëve komunal të arsimit DA-së me SIA-në, dhe organe tjera relevante.

Drejtoria e Arsimit dhe stafi i saj në bashkëpunim me MASHTI-n, drejtoritë e shkollave dhe organet tjera relevante janë angazhuar në krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për punë në shkollat e komunës sonë. Planifikimi me kohë ka mundur një fillim të mbarë të procesit edukativo-arsimor.

Drejtoria e Arsimit në përfundim të vitit mësimor, në të gjitha shkollat e komunës sonë, fillon punët në lidhje me përgatitjet e përgjithshme e të nevojshme për vitin e ri shkollor. Drejtorët e shkollave me kohë kanë marrë udhëzimet e nevojshme për fillimin e punëve në lidhje me përgatitjet të cilat duhet të bëhen sipas dinamikës së paraparë nga Drejtoria e Arsimit.

Përgatitjet janë kryer sipas punëve me prioritet:

- Në përfundim të vitit mësimor, ka filluar me përgatitjet e objekteve shkollore si renovime, lysterje, gëlqerosje, dezinfektim dhe dezinfektim etj;
- Për të siguruar kuadrin e nevojshëm, Njësia Administrative pranë Drejtorisë sonë, me kohë ka bërë përgatitjen dhe shpalljen e konkurseve;
- Me kohë është bërë edhe planifikimi për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore të cilat gratis i ka siguruar MASHTI, për nivelin fillor dhe të mesëm të ulët. Edhe këtë vit, furnizimi me libra për nxënësit është bërë përmes rimbursimit, me ç'rast prindërit, pas pranimit të mjeteve, ka bërë blerjen e librave për fëmijët e tyre;

- Nga Drejtoria e Arsimit është bërë planifikimi për furnizimin e shkollave me lëndë djegëse dhe material tjetër të nevojshëm shpenzues;
- Gjithashtu me kohë, shkollat janë pajisur me dokumentacion pedagogjik si libra amë, ditar të punës, fletore të punës për mësimdhënës, material shkollor e gjëra të tjera të nevojshme;
- Drejtoria e Arsimit, përmes Aktivit të Drejtorëve të Shkollave, kujdes të veçantë i ka kushtuar përfshirjes së të gjithë nxënësve në procesin edukativo-mësimor. Një kujdes të shtuar kemi pasur për nxënësit me nevoja të veçanta. Këtë kategori të nxënësve e kemi përfshirë në gjitha nivelet e arsimit, kurse një numër i tyre (për shkak të nevojave më specifike) janë të përfshirë edhe në dy shkolla fillore në „Gjon Serreçi” dhe në „Ahmet Hoxha”;
- Drejtoria e Arsimit ka themeluar edhe Ekipin Komunal për Vlerësimin e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta, Ekipin Komunal për Vlerësim të Brendshëm dhe Ekipin për Parandalim e Braktisjes dhe Mosregjistrim;
- Drejtoria e Arsimit ka planifikuar buxhetin për ndarjen e bursave për studentët e komunës sonë për vitin akademik 2025-2026. Ndërsa për vitin akademik 2024-2025 u ka ndarë bursa të gjithë studentëve që kanë aplikuar.

Me qëllim të mbarëvajtjes së procesit edukativo- arsimor dhe në përgjithësi të punëve nëpër shkolla, Drejtoria e Arsimit, i ka kushtuar kujdes të duhur edhe:

- Planifikimit dhe regjistrimit të fëmijëve në klasat parafilelore;
- Planifikimit dhe regjistrimit të nxënësve në klasën e parë;
- Planifikimit dhe regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të, në shkollat e arsimit të mesëm të lartë;

Drejtoria e Arsimit, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe disiplinës, ka realizuar vizitat të rregullta dhe informative nëpër shkolla.

Sigurisë në shkolla i është kushtuar rëndësia e duhur, është forcuar bashkëpunimi me Policinë, kemi angazhuar sigurimin fizik kryesisht në shkolla të qytetit, kemi vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me Këshillin e Prindërve si dhe është shtuar kujdestaria e ditës nga nxënësit dhe mësimdhënësit.

Një numër i madh i shkollave janë rinovuar nga brenda, ku është bërë suvatimi, ngjyrosja e shkollave, shtrimi i shumë klasave me linoleum etj. Janë rregulluar shumë parkingje të shkollave dhe shtigje për ecje për nxënës. Gjelbërimeve në oborret shkollore i është kushtuar rëndësia e duhur. Në këtë drejtim edhe janë shënuar rezultate. Në disa shkolla janë rregulluar parqet shkollore si dhe janë mbjellë drunjë dekorativ.

Rëndësi e veçantë i kushtohet edhe organizimit të aktiviteteve jashtëkurrikulare, si organizimi i kuizeve nga lëndë të ndryshme të diturisë, garave kulturore, sportive etj.

RAPORTI I PUNËS PËR SEKTORIN ADMINISTRATIV TË DA-së

Spektori Administrativ në Drejtorinë e Arsimit gjatë periudhës për vitin shkollor 2024-2025 ka udhëhequr procedurat administrative dhe ligjore për pranimin e mësimdhënësve dhe punëtorëve tjerë në shkolla për të gjitha nivelet e arsimit para universitar në kuadër të Komunës së Ferizajt.

Gjatë këtij viti shkollor kemi publikuar gjithsej 17 konkurse. Konkursët janë shpallur me kohë duke i respektuar afatet ligjore, janë shpallur edhe në faqen zyrtare të Komunës si dhe në tabelën e shpalljeve me sa vijon:

- Për mësimdhënës - 12 konkurse
- Për asistente për FNV – 1 konkurs
- Për drejtor të shkollave – 1 konkurs
- Për edukatore - 2 konkurse
- Bursa për studentë – 1 konkurs

Janë udhëhequr procedurat e njoftimit të kandidatëve, intervistimit, për pranimin e kandidatëve për plotësimin vendeve të punës, si në zëvendësime, plotësime etj. Janë zhvilluar procedurat e pushimeve të lehonisë, pushimeve mjekësore, pushimeve pa pagesë dhe të punëtorëve të pensionuar gjatë kësaj periudhe.

Kemi shqyrtuar kërkesa, ankesa, kemi dhënë përgjigje me shkrim sipas shkresave të palëve. Kemi bërë kompletimin e lëndëve për zyrën ligjore sipas padive të palëve për kompensimin e pagave me rastin e pensionimit, për rastet e punësimit.

NJËSIA E FINANCAVE

- Përgatitja për raportimin e borxheve për vitin e mëparshëm në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, investime kapitale dhe subvencione.
- Përgatitja për raportimin e pasqyrave financiare për vitin e mëparshëm në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, investime kapitale dhe subvencione.
- Përgatitja planit të keshit për vitin 2025 në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, investime kapitale.
- Shpërndarja e mjeteve në kategoritë e pagave për arsimin fillor të mesëm, sipas shkollave dhe raportimi i tyre për Ministrinë e Financave.
- Shpërndarja e mjeteve përmes FreeBalance për çdo shkollë veç e veç në arsimin fillor të mesëm dhe çerdhen e fëmijëve.
- Kemi bërë shpërndarjen e pagave sipas shkollave, pastaj i kemi futur në FreeBalance pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, komunalitë për vitin 2025.
- Kemi bërë përgatitjen e zotimeve për investime kapitale, përgatitjen e disponueshmërisë së mjeteve, kërkesa për zhvillimin e procedurave të prokurimit.
- Përgatitjen e raportit tremujor për kategorinë e pagave, mallrave dhe shërbimeve, komunalive.
- Rregullimin e retroaktivit për mësimdhënësit që nuk kanë hyrë me kohë në listën e pagave.
- Raporti i borxheve në të gjitha kategoritë ekonomike për Ministrinë e Financave sipas kërkesës së tyre.
- Përgatitja e të dhënave për rishikim të buxhetit në të gjitha kategoritë ekonomike në muajin qershor.

- Përgatitja e të gjitha të dhënave për bursat për studentë dhe pagesat e tyre prej subvencioneve.
- Futja e të dhënave në BDMS në të gjitha kategoritë ekonomike për çdo shkollë veç e veç.
- Përgatitja e investimeve kapitale për ridestitim, sipas programeve të arsimit.
- Përgatitja e listave të pagave për zyrën e Thesarit.
- Raportimin e mjeteve të sindikatës.
- Trajnimet e drejtorëve dhe stafit administrativ, sipas nevojave.
- Kemi kryer të gjitha punët që na lidhin me prokurimin, planin e prokurimit, kërkesat për prokurim.
- Bashkëpunimi dhe harmonizimi i punëve me drejtorët e shkollave.
- Raportin e faturave të papaguara për vitin kalendarik 2025.
- Pasqyrat financiare 2025.

NJËSIA E SHËRBIMEVE TEKNIKE

Drejtoria e Arsimit i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe infrastrukturës shkollore dhe duke parë që shkollat në Komunën e Ferizajt kanë nevojë për renovime dhe përkujdesje, gjatë vitit 2025, ka vazhduar me realizimin e projekteve siç janë në vijim:

Ndërtimi i objekteve shkollore gjatë vitit 2025

- Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Tërrn, vazhdon faza e dytë;
- Ndërtimi i shkollës fillore fshatin Neredime, është finalizuar në tërësi;
- Ndërtimi i çerdhes në rrugën “Rexhep Bislimi” – Ferizaj;
- Ndërtimi i çerdhes në fshatin Dardani.

Renovimi i brendshëm i shkollave-suvatimi, ngjyrosja, instalimi i perdeve dhe shtrimi i linoleumit në:

- SHFMU “Ramadan Rexhepi” - Sojevë
- SHFMU “Imri Halili” - Gaçkë
- SHFMU “Enver Topalli” - Omuraj
- SHFMU “Mic Sokoli” - Slivovë
- SHFMU “Visar Dodani” -Varosh
- SHFMU “Vezir Jashari” - Ferizaj
- SHFMU “Liman Rekaj” – PNF Surqinë
- SHFMU “Arsim Rexhepi” - Sazli
- SHFMU “Naim Frashëri” - PNF në Doganaj, fasadimi i jashtëm.
- SHFMU “Riza Matoshi”- Nikadin
- SHFMU “Tefik Çanga”- Ferizaj
- SHFMU “Jeronim De Rada” - Ferizaj
- Gjumnazi i Shkencor “Kuvendi i Arbërit” - Ferizaj
- IAAP “Pjetër Bogdani” – Ferizaj

Rregullimi i parkingut, trotuareve dhe shtigjeve për këmbësor në:

- Rregullimi i oborrit dhe shtrimi i kubëzave për trotuare të nxënësve në SHFMU “Abetarja” PNF në Pojatë;
- Rregullimi i oborrit dhe parkingut të shkollës “Kemajl Hetemi” në Rahovicë;
- Shtrimi me kubëza i trotuarit për nxënës në SHFMU “Konstantin Kristoforidhi” në Neredime;
- Rregullimi i oborrit dhe shtrimi i trotuarit me kubëza në SHFMU “Ganimete Tërbeshi” në Ferizaj;
- Ndërtimi i aneksit në SHFMU “Besim Rexhepi”, PNF në Llugaj dhe hapja e pusit për ujë të pijshëm në SHFMU “Besim Rexhepi” PNF në Llugaj (Komogllavë);
- Rregullimi i parkingut në SHFMU “Pesë Dëshmorët e UÇK-së” në Pleshinë;
- Rregullimi i oborrit në SHFMU “Muharrem Shemsedini” në Fshatin e Vjetër;
- Rregullimi i parkingut në SHFMU “Dituria” në Dardani;
- Termo izolimi i objektit shkollor “Naim Frashëri” PNF në Doganaj,
- Rregullimi i oborrit të shkollës “Naim Frashëri” në Zaskok, shtruarja e parkingut, trotuareve dhe asfaltimi i fushës së futbollit dhe volejbollit;
- Ndërtimi i kulmit dhe vendosja komplet e kulmit të ri në SHFMU “Halit Ibishi” në Cërnillë, montimi i dymve të reja, suvatimi i klasave dhe shtruarja e korridoreve me pllaka.
- Riparimi i kulmit në SHFMU “Konstantin Kristoforidhi” PNF në Neredime;
- Rregullimi i parkingut dhe trotuareve në SHFMU “Jeronim De Rada” në Ferizaj;
- Riparimi dhe riinstalimi i ngrohjes qendrore në shkollën SHFMU “Astrit Bytyçi”- Ferizaj.

SEKTORI I ARSIMIT

Në kuadër të sektorit të arsimit aktivitetin e tyre e zhvillojnë:

Zyrtari për arsimin para fillor dhe fillor

Zyrtari për arsimin e mesëm të ulët, dhe

Zyrtari për arsimin e mesëm të lartë.

Zyrtarët arsimor, i kanë kushtuar kujdes të duhur këtyre punëve:

- Kanë përcjellë dhe mbikëqyrur përgatitjet e gjithmbarshme të shkollave në kuadër të procesit edukativo-arsimor, janë angazhuar që të bëhet përfshirja e nxënësve në shkollimin e rregullt, kemi kontribuar në ngritjen e bashkëpunimit të shkollës me prindër dhe komunitetin në përgjithësi;
- Bashkëpunojnë me Shoqatën e Matematikentëve, Fizikentëve, Shoqatën e Kimistëve, si dhe Shoqatën e Kulturës Sportive në organizimin e garave në lëmitë përkatëse;
- Në muajin gusht kanë pranuar dhe shpërndarë tekstet shkollore në të gjitha shkollat e komunës sonë, si dhe kemi vazhduar edhe me pjesën tjetër të teksteve të ardhura më vonë nga shtëpitë tjera botuese. Nga kontaktet që kemi pasur me shkolla mund të konkludojmë se të gjitha shkollat janë furnizuar me libra. Përzgjedhja e teksteve ka vepruar sikur viteve të fundit përmes teksteve alternative.
- Është bërë vlerësimi pedagogjik i 18 fëmijëve me nevoja të veçanta, përmes Ekipit Vlerësues;
- Zyrtarët arsimor në kuadër të punëve dhe detyrave të tyre të punës për çdo gjysmë vjetor, janë marrë me grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore për suksesin e nxënësve, vijueshmërinë, disiplinën.
- Zyrtarët arsimor gjatë vitit shkollor 2024-2025 kanë bërë vizita në të gjitha shkollat, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe disiplinës. Gjatë këtyre vizitave është përcjellë respektimi i orarit

mësimor, realizimi i planprogrameve, notimi i nxënësve, kontrollimi i dokumentacionit administrativ, pedagogjik, stafit arsimor, teknik si dhe zhvillimi i aktiviteteve tjera kurrikulare dhe jashtëkurrikulare;

- Janë dhënë udhëzime lidhur me organizmin e mbajtjes të Testit Kombëtar për klasat e IX-ta dhe të Testit të Maturës për klasat e XII-ta;
- Zyrtarët arsimor kanë bërë të gjitha përgatitjet për realizimin e Testit, si dhe kanë marrë pjesë në mbarëvajtjen e Testit;
- Zyrtarët arsimor, kanë shqyrtuar konkursat e shpallura për pranimin e kuadrit arsimor, udhëheqës, teknik dhe punëtor administrativ, kanë bërë vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve;
- Koordinimi dhe përcjellja e të gjitha trajnimeve që realizohen në Qendrën për Ngritjen Profesionale (QNP) në shkollën “Tefik Çanga”, për të gjitha nivelet (0,1,2,3);
- Është hartuar plani i përcjelljes së trajnimeve për zbatim të KK dhe KB (Kurrikulës dhe Kurrikulës Bërthamë);
- Janë hartuar raporte mujore me shkrim lidhur me zbatimin e KKK-së dhe KB-ve në të gjitha shkollat e Komunës së Ferizajt, raportet janë dërguar në MASHTI-n;
- Po ashtu, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të stafit arsimor në shkolla përmes zhvillimit profesional, DA në bashkëpunim me MASHTI-n dhe organizata të akredituara ka organizuar trajnime, seminare e punëtori.

Zhvillimi i procesit mësimor

Viti i ri shkollor ka filluar me 1 shtator. Shkollat me kohë kanë bërë të gjitha përgatitjet në aspektin teknik dhe kompletimin e dokumentacionit pedagogjik. Të gjitha shkollat janë pajisur me mjete higjienike, është bërë me kohë dezinfektimi dhe dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore si dhe është bërë vlerësimi higjienik edhe nga Inspektorati Sanitar. Gjetjet e tyre kanë konstatuar se shkollat plotësojnë kushtet teknike për fillimin e vitit të ri shkollor.

ARSIMIT PARAFILLOR

Në komunën tonë funksionojë tri çerdhe të fëmijëve. IP “Ardhmëria Jonë”, si çerdhe publike, Çerdhja “Engjujt”, çerdhja në fshatin Greme.

Viti shkollor 2025-2026

Në institucionet parashkollore janë regjistruar:

Grup mosha	Numri i grupeve	Gjithsej numri i fëmijëve		
		M	F	Gj
06 muaj – 2 vjeç	4	28	41	69
1 vjeç – 2 vjeç	2	19	17	36
2 vjeç – 3 vjeç	5	39	45	84
3 vjeç – 4 vjeç	6	64	70	134
4 vjeç – 5 vjeç	5	62	51	113
5 vjeç – 6 vjeç	4	61	43	104
Gjithsej	26	273	267	540

Numri i fëmijëve të regjistruar në klasat para fillore
Viti shkollor 2025 – 2026

Numri i fëmijëve në klasat para fillore	M	F	GJ
	682	696	1378

Arsimi fillor

Numri i nxënësve të regjistruar klasa 1 - 5
Viti shkollor 2025 – 2026

Numri i nxënësve klasa 1 – 5	M	F	GJ
	3906	3931	7837

Arsimi i mesëm i ulët

Numri i nxënësve të regjistruar klasa 6 - 9
Viti shkollor 2025 – 2026

Numri i nxënësve klasa 6 – 9	M	F	GJ
	3224	3153	6377

Arsimi i mesëm i lartë

Numri i nxënësve të regjistruar klasa 10 - 12
Viti shkollor 2025 – 2026

Numri i nxënësve klasa 10 – 12	M	F	GJ
	2488	2528	5016

Numri i përgjithshëm i nxënësve
Viti shkollor 2025– 2026

Numri i nxënësve klasa 0 – 12	M	F	GJ
	10300	10308	20608

Rezultatet e Testit të Arritshmërisë Klasa IX-të - Viti shkollor 2024 – 2025

Nr	Institucioni	Numri i nxënësve	Gjuhë shqipe	Gjuhë angleze	Histori	Gjeografi	Matematikë	Informatikë	Kimi	Fizikë	Biologji	Gjithsej	%
1	Shfmu "Gjon Serreçi"	209	2453	430	1586	1262	1543	561	591	568	748	9742	46.61
2	Shfmu "Jeronim De Rada"	154	1848	327	1210	917	1073	439	428	447	565	7254	47.10
3	Shfmu "Tefik Çanga"	138	1719	273	1077	902	1132	392	435	322	541	6793	49.22
4	Shfmu "Ahmet Hoxha"	114	1106	179	782	584	732	273	297	266	361	4580	40.18
5	Shfmu "Ganimete Tërbeshi"	59	705	106	474	396	391	151	175	146	228	2772	46.98
6	Shfmu "Vezir Jashari"	61	781	121	447	350	405	173	199	179	221	2876	47.15
7	Shfmu "Bilall Shala"	17	189	32	126	85	123	37	47	36	61	736	43.29
8	Shfmu "Jeta e Re"	26	286	50	161	135	176	58	78	53	90	1087	41.81
9	Shfmu "Konstandin Kristoforidhi"	32	631	110	434	317	404	145	173	137	201	1436	44.88
10	Shfmu "Naim Frashëri"	74	542	85	370	256	354	102	153	129	182	2173	33.43
11	Shfmu "Dituria"	25	285	46	191	132	180	61	71	52	91	1109	44.36
12	Shfmu "Besim Rexhepi"	53	656	102	438	294	390	150	157	156	180	2523	47.60
13	Shfmu "Imri Halili"	38	405	71	277	208	274	84	118	99	138	1674	44.05
14	Shfmu "Abetarja"	11	132	19	92	61	61	26	38	23	26	478	43.45
15	Shfmu "Muharrem Shemsedini"	38	403	72	270	213	229	94	99	97	114	1591	41.87
16	Shfmu "Visar Dodani"	26	305	63	227	178	212	76	93	79	115	1348	51.85
17	Shfmu "Dëshmorët e Kosharës"	27	275	42	165	126	136	54	78	55	85	1016	37.63
18	Shfmu "Ismajl Qemali"	20	222	40	140	99	129	39	52	56	70	847	42.35
19	Shfmu "Liman Rekaj"	16	124	21	105	69	76	31	40	30	40	536	33.50
20	Shfmu "Ramadan Rexhepi"	15	166	32	117	91	114	38	50	49	45	702	46.80
21	Shfmu "Ali Hadri"	19	200	40	145	116	117	43	56	40	78	835	43.95
22	Shfmu "Skënderbeu"	1	7	2	6	2	8	1	2	3	1	32	32.00
23	Shfmu "Halit Ibishi"	16	139	25	87	55	82	30	43	22	41	524	32.75
24	Shfmu "Dardania"	16	195	27	128	87	105	38	41	32	60	713	44.56
25	Shfmu "Mic Sokoli"	13	127	17	85	53	58	27	33	23	32	455	35.00
26	Shkolla Fillore	21	220	37	162	107	113	45	61	65	61	871	41.48
27	Shfmu "Pesë Dëshmorët e UÇK"	15	186	34	121	91	83	48	40	36	55	694	46.27
28	Shfmu "Dëshmorët e Lirisë"	31	328	41	194	139	190	66	71	65	104	1198	38.65
29	Shfmu "Kemajl Hetemi"	17	183	32	124	84	97	31	35	47	47	680	40.00
30	Shfmu "Dy Dëshmorët"	27	233	39	139	107	121	58	59	51	51	858	31.78
31	Shfmu "Mejdi Xhaferi"	20	173	26	154	113	111	45	59	56	68	805	40.25
32	Shfmu "Pavarësia"	15	195	28	125	95	109	38	54	46	53	743	49.53
33	Shfmu "Astrit Bytyçi"	62	759	114	484	379	459	177	189	180	221	2962	47.77
34	Shfmu "4 Prilli"	18	192	35	118	105	109	37	53	55	64	768	42.67
35	Shfmu "Hajriz Muhadini"	16	195	33	120	96	107	39	36	33	44	703	43.94
36	Shfmu "Afrim Abazi"	22	254	46	164	121	126	53	65	39	81	949	43.14
37	Shfmu "Riza Matoshi"	23	275	39	199	141	163	61	66	55	97	1096	47.65
38	Shfmu "Enver Topalli"	19	219	32	132	96	119	35	41	42	57	773	40.68
39	Shfmu "Arsim Rexhepi"	20	201	38	165	95	119	38	58	45	54	813	40.65
Gjithsej		1544	17514	2906	11541	8757	10530	3894	4434	3914	5371	68861	44.60

Krahasuar me vitin e kaluar shkollor 2023-2024, kalueshmëria në testin e arritshmërisë për vitin shkollor 2024-2025 është më e lartë për 0.03 %

PROVIMI I MATURËS – Afati i Qershorit
Viti shkollor 2024-2025

Shkollat	Nr. i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
"K.Arbërit"	429	326	75.99	91	21.21
"F.Konica"	143	48	33.57	95	66.43
"P.Bogdani"	85	45	52.90	40	47.1
"Z.Hajdini"	65	12	18.46	53	81.54
"E.Gjika"	221	178	80.54	43	19.45
"Çesk Zadeja"	34	13	38.23	21	61.76
"Dr.Sh.Hashani"	283	161	56.89	122	43.10
"Kompetencës"	165	145	87.87	20	12.12
"Aga Xhite"	11	5	68.40	6	54.55
G j i t h s e j	1437	989	68.82	494	34.38

PROVIMI I MATURËS – Afati i Gushtit
Viti shkollor 2024-2025

Shkollat	Nr. i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
"Kuvendi i Arbërit"	97	69	71.30	28	28.87
"Faik Konica"	60	12	20.00	48	80.00
"Pjetër Bogdani"	35	19	54.3	16	45.70
"Zenel Hajdini"	40	11	27.50	29	72.50
"Elena Gjika"	47	35	74.47	12	25.53
"Çesk Zadeja"	9	4	44.44	5	55.56
"Dr. Shaban Hashani"	110	45	40.90	65	59.90
"Çendra Kompetencës"	17	9	52.94	8	47.06
"Aga Xhite"	4	1	25.00	3	75.00
G j i t h s e j	419	205	48.93	214	51.07

Testi i Maturës – Rezultati i përgjithshëm

Shkollat	Nr. i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
G j i t h s e j	1437	1194	83.09	243	16.91

Krahasuar me vitin e kaluar shkollor 2023-2024, në vitin shkollor 2024-2025, kalueshmëria është më lartë për 6.08 %.

Përfundim

Përkundër sfidave dhe peripecive të shfaqura në shumë dimensionë që është duke u ballafaquar arsimit në Republikën e Kosovës, Drejtoria e Arsimit, pas vlerësimit dhe analizës së përgjithshme mbi rezultatet e arritura nga nxënësit në tri nivelet e arsimit para universitar gjatë vitit shkollor 2024/2025 si dhe zhvillimeve të përgjithshme të ecurisë së procesit edukativo-arsimor, konstatohet se në këtë vit shkollor ka zhvillime dhe përmirësime të rezultateve dhe suksesit të nxënësve në komunën e tonë.

Kjo është si rezultat i masave dhe veprimeve konkrete të ndërmarra nga Drejtoria e Arsimit në shumë dimensionë në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim.

Drejtoria e Arsimit po punon në vazhdimësi me të gjithë kapacitetin maksimal, duke bashkëpunuar edhe me institucionet relevante përgjegjëse të arsimit që në komunën tonë të ndërtohet një infrastrukturë shkollore e standardeve për të krijuar kushte sa më optimale që në shkollat tona në vazhdimësi të kemi ngritje të cilësisë në arsim.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

Hyrje

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Ferizajt gjatë vitit 2025 ka vazhduar angazhimin e saj në zhvillimin dhe avancimin e jetës kulturore, rinore dhe sportive në komunë, duke realizuar një sërë aktivitesh, programesh dhe iniciativash që kanë kontribuar në përfshirjen aktive të qytetarëve dhe në pasurimin e jetës publike në qytet.

Përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile, institucionet arsimore, organizatat ndërkombëtare, komunitetin artistik dhe klubet sportive, Drejtoria ka synuar të krijoj mundësi më të mira për zhvillimin kulturor, social dhe sportiv të komunitetit. Në këtë drejtim, aktivitetet e realizuara gjatë vitit raportues kanë pasur për qëllim promovimin e vlerave kulturore, fuqizimin e rolit të rinisë në jetën shoqërore dhe mbështetjen e zhvillimit të sportit si një element i rëndësishëm për mirëqenien dhe integrimin social të qytetarëve.

Institucionet kulturore që funksionojnë në kuadër të Drejtorisë, si Teatri i Qytetit “Adriana”, Galeria e Arteve, Muzeu i Qytetit dhe Biblioteka Komunale “Sadik Tafarshiku”, gjatë vitit 2025 kanë zhvilluar një aktivitet të pasur artistik dhe kulturor përmes organizimit të shfaqjeve teatrore, ekspozitave, aktiviteteve edukative, promovimeve letrare dhe programeve të ndryshme që kontribuojnë në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të komunës.

Në fushën e rinisë, Drejtoria ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktivitesh që kanë synuar fuqizimin e rolit të të rinjve në jetën shoqërore dhe institucionale. Përmes aktiviteteve edukative, projekteve rinore, programeve të vullnetarizmit dhe bashkëpunimit me organizata vendore dhe ndërkombëtare, është arritur të rritet përfshirja e të rinjve në iniciativa që kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit. Një moment i rëndësishëm gjatë këtij viti ishte edhe themelimi i Këshillit Lokal Rinor në Ferizaj, i cili paraqet një mekanizëm të rëndësishëm për përfaqësimin dhe përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal.

Në sektorin e sportit, Drejtoria ka mbështetur zhvillimin e aktiviteteve sportive përmes organizimit të garave dhe turneve si dhe përmes përkrahjes së klubeve sportive që veprojnë në komunë. Aktivitetet sportive të realizuara gjatë vitit kanë kontribuar në promovimin e sportit dhe në rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve dhe qytetarëve në aktivitete fizike dhe rekreative.

Përmes këtyre aktiviteteve dhe iniciativave, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka vazhduar të luaj një rol të rëndësishëm në zhvillimin kulturor, social dhe sportiv të Komunës së Ferizajt, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi më aktiv, më gjithëpërfshirës dhe më të pasur me aktivitete për qytetarët.

Ky raport paraqet një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve, projekteve dhe iniciativave të realizuara gjatë vitit 2025 nga sektorët përkatës të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe reflekton angazhimin institucional për zhvillimin dhe avancimin e këtyre fushave në Komunën e Ferizajt.

I. SEKTORI I KULTURËS

Sektori i Kulturës është një nga katër dikasteret që funksionojnë në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit- Komuna e Ferizajt. Ky sektor organizon aktivitete kulturore të përbashkëta e të ndara, me grupet kulturore e komunitetin artistik, aktivitete tjera që kërkohen nga institucionet komunale, si dhe propozime nga faktorë të jashtëm. Këto aktivitete shtrihen gjatë punës njëvjeçare duke iu përmbajtur planit të punës të përpiluar në fillim vit e në të shumtën e rasteve duke tejkaluar këtë plan me aktivitete shtesë.

Në raportin në vijim i gjeni aktivitetet e realizuara nga ky sektor, përkatësisht njësitë e saj, si dhe aktivitete nga grupe kulturore që veprojnë në partneritet me këtë sektor.

Në kuadër të Sektorit funksionojnë këto njësi:

- **Njësia e Kulturës**
- **Galeria e Arteve**
- **Njësia e Muzeut**
- **Teatri**

Realizimi i planit të punës, mbajtja e aktiviteteve sipas planit dhe ecuritë tjera, shpeshherë varen edhe nga faktorë të tjerë, siç janë: përkrahja financiare, hapësirat dhe kushtet, si dhe rrethanat tjera.

Në vazhdim shohim aktivitetet dhe ngjarjet kulturore, të mbajtura sipas rrjedhës kalendarike dhe përshtatjes.

Teatri i Qytetit “Adriana”

- **3 shfaqje për të rritur (Dramë/Kult).**
- **1 stand-up Komedi (Inovacion në format)**
- **1 performancë teatrore (Teatër eksperimental/bashkëkohor).**
- **1 shfaqje për fëmijë.**

94 shfaqje të realizuara (premiera dhe repriza), pa përfshirë reprizat e organizuara për fëmijë dhe programi voluminoz i *Festivalit të Teatrove* (për të rritur dhe fëmijë), gjë që e rrit konsiderueshëm numrin total të hyrje-daljeve të publikut në teatër.

Teatri “Adriana” është dëshmuar edhe në përfaqësime brenda vendit dhe në arenën ndërkombëtare, si pjesë në pesë festivale, dy kombëtare; Në Mitrovicë dhe Talia e Flakës në Gjilan, ku mori tri çmime. Si edhe tri prezantime ndërkombëtare: në Bursa-Turqi, dhe dy në Maqedoninë e Veriut.

Galeria e Arteve

Veç aktiviteteve të përbashkëta, Galeria e Arteve vazhdoi me mbajtjen dhe organizimin e aktiviteteve tradicionale, ekspozitave, kolonive artistike, bienaleve, punëtorive, vizitave etj. Një pjesë e madhe e aktiviteteve u panë në raportin e përgjithshëm, mësipërm, ndërsa këtu po japim disa statistika të përgjithshme të realizuara nga Galeria e Arteve, ku organizoi, bashkë organizoi ose u bë pjesë e aktiviteteve të artit pamor si:

- **10 ekspozita kolektive**
- **4 koloni artistike**
- **2 debate mbi artin bashkëkohor**
- **4 prezantime mediale etj.**

Rikujtojmë se në mungesë të hapësirave për promovime artistike të disiplinave tjera, Galeria e Arteve u bë vendi ku gjetën mundësinë e realizimit qindra aktivitete tjera gjatë vitit 2025.

Njësia për Trashëgimi e Muze - Muzeu i Qytetit

Njësia për Trashëgimi e Muze, që menaxhon Muzeun e Qytetit dhe përkujdeset për trashëgiminë kulturore gjatë vitit 2025, ishte pjesë e shumë aktiviteteve kulturore të organizuara nga DKRS, por edhe si vet kontribuuese në aktivitetet e realizuara në fushën përkatëse që e mbulon.

Muzeu i Qytetit u vizitua nga:

- **65 grupe të organizuara nga shkollat fillore, të mesme dhe universitare;**
- **8 grupe të organizuara ndërkombëtare**
- **3 grupe, delegacione të organizuara**

Njësia për Trashëgimi e Muze, organizoi:

- **3 ligjërata** në objektet e kulturës, dhe
- **11 ligjërata** nëpër shkolla fillore e të mesme
- **3 ekspozita vizuale**
- **9 vizita në terren** (pikat e trashëgimisë kulturore dhe takime me koleksionistë)

Muzeu i Qytetit gjatë vitit 2025, kishte rreth 3900 vizitorë nga në grupe, individ, vendor e ndërkombëtar dhe qytetarë të rëndomtë. Një pjesë e madhe e këtyre vizitorëve, sidomos ata ndërkombëtar, të njëjtën kohë vizituan Galerinë e Arteve dhe Bifurkacionin dhe pjesë të tjera të trashëgimisë kulturore.

Shikuar që nga fillim viti e deri në përmbyllje të vitit 2025 Sektori i Kulturës, bashkë me njësitë tjera, Teatrin e Qytetit, Galerinë e Arteve, Muzeun e Qytetit, kanë realizuar një varg aktiviteteve kulturore, duke përfshirë të gjitha disiplinat: koncerte, promovime, shfaqje teatrore, ekspozita kolektive e individuale, koloni artistike, akademi solemne, mbrëmje filmi, mbrëmje artistike, punëtori, etj., etj. Të gjitha këto janë bërë në organizim, bashkë organizim, në përkrahje, në përkujdesje etj., me grupet relevante kulturore institucionale dhe ato të pavarura, si: Ansambli “Kastriotët”, SHAF “Zef Kolombi”, Klubi Letrar “De Rada”, Shkolla e Arteve “Çesk Zadeja”, Kori e Orkestra e Qytetit, etj.

Nga i gjithë raporti i aktiviteteve kulturore të realizuar gjatë vitit 2025 nga ky sektor e njësi, dalin **139 aktivitete kulturore** ndërsa nëse përfshijmë edhe aktivitetet e rëndomta, reprizat e shfaqjeve teatrore dhe vizitat në Muzeun e Qytetit, Galerinë e Arteve, dhe apo angazhime të tjera të rëndomta, takime, konsultime, bashkëpunime etj., dalin **afro 300 angazhime kulturore**, ose mesatarja, gati çdo ditë pune e vikendi është e mbuluar me aktivitete kulturore.

Biblioteka Komunale “Sadik Tafarshiku”

Në Sektorin për Fëmijë u anëtarësuan 627 lexues me 12523 libra të lexuara. Tek Sektori për të Rritur u anëtarësuan 437 lexues me 7338 libra të lexuara.

Gjithsej: 1064 lexues me 19861 libra të lexuara.

Në sallën e leximit ishin 6643 lexues, kurse periodikun e kërkuar 83 përdorues.

Në Talinoc të Muhaxherëve u anëtarësuan 77 lexues me 591 libra të lexuara.

Në Dardani (nuk punon biblioteka)

Në Komogllavë u anëtarësuan 102 lexues me 404 libra të lexuara.

Në Neredime u anëtarësuan 97 lexues me 315 libra të lexuara.

Gjithsej: 276 lexues me 1310 libra të lexuara.

Në sektorin e katalogimit dhe përpunimit të librit, u bë inventarizimi i 1348 librave.

Aktivitetet

- Në kuadër të aktiviteteve nga Drejtoria e Kulturës, për nder të 17 shkurtit, Ditës së Pavarësisë, Biblioteka Komunale "Sadik Tafarshiku" mbajti aktivitetin ku u zgjodhën lexuesit më të mirë për vitin 2024. Po ashtu nxënësit e shkollës "Ahmet Hoxha", recituan poezi për 17 shkurtin dhe grupi i fëmijëve "Kastriotët" performuan valle.
- Për të nderuar figurën e shkrimtarit tonë të madh, Fan Noli në përvjetorin e vdekjes, hapëm ekspozitën me veprat e tij e po ashtu në bashkëpunim me nxënësit e shkollës "Ahmet Hoxha" mbajtëm një orë letrare duke deklamuar vargjet e tij.
- Në Ditën Botërore të Librit, bibliotekën e vizituan shumë shkolla, ku nxënësit u njohën me bibliotekën, me rregullat e saj, dhe me historinë e Bibliotekës.
- Vizitë në bibliotekën e fshatit Talinoc i Muhaxherëve
- Nxënësit e kolegjit Universum, vizitë në bibliotekë dhe me rastin e Ditës Botërore të Librit i dhuruan bibliotekës disa libra.

- Hapëm ekspozitën me librat shkollor për nxënës, për tu njohur lexuesit me literaturën shkollore që posedon Biblioteka.
- Në përvjetorin e ditëlindjes së Kryeheroit kombëtar Gjergj Kastriotit, ekspozuam për lexuesit tanë librat që posedon biblioteka, për Gjergj Kastriotin - Skënderbeun.
- Në qershor promovuam librat e autorit Nusret Pllana “Terrori i Serbisë pushtuese mbi shqiptarët 1844-1999” si dhe libri "Intervenimi i NATO-s në Kosovë".
- Së bashku me nxënësit e shkollës “Tefik Çanga” u recituan poezi për 28 nëntorin, dhe flamurin kombëtar.
- E vizituan bibliotekën nxënësit e shkollës “Gjon Serreçi” ku u njoftuan me rregullat e bibliotekës dhe me fondin librar që posedon biblioteka.

Tabela përmbledhëse e aktiviteteve

Kategoria e aktivitetit	Numri i aktiviteteve	Përshkrimi
Festivale dhe manifestime kulturore	8+	Ferilm Festival, Festivali i Teatrove, Kosovarja Këndon, Ferfolk, Ferizaj Piano Fest, Festivali i Karikaturës, Mural Fest, etj.
Premiera teatrore	6	Premiera të realizuara nga Teatri i Qytetit “Adriana”
Shfaqje teatrore	94	Premiera dhe repriza gjatë vitit
Ekspozita të artit pamor	10	Ekspozita kolektive dhe personale
Koloni artistike	4	Koloni me artistë vendor dhe ndërkombëtar
Promovime librash	10+	Promovime nga autorë vendor dhe nga trojet shqiptare
Koncerte dhe aktivitete muzikore	20+	Koncerte klasike, folklorike dhe programe muzikore
Aktivitete për fëmijë dhe edukim kulturor	10+	Programe artistike dhe aktivitete edukative
Ligjërata dhe aktivitete për trashëgiminë kulturore	14	Ligjërata në institucione dhe shkolla
Vizita në Muzeun e Qytetit	65 grupe	Vizita nga nxënës dhe studentë
Vizita ndërkombëtare në muze	8 grupe	Vizitorë nga vende të ndryshme
Delegacione zyrtare	3	Vizita institucionale
Pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare	Disa	Prezantime në Turqi, Shqipëri, Mal të Zi dhe vende tjera

II. SEKTORI I RINISË

Duke filluar nga janari 2025 e deri në fund të muajit dhjetor, Sektori i Rinisë ka realizuar një varg ngjarjesh rinore, sportive dhe aktiviteteve të tjera të ndryshme, por edhe ka qenë pjesë e projekteve e organizimeve të shumta në nivel lokal dhe qendror. Ashtu si edhe në periudhat e mëparshme, vëmendje e veçantë i është dhënë gjithë përfshirjes së të rinjve në aktivitetet e ndryshme, në mënyrë që ata të njihen me politikat rinore që zbatohen nga institucionet publike, të integrohen me sukses në shoqëri, të marrin pjesë aktive në të gjitha nivelet e shoqërisë dhe të kenë mbështetjen për t'u bërë faktorë të ndryshimit.

Aktivitetet e organizuara gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar në bashkëpunim me organizata dhe institucione partnere të Sektorit të Rinisë ndër vite dhe kanë tërhequr të rinj të grup moshave të ndryshme të Ferizajt me rrethinë. Vlen të theksohet këtu në veçanti aktiviteti tradicional “Java e KFOR-it 2025” që zhvillohet në bashkëpunim me KFOR-in amerikan tash e njëmbëdhjetë vjet. Për një javë rresht, sa zgjat ky aktivitet, janë zhvilluar takime dhe aktivitete të shumta tërheqëse për të rinjtë ferizajas dhe ushtarët e KFOR-it Amerikan.

Gjatë vitit 2025, Sektori i Rinisë ka realizuar mbi **50 aktivitete dhe iniciativa rinore**, të cilat përfshijnë takime institucionale, aktivitete edukative dhe kulturore, vizita informuese në shkolla, aktivitete sportive dhe ndërgjegjësuere, si dhe pjesëmarrje në konferenca dhe punëtori vendore e ndërkombëtare.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë realizuar rreth 8 takime pune dhe koordinuese me institucione dhe partnerë, 7 vizita informuese në shkolla dhe institucione arsimore, 15 aktivitete rinore dhe komunitare, 9 aktivitete për shënimin e ditëve ndërkombëtare, 7 pjesëmarrje në konferenca dhe punëtori, si dhe 6 aktivitete sportive dhe rekreative për të rinjtë e Komunës së Ferizajt.

Partnerët

Gjatë vitit raportues, Sektori i Rinisë ka zhvilluar bashkëpunim të vazhdueshëm me institucione lokale, organizata vendore dhe ndërkombëtare, si dhe me institucione arsimore dhe struktura të tjera që veprojnë në fushën e rinisë. Ndër partnerët kryesorë kanë qenë: Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (USHAF), Qendra e Punësimit, Qendra për Aftësim Profesional, Qendra e Kompetencës në Ferizaj, institucionet arsimore të qytetit, Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Shoqata e të Burgosurve Politik, Caritas Kosova, Peace Corps Kosovo, Organizata për Mbrojtjen e Mjedisit “Gjethi”, organizata të ndryshme të shoqërisë civile si AVONET dhe ROE, si dhe partnerë ndërkombëtarë si OSBE, UNDP, UNFPA, UNICEF, RYCO dhe KFOR-i Amerikan (Njësi LMT).

Bashkëpunimi me këta partnerë ka mundësuar organizimin e aktiviteteve të ndryshme edukative, kulturore, sportive dhe ndërgjegjësuere për të rinjtë e Komunës së Ferizajt.

Aktivitetet

Gjatë vitit 2025, Sektori i Rinisë ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktivitetesh të cilat kanë përfshirë të rinjtë në fusha të ndryshme të zhvillimit social, edukativ, kulturor dhe sportiv. Në kuadër të takimeve dhe bashkëpunimit institucional, janë zhvilluar takime me institucione arsimore dhe organizata të ndryshme me qëllim të zgjerimit të mundësive për të rinjtë, orientimin në karrierë dhe integrimin në tregun e punës.

Në kuadër të vizitave informuese nëpër shkolla, Sektori i Rinisë ka organizuar prezantime dhe takime me nxënës të shkollave të mesme dhe institucioneve profesionale, ku të rinjtë janë informuar për mundësitë e përfshirjes në aktivitete rinore, punë vullnetare, edukim joformal dhe programe të ndryshme zhvillimore.

Një pjesë e rëndësishme e aktiviteteve kanë qenë edhe aktivitetet edukative dhe ndërgjegjësuëse, si ligjërata për shëndetin dhe parandalimin e dukurive negative, aktivitete për mbrojtjen e mjedisit, punëtori për zhvillimin e aftësive të të rinjve dhe promovimin e dialogut social. Sektori i Rinisë ka organizuar dhe mbështetur edhe aktivitete kulturore dhe artistike, duke përfshirë orë letrare, ekspozita, shfaqje teatrore dhe aktivitete të ndryshme që promovojnë krijimtarinë dhe angazhimin kulturor të të rinjve.

Një dimension i rëndësishëm i punës së sektorit kanë qenë edhe aktivitetet sportive dhe rekreative, të cilat janë realizuar në bashkëpunim me partnerë institucional dhe organizata të tjera, duke synuar promovimin e një stili jetese të shëndetshëm dhe bashkëpunimit mes të rinjve. Po ashtu janë organizuar aktivitete për shënimin e ditëve ndërkombëtare dhe ngjarjeve me rëndësi shoqërore, si Dita e Poezisë, Dita e Tokës, Dita Ndërkombëtare e Rinisë, Dita e Vullnetarizmit dhe aktivitete ndërgjegjësuëse kundër dhunës me bazë gjinore.

Një aktivitet i rëndësishëm i realizuar gjatë vitit ishte edhe organizimi i aktivitetit tradicional “Java e KFOR-it”, që përfshiu aktivitete sportive, edukative dhe sociale për të rinjtë në bashkëpunim me ushtarët e KFOR-it Amerikan.

Rezultatet

Përmes aktiviteteve të realizuara gjatë vitit, Sektori i Rinisë ka arritur të rris pjesëmarrjen dhe angazhimin e të rinjve në jetën komunitare dhe institucionale.

Ndër rezultatet më të rëndësishme të këtij viti veçohen:

- Rritja e interesimit të të rinjve për punë vullnetare dhe aktivitete rinore;
- Zgjerimi i bashkëpunimit me organizata vendore dhe ndërkombëtare;
- Organizimi i aktiviteteve të shumta edukative dhe ndërgjegjësuëse për të rinjtë;
- Krijimi i hapësirave për dialog dhe bashkëpunim ndërmjet të rinjve dhe institucioneve;
- Themelimi i Këshillit Lokal Rinor në Ferizaj, një mekanizëm i rëndësishëm për përfaqësimin dhe përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal.

Po ashtu, puna dhe përkushtimi i Sektorit të Rinisë është vlerësuar edhe në nivel kombëtar, ku sektori është shpërblyer me mirënjohjen “Komuna me Elemente të Inovacionit në Vullnetarizëm për vitin 2025” nga Organizata TOKA.

Sfidat

Gjatë realizimit të aktiviteteve janë identifikuar edhe disa sfida që lidhen me zhvillimin dhe përfshirjen e të rinjve në jetën shoqërore dhe institucionale. Ndër sfidat kryesore veçohen:

- nevoja për rritjen e hapësirave dhe mundësive për aktivitete rinore;
- përfshirja më e gjerë e të rinjve në aktivitete dhe procese vendimmarrëse;
- nevoja për rritjen e burimeve financiare dhe mbështetjes institucionale për projekte rinore;
- sfidat që lidhen me integrimin e të rinjve në tregun e punës.

III. SEKTORI I SPORTIT

1. Aktivitetet e klubeve sportive në sallë

Klubi / Ekipi	Stërvitje	Ndeshje kampionale	Ndeshje ndërkombëtare	Ndeshje miqësore
KHM Kastrioti – Senior	284	12	2	2
KHM Kastrioti – Kadet	120	12	-	-
KHF Kastrioti – Senior	263	7	-	-
KHF Kastrioti – Kadet	120	7	-	-
KHF Ferizaj – Senior	268	7	-	2
KHF Ferizaj – Kadet	120	7	-	-
KBF Kastrioti	60	-	-	-
KVM Ferizaj – Senior	192	15	-	1
KVM Luboteni – Senior	192	15	-	1
KVF Kastrioti – Senior	133	6	-	1
KVF Fervolley	268	11	1	1
KVF Ferizaj – Senior	250	12	-	1

2. Aktivitetet sportive dhe turnetë në sallë

Aktiviteti	Numri
Turne volejboli për vajza (U14, U16, U18)	12
Gara të shkollave fillore dhe të mesme	Disa aktivitete
Futsall	48
Hendboll	24
Basketboll	22
Volejboll	16
Turne të ndryshme sportive	11

3. Aktivitetet e sporteve individuale

Sporti / Klubi	Stërvitje
Kik Boksi Ferizaj	182
Xhudo – Kastrioti	181
Boksi – Kastrioti	300
Kik Boksi – Kastrioti	182
Pingpong veteranët	196
Klubi i Pingpongut	84

4. Ngjarje dhe aktivitete të veçanta në sallë

Aktiviteti	Numri
Turneu memorial “Ismet Ramadani”	4
Turneu memorial “Ahmet Petrova”	2
Turneu futsall “Uhilas”	2
Aktivitetet sportive QKMF	3
Diplomimi i maturantëve	2
Diplomimi i kadetëve të FSK	3
Aktivitetet e KFOR-it	2
Kampionati Maythai	1

Përmbledhje

Aktiviteti	Numri
Numri i stërvitjeve	3414
Ndeshje kampionale	173
Ndeshje ndërkombëtare	5
Ndeshje miqësore	11



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2025

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, paraprakisht ka bërë një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm të punëve dhe aktiviteteve të zhvilluara në vitin paraprak, me qëllim të identifikimit të të gjitha sfidave që do të merren si bazë në përcaktimin e objektivave kryesore për vitin 2025, për Sektorin e Shëndetësisë, QKMF dhe Shtëpinë Bazë në Komunitet për Persona me Aftësi të Kufizuara Mendore.

SEKTORI I SHËNDETËSISË

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka vlerësuar si të domosdoshme mbajtjen e takimeve konsultuese me strukturat udhëheqëse të QKMF-së, Këshillin Drejtues, Këshillin Profesional si dhe udhëheqës të njësive për përcaktimin e objektivave.

Konkluzion i përbashkët ishte se bazë e përcaktimit të objektivave për vitin 2025, do të jetë buxheti që kemi, duke u fokusuar në objektivat më të domosdoshme në Kujdesin Parësor Shëndetësor që drejtpërsëdrejti do të reflektonin në nivelin e ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore për një mirëqenie shëndetësore më të mirë për qytetarët tanë.

Gjatë vitit 2025 në DSHMS, respektivisht Sektorin e Shëndetësisë, angazhim permanent ishte zhvillimi i politikave shëndetësore konform infrastrukturës ligjore në fuqi, që rregullon sferën e Kujdesit Parësor Shëndetësor, duke qenë të përkushtuar në ndërmarrjen e veprimeve për një funksionalizim të mirëfilltë të QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve, me të vetmin qëllim që qytetarëve tanë t'u ofrohen shërbime shëndetësore sa më dinjitoze dhe cilësore.

Jemi të vetëdijshëm se edhe përkundër përkushtimeve tona mbetet ende për tu bërë, ndaj angazhimi ynë do të jetë i përhershëm edhe përkundër që shpeshherë po përballemi me sfida si furnizimi jo i mjaftueshëm me barna esenciale nga Ministria e Shëndetësisë.

HYRJE

Personeli i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare e filloi vitin 2025 me angazhimet e nevojshme me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe detyrave të punës. Që në ditët e para të **vitit 2025**, puna filloi me ritmin e zakonshëm nëpër të gjitha QMF – të dhe AMF – të, për të vazhduar më tej me synim të intensifikimit. Si gjithmonë, përkushtimi ndaj organizimit të punës dhe eliminimi i ngecjeve eventuale, kanë qenë preokupim i vazhdueshëm i stafit menaxhues dhe hap imediat drejt përmbushjes së objektivave të paracaktuara për këtë vit, të cilat janë:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore;
- Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe performancës në punë në KPSH;
- Monitorimi i vazhdueshëm i standardeve bazike në KPSH;
- Koordinimi i punëve në Edukimin dhe Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Zonimi dhe listimi i pacientëve për mjekë;
- Kujdesi për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien në punë të të gjithë të punësuarve;
- Funksionalizimi i laboratorëve në QMF 6 në fshatin Pleshinë dhe QMF 7 në fshatin Neredime si dhe ofrimin e shërbimit të vaksinimit;
- Shtimi i llojeve të analizave në laboratorin e QKMF-së;
- Furnizimi me pajisje mjekësore, stomatologjike;
- Krijimi i një plan-strategjie për shtimin e numrit të specialistëve të rinj në Mjekësi Familjare;
- Vazhdimi i ndërtimit të objektit të QKMF-së, të QMF-së në fshatin Koshare, si dhe finalizimin e objektit të QMF2.
- Renovimi i objekteve shëndetësore;
- Vazhdimi i botimit të numrave të tjerë të revistës Kujdesi Shëndetësor.
- Vazhdimi i implementimit të tërësishëm të SISH-it dhe programit të SMSF-së dhe modulit të vaksinimit në bazë të SISH-it .

TRUPAT PROFESIONALE TË QKMF – së

KËSHILLI DREJTUES DHE ZYRA E DREJTORIT

Këshilli Drejtues si organi më i lartë i udhëheqjes së QKMF – së, gjatë *periudhës Janar-Dhjetor 2025* ka mbajtur dhjetë mbledhje, për të cilat janë mbajtur rregullisht procesverbalet, që pas aprovimit janë protokolluar dhe ruhen në arkiv. Në këto mbledhje ndër temat kryesore që u shqyrtuan ka qenë të lidhura me organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës në QKMF.

KËSHILLI PROFESIONAL DHE ZYRA E KRYESHEFIT TË DMF (DEPARTAMENTIT TË MJEKËSISË FAMILJARE)

Zyra e Kryeshefit të Departamentit të Mjekësisë Familjare gjatë *dymbëdhjetë mujorit Janar-Dhjetor 2025* është angazhuar në menaxhimin e punës nëpër njësi, sistematizimin e personelit dhe përpilimin e kujdestarive.

Preokupim permanent i Zyrës së Kryeshefit edhe më tej mbetet angazhimi në monitorimin e mbarëvajtjes së procesit të punës dhe realizimit të objektivave në vijim:

1. Respektimi i orarit të punës nëpër njësi nga stafi shëndetësor dhe ai mbështetës;
2. Përpilimi i orareve për kujdestaritë e të dielave dhe festave;
3. Vizitat mbikëqyrëse nëpër njësitë e QKMF-së;
4. Takimet dhe kontaktet e vazhdueshme me shefat e njësive;
5. Vazhdimi i ligjëratave dhe trajnimeve për stafin shëndetësor.

Zyra e Kryeinfermierit

Shërbimet Infermierike në QKMF përbëjnë mbi 76% të volumit të përgjithshëm të punës në këtë institucion , prandaj edhe kërkojnë një menaxhim dhe përkushtim të punës infermierore si tërësi, shumica e punëve në këtë institucion dhe cilësia e tyre varen nga përgatitja dhe profesionalizmi i punës së infermiereve.

Në QKMF shërbimet infermierike kryhen me përgjegjësi dhe disa nga këto shërbime udhëhiqen nga stafi infermior si p.sh.; Vizitat shtëpiake për persona kronik dhe Kujdes Paliativ, shërbimi i vizitave për nëna dhe fëmijë, Kujdesi antenatal, Dispanseri antituberkular etj.

ZYRA PËR CILËSI DHE SIGURI TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

Koordinatori i Cilësisë në kuadër të përgjegjësisë së tij ka marrë pjesë në takimet e Këshillit Drejtues dhe Këshillit Profesional, ku janë shqyrtuar çështje të ndryshme dhe janë marrë vendime në interes të institucionit tonë.

Arritjet Kryesore:

- U formua Komiteti i Cilësisë dhe mbahen takime mujore të gjitha të dokumentuara me procesverbal;
- U krijua sistemi digjital i ruajtjes së të dhënave të SMC;
- Ruajtja e të dhënave në mënyre fizike me 12 blloqe;
- U krijua një grup punues në implementimin e SMC me i gjerë;
- Implementimi i mekanizmit për opinionet e komunitetit (u organizua një vizitë monitoruese nga Koordinatori i Cilësisë, kryesuesi i Komitetit dhe Kryeshefi i QKMF-së në QKMF,QMF,AMF dhe në të gjitha njësitë punuese);

- U vendosën kuti të ankesave dhe sugjerimeve në të gjitha njësitë dhe u vendosën të gjitha protokollat nga MSH;
- Përgatitja e dokumentacionit për të zhvilluar procedurat standarde për shqyrtimin dhe adresimin e ankesave,
- Zhvillimi i auditimeve klinike;
- Vendosja e Organogramit, Deklaratës së Cilësisë dhe Rrjedha e pacientit;
- U vendosën tabelat në dyer të secilës ordinancë etj.;
- Standardizimi i proceseve të punës;
- Përditësimi i protokolleve klinike dhe administrative;
- Unifikimi i dokumentacionit për të gjitha njësitë;
- Rritja e sigurisë së pacientit;
- Futja e sistemit për raportimin dhe menaxhimin e incidenteve/gabimeve;
- Përmirësimi i higjienës dhe kontrollit të infeksioneve;
- Rritja e kënaqshmërisë së pacientëve;
- Kryerja e matjeve periodike javore, mujore, tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore, vjetore nëpërmes QR-Codit të kënaqshmërisë së pacientëve;
- Vendosja e veprimeve korrigjuese për çështjet e ngritura nga pacientët;
- Përmirësimi i komunikimit pacient-staf;
- Aftësimi dhe trajnimi i stafit;
- Trajnime të rregullta për cilësi, siguri, standarde, raportim incidentesh;
- Trajnime për nëpunësit administrativ, infermierë dhe mjekë;
- Rritja e kapaciteteve për auditime të brendshme;
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe mjedisit të punës;
- Riorganizimi i ambienteve për rrjedhë më të sigurt të pacientëve;
- Mirëmbajtje më e mirë dhe menaxhim i inventarit të pajisjeve;
- Forcimi i sistemit të monitorimit dhe matjes;
- Matje mujore të performancës dhe diskutime në udhëheqësi;
- Përdorimi i të dhënave për vendimmarrje;
- Përmirësimi i menaxhimit të barnave dhe materialeve;
- Organizimi i magazinës dhe regjistrimit të inventarit.;
- Kontrolli më i mirë i afateve të barnave;
- Procedura më e qartë për pranimin dhe daljen e barnave;
- Përgatitja e planit për evakuim dhe siguri;
- Hartimi i planeve të evakuimit sipas standardeve;
- Inspektime të rregullta për pajisjet e sigurisë;
- Përmirësimi i komunikimit dhe transparencës së brendshme;
- Takime të rregullta të cilësisë;
- Raportime mujore të njësive;
- Më shumë bashkëpunim në mes të shërbimeve;
- Rritja e llogaridhënies dhe dokumentimit;
- Dokumentim më i mirë i veprimeve ndaj problemeve të identifikuara;
- Procedura për masa korrigjuese dhe parandaluese;
- Arkivim më i rregullt dhe gjurmueshmëri më e madhe;
- U implementuan 93 indikatorë nga 93 gjithsej;
- Janë përfunduar 20 procese kryesore duke shfrytëzuar indikatorin kyç të cilësisë.

I. DEPARTAMENTI I MJEKËSISË FAMILJARE

Departamenti i Mjekësisë Familjare, me shtrirjen e aktivitetit nëpër Qendrat e Mjekësisë Familjare në të gjitha nivelet, ka vazhduar angazhimet drejt realizimit të objektivave të veta mbi shëndetin, për të gjithë banorët e komunës sonë, aktivitete këto që bëhen duke respektuar gjithnjë politikat lokale për shëndetësi të referuara nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (Sektori i Shëndetësisë) dhe Ministria e Shëndetësisë, të bazuara në ligjet dhe rregulloret administrative në fuqi.

Departamenti i Mjekësisë Familjare gjatë *dymbëdhjetë mujërit Janar-Dhjetor*, si gjithnjë funksionimin e vet e ka përqendruar në kryerjen e shërbimeve të përhershme: Shërbimet konsultative nga mjeku i përgjithshëm, mjeku familjar dhe specialistët e tjerë (fiziatri, oftalmologu), shërbimet e shëndetit oral, shërbimet infermierike, shërbimet preventive (edukimi, vaksinimi, KAN-i, vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë, Qendra informuese për shëndetin e gruas), shtëpiake, emergjente dhe diagnostike (EKG, ECHO, shërbimet laboratorike, shërbimet rëntgenologjike).

Raporti në vazhdim jep një pasqyrë të detajuar të punës dhe angazhimeve të personelit shëndetësor në Departamentin e Mjekësisë Familjare.

1. SHËRBIMET MJEKËSORE

Shërbimet mjekësore kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë mes mjekëve dhe infermierëve, krahas përgjegjësisë dhe shkallës së lartë të përgatitjes profesionale. Gjatë punës dhe aktivitetit të përditshëm të mjekëve dhe infermierëve bëhen përpjekje të vazhdueshme për të ofruar shërbime shëndetësore me cilësi të lartë për të gjithë qytetarët e komunës sonë dhe më gjerë.

Numri i shërbimeve dhe mbarëvajtja – Rezultatet e punës për *dymbëdhjetë mujërit Janar-Dhjetor*, në Departamentin e Mjekësisë Familjare të QKMF – së, mund të radhiten sipas qendrave dhe sektorëve, me sa vijon:

- **Në QKMF:** janë ofruar **170376** shërbime shëndetësore, prej tyre **41653** janë vizita mjekësore kurse **128723** shërbime infermierike.
- **Në QMF 1:** janë kryer **89796** shërbime shëndetësore, prej tyre **26370** janë vizita mjekësore, kurse **63426** shërbime infermierike.
- **QMF 2:** janë kryer **27906** shërbime shëndetësore, prej tyre **8243** janë vizita mjekësore kurse **19663** janë shërbime infermierike dhe të tjera.
- **QMF 3 - Greme:** janë kryer **20576** shërbime shëndetësore, prej tyre **5445** janë vizita mjekësore kurse **15131** shërbime infermierike.
- **QMF 4:** janë kryer **98248** shërbime shëndetësore, prej tyre **28099** janë vizita mjekësore kurse **70149** shërbime infermierike.
- **QMF 5 - Komogllavë:** janë kryer **15307** shërbime shëndetësore, prej tyre **4114** janë vizita mjekësore kurse **11193** shërbime infermierike.

- **QMF 6 - Pleshinë:** janë kryer **12943** shërbime shëndetësore, prej tyre **3978** vizita mjekësore dhe **8965** shërbime infermierike.
- **QMF 7 - Neredime:** janë kryer **10724** shërbime shëndetësore, prej tyre **3170** vizita mjekësore dhe **7554** shërbime infermierike.
- **QMF 8 - Dardani:** janë kryer **15245** shërbime shëndetësore, prej tyre **4664** vizita mjekësore dhe **10851** shërbime infermierike.
- **QMF 9 - Softaj:** janë kryer **9810** shërbime shëndetësore, prej tyre **3520** vizita mjekësore dhe **6290** shërbime infermierike
- **QKMF 10-Prelez:** janë kryer **7458** shërbime shëndetësore, prej tyre **2375** vizita mjekësore dhe **5083** shërbime infermierike
- **AMF-të të gjitha-**janë kryer **3053** shërbime shëndetësore, prej tyre **1283** vizita mjekësore kurse **1770** shërbime infermierike.
- **KUJDESTARIA E NATËS** – si njësi që funksionon në kuadër të Shërbimit Emergjent Primar në QKMF, ka ofruar gjithsejtë **65494** shërbime shëndetësore, nga të cilat **35608** vizita mjekësore dhe gjithsej **29886** shërbime infermierike .
- **KUJDESTARIA E NATËS**-si njësi që funksionon në **QMF2**,ka ofruar gjithsej **8324** shërbime shëndetësore nga të cilat **4391** vizita mjekësore kurse **3933** shërbime infermierike.
- **KUJDESTARIA E TË SHTUNEVE** – ka kryer gjithsej **34126** shërbime shëndetësore ,prej të cilave **22649** janë vizita mjekësore dhe **11477** janë shërbime infermierike.
- **KUJDESTARIA E TË DIELAVE** – si njësi që funksionon në kuadër të Shërbimit Emergjent Primar në QKMF, ka ofruar gjithsej **20721** shërbime, prej të cilave **10906** vizita mjekësore dhe **9815** shërbime infermierike.
- **KUJDESTARIA E TË DIELAVE**-në **QMF2** ka kryer gjithsej **1448** shërbime shëndetësore, prej të cilave **767** janë vizita mjekësore dhe **680** shërbime infermierike.

Tabela 1. Numri i shërbimeve në të gjitha QMF-të dhe AMF-të

Qendra	Numri i vizitave mjekësore	Numri i shërbimeve infermierike	Numri i përgj. i shërbimeve
QKMF	41653	128723	170376
QMF 1	26370	63426	89796
QMF 2	8243	19663	27906
QMF 3 - Greme	5445	15131	20576
QMF 4	28099	70149	98248
QMF 5 - Komogllavë	4114	11193	15307
QMF 6 - Pleshinë	3978	8965	12943
QMF 7 - Neredime	3170	7554	10724
QMF 8 - Dardani	4664	10581	15245
QMF 9 - Softaj	3520	6290	9810
QMF 10- Prelez	2375	5083	7458
AMF-të të gjitha	1283	1770	3053
Kujdestaria e natës QKMF	35608	29886	65494
Kujdestaria e natës QMF2	4391	3933	8324
Kujdestaria e shtunave	22649	11477	34126
Kujdestaria e të dielave QKMF	10906	9815	20721
Kujdestaria e të dielave QMF2	767	681	1448
TOTALI	207235	404320	611555

2 .SHËRBIMET DIAGNOSTIKE

2.1. Njësia e laboratorit

Personeli i laboratorëve në dhjetë qendrat ka ofruar shërbime të vazhdueshme, në këta laboratorë janë kryer shumica e analizave të nevojshme për diagnostikim, numri i përgjithshëm i të cilave gjatë *këtij dymbëdhjetë mujori* arrin në **142480** analiza, prej të cilave janë **129871** analiza gjaku dhe **12609** analiza urine.

Tabela 2. Numri i shërbimeve në laboratorët e qendrave

Laboratorët në qendra	Analiza urine	Analiza gjaku	Gjithsej
QKMF	8384	97236	105260
QMF 1	2253	16713	18966
QMF 2	502	4977	5479
QMF 3 (Greme)	167	1050	1217
QMF 4	670	5971	6641
QMF 5-Komogllavë	192	1254	1446
QMF 6-Pleshinë	48	265	313
QMF 7-Neredime	53	411	464
QMF 8 - Dardani	292	1973	2265
QMF 9 - Softaj	48	21	69
QMF 10-Prelez i Muhaxherëve	15	34	49
Totali	12624	129,905	142529

2.2. Njësia e radiologjisë

Njësia e Radiologjisë në kuadër të QKMF-së është e ndarë në gjashtë kabine: RTG në DAT, RTG digjital në SHEP, RTG dental, Mamografia dhe kabineti i radiologes i pajisur me aparat të ultrazërit. Shërbimet e kryera gjatë *dymbëdhjetë mujorit Janar-Dhjetor 2025* në këtë njësi janë paraqitur në tabelën vijuese.

Tabela 3. Shërbimet në Kabinetin e RTG-së

Shërbimet	Numri i shërbimeve
Vizita specialistike radiologjike	3611
Radiografia të extremiteteve	9652
Radiografi të mushkërive	2236
Echo	199
Mamografi eksponime	2208
Mamografi lexim	359
Gjithsej	18265

3.DISPAZERI I SËMUNDJEVE TË MUSHKËRIVE

Në DAT gjatë këtij *dymbëdhjetë mujori Janar-Dhjetor* janë ofruar gjithsej **4217** shërbime. Numri i pacientëve si raste të reja me TB dhe 1 recidiv kanë qenë gjithsej 55, që është në rënie në krahasim me numrin tyre gjatë vitit 2024 që ka qenë gjithsej 82.

Tabela 4. Shërbimet në Dispanserinë Antituberkular

Shërbimet	Numri
Vizita specialistike	721
Patronazh (edukim shëndetësor)	1518
Përpunim i kontaktit	145
Baciloskopi	587
TBC pulmolare	35
TBC extrapulmonale	43
Raste të reja me TB	55
BK+	35
Laborator (Se)	4
PPD	475
Vizita shtëpiake	97
Inhalime	24
Teste për covid	23
Testi i HIV-it	24
Punktate	33
Gen Expert	147
Matja e peshës	251
Gjithsej	4217

Rezultatet e mjekimit gjatë dymbëdhjetë mujorit Janar-Dhjetor: -Të shëruar =13M dhe 19F ;

-Trajtim i kompletuar =24M dhe 16F ;

-Të vdekur nga TBC =3

-Humbje nga përcjellja =2 raste kanë shkuar jashtë vendit

-I lëvizur (transfer në qendër tjetër)= 1

-Ndërprerje (jo TBC) =1 dhe Dështim =0

4. SHËRBIMET PREVENTIVE

Në shërbimet preventive, që nënkuptojnë promovimin e shëndetit në komunitet, bëjnë pjesë dy njësi të QKMF – së:

- a) Edukimi shëndetësor dhe
- b) Vaksinimi.

Të dyja këto njësi ofrojnë shërbime nëpër shkolla dhe në komunitet dhe organizojnë punën nëpërmjet ekipeve përkatëse.

4.1. Edukimi shëndetësor

Nisma e angazhimeve për anëtarët e Grupit të Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor gjatë këtij *dymbëdhjetë mujori*, filloi me realizimin e objektivave të përcaktuara:

Nga 18-21.03.2025 me aktivitete të shumta si vizita, këshilla e ligjëratë për ruajtjen, kujdesin dhe higjienën e gojës është shënuar „**20 Marsi-Dita Botërore e Shëndetit Oral**”, të organizuar nga stafi i sektorit të stomatologjisë në përkrahje nga drejtorja dhe grupi i Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor. Këto aktivitete janë mbajtur në kopshtet e fëmijëve „Ardhmëria jonë” dhe „Engjujt” si dhe me fëmijët parashkollor të shkollës „Astrit Bytyqi”, „Pavarësia” në fshatin Balaj, ndërsa fëmijët parashkollor të shkollës „Abetarja” në Softaj dhe Pojatë ishin në QMF-9 në Softaj. Aktivitet u përmbyllën me 21.03.2025 me mbajtjen e ligjërates „Efektet negative të drogës dhe duhanit në shëndetin oral tek adoleshentët”.

Me 24.03.2025 në Ditën Botërore kundër Tuberkulozit ekipi i Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor të QKMF-së, mbajti një ligjëratë për nxënësit e shkollës së mesme „Zenel Hajdini”.

Me 16.5.2025 në Ditën Botërore të Hipertensionit ekipet e EPSH, në QKMF, QMF-1 dhe QMF-4, organizuan këndet informuese në të cilat pacientëve të rastit u bënë matjen e tensionit dhe kanë dhënë këshilla rreth sëmundjes dhe parandalimit të saj.

Me 30.05.2025 në Ditën Botërore kundër Duhanit, ekipi për EPSH, ka mbajtur një ligjëratë vetëdijësuese me nxënësit dhe një pjesë të stafit arsimor të shkollës fillore, “Ganimete Tërbeshi” në Ferizaj.

Me 26.06.2025 në Ditën Ndërkombëtare Kundër Abuzimit të Drogave dhe Trafikimit të paligjshëm në Qendrën Rinore të qytetit është mbajtur ligjëratë nga ekipi i EPSH të QKMF-së.

Me 07.08.2025 në Javën e Gji dhënies, u mbajt ligjërata ne Qendrën Trajnuese me nënat dhe u shpërndan fletushka në Qendrat e Mjekësisë Familjare.

Me 29.09.2025 në Ditën Botërore të Zemrës me moton "Mos humb asnjë rrahje" në QKMF e nëpër QMF-të e qytetit pacientëve të rastit u është bërë matja e tensionit arterial u janë dhënë këshilla dhe u janë shpërndarë fletëpalosje.

Me 01.10.2025 në Muajin Rozë, në këtë muaj u mbajt ligjëratat me komunitetin dhe u shpërndan fletushkat për ndërgjegjësimin për luftën kundër kancerit të gjirit.

Me 07.10.2025 në Muajin Rozë, nga grupi i EPSH u mbajt ligjëratë në fshatin Dubravë.

Me 10.10.2025, nga grupi i EPSH u mbajt ligjëratë në shkollën fillore „Ahmet Hoxha”.

Me 14.10.2025, në Muajin Rozë, nga punëtorët shëndet. u bë dhurimi i gjakut në qendrën për transfuzion.

Me 15.10.2025, në Muajin Rozë, nga grupi i edukimit për EPSH u mbajt karvani "perSHËNDETje" nga ora 11:00 deri në ora 14:00 u bë matje e tensionit, glikemisë, peshës dhe këshillimit nga punëtorët shëndetësor mjekët dhe infermierët si dhe vullnetarët e AQH,KOPF në qendrën e qytetit për vetëdijësimin për sëmundjet dhe dukuritë negative e mbështetur nga AQH,KOPF,QKMF,si dhe qytetarëve iu shpërndanë fletushka.

Me 15.10.2025 në Muajin Rozë, nga grupi i edukimit për EPSH u mbajt ligjëratë me mirëmbajtëse.

Me 22.10.2025 në Muajin Rozë, nga grupi i edukimit për EPSH u mbajt ligjërata në shkollën fillore “Besim Rexhepi” Komogllavë me punëtorët e arsimit dhe komunitetin.

Me 24.10.2025 në Muajin Rozë, nga grupi i eduk. për EPSH në bashkëpunim me OJQ NEVO KONCEPTI u mbajt ligjërata në shk.f. "Tefik Çanga" dhe "Ahmet Hoxha" me punëtorët e arsimit dhe komunitetin.

Me 28.10.2025 në Muajin Rozë, nga grupi i edukimit për EPSH u mbajt ligjërata në shkollën fillore "Jeta e re" në Greme, me punëtorët e arsimit dhe komunitetin.

Me 31.10.2025 në Muajin Rozë, u mbajt Marshi Tradicional për ndërgjegjësimin e kancerit të gjirit nga Objekti i QKMF-se deri tek sheshi afër komunës së Ferizajt, ky marsh u mbështet nga Spitali Rajonal Ferizaj, IRSHP dhe Policia e Kosovës.

Me 14.11.2025 në Ditën Botërore të Diabetit me moton" Diabeti nuk përcakton se kush jemënyra si e menaxhon tregon forcën tënde". Në QKMF dhe nëpër QMF-të e komunës së Ferizajt, stafi shëndetësor i QKMF-së bënë matjen e glikemisë, këshillimin për menaxhimin e sëmundjes së diabetit, rëndësinë e jetës së shëndetshme në parandalimin e diabetit si dhe iu shpërndanë broshura informuese qytetarëve.

Me 01.12.2025 në Ditën Botërore të HIV/AIDS ekipi i Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor i QKMF-së, ka mbajtur një ligjëratë informuese dhe ndërgjegjësuere me nxën. e shkollës “Çesk Zadeja”.

Me 16.12.2025, nga ekipi i Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor i QKMF-së u mbajt ligjërata për ndërgjegjësimin e popullatës për shtypjen e lartë të gjakut (Hipertensionin) u bë edhe matja e tensionit për të pranishmit kjo ligjëratë ishte e mbështetur nga AQH-QKMF

Me 22.12.2025, nga ekipi i EPSH i QKMF-së u mbajt ligjërata për ndërgjegjësimin e popullatës për Diabetin u bë edhe matja e glikemisë për të pranishmit kjo ligjëratë u mbështet nga AQH-QKMF.

4.2. Shërbimi i vaksinimit

Gjatë *dymbëdhjetë mujorit Janar-Dhjetor* në Shërbimin e Vaksinimit në të gjitha QMF-të dhe AMF-të, janë dhënë gjithsej **29273** vaksina.

Tabela 5. Vaksinimi sipas qendrave

<i>Qendra</i>	<i>Vaksinat nëpër njësi</i>
<i>QKMF</i>	<i>21243</i>
<i>QMF 1</i>	<i>2527</i>
<i>QMF 2</i>	<i>2843</i>
<i>QMF 3 - Greme</i>	<i>878</i>
<i>QMF 4</i>	<i>1073</i>
<i>QMF 5 - Komogllavë</i>	<i>71</i>
<i>QMF 7-Neredime</i>	<i>21</i>
<i>QMF 8 - Dardani</i>	<i>70</i>
<i>QMF 9 - Softaj</i>	<i>547</i>
<i>AMF - të</i>	<i>0</i>
<i>Totali</i>	<i>29273</i>

Qendra Kryesore e Mjekësisë-Ferizaj -Formulari për raportimin e përfshirjes me vaksinim

Periudha JANAR - DHJETOR 2025

Grup-mosha		Fëmijët e planifikuar për vit	Fëmijët e planifikuar për muaj
0-11 muaj (BCG, HepB, DTaP, IPV, Hib,PCV,Rota)		1589 BCG(1688)	
12- 23 muaj (MMR, PCV,DTaP, IPV,Hib)		1447	
24-59 muaj (Fëmijët e mbeturë)	IPV/bOPV, DTP,Hib,HepB	27	
	IPV/bOPV,DPT,PCV	21	
	MMR	43	
Fëmijët e klasës së I-rë (DT,bOPV,MMR)		1539	
Te mbetur nga kl I-rë (DT,bOPV,MMR)		48	
Fëmijët e klasës së VI-të (dT,bOPV,HPV) / vajza		1718	
Te mbetur nga kl VI-të (dT,bOPV,HPV)		59	
Fëmijët e shkollës mesme (dT)		1332	

Vaksinat	0-11 muaj (2024- 2025)	12-23 muaj (2023- 2024)	24-59 muaj	Kl.I- rë	Të mbetur	Kl VI- të	Të mbetur	Kl XII- të	Mbi 59 muaj	TOTALI
BCG në lindje	1686									1686 99.8%
Hep.B 1 në lindje	1686									1686 99.8%
HepB 2	1538									1538 96.7%
HepB 3	1344									1344 84.5%
DTaP-IPV-Hib 1	1588									1588 99.2%
DTaP-IPV-Hib 2	1545									1545 97.2%
DTaP-IPV-Hib 3	1334									1334 83.9%
Rota 1	1561									1561 98.0%
Rota 2	1496									1496 94.5%
PCV 1	1588									1588 99.2%
PVC 2	1545									1545 97.2%
MMR 1		1333								1333 92.7%
PCV 3		1400								1400 96.1%
DTaP-IPV-Hib (12-18 m)		1097								1097 75.8%

Gjatë kësaj periudhe dymbëdhjetë mujore janë realizuar aktivitetet e rekomanduara nga IKSHPK për rëndësinë e vaksinimit me MMR vaksinën kundër fruthit dhe janë shpërndarë broshura nëpër kopshte.

4.3. Qendra Informuese për Shëndetin e Gruas

Në Qendrën Informuese për Shëndetin e Gruas në QMF-2, gjatë *këtij dymbëdhjetë mujori* janë ofruar gjithsej **85** shërbime, ku përfshihen trajnimet individuale dhe grupore, për gra shtatzëna dhe familjet e tyre.

4.4. Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0 deri 3 vjeç

Shërbimi i Vizitave Shtëpiake për Nëna dhe Fëmijë gjatë *këtij dymbëdhjetë mujori*, ka ofruar **3186** vizita që janë tejet të rëndësishme për ruajtjen e shëndetit të nënave dhe fëmijëve, ushqyeshmërinë e shëndetshme të fëmijëve dhe parandalimin e sëmundjeve të ndryshme apo identifikimin e hershëm të tyre.

Tabela 6. Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0 deri 3 vjeç

Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0 deri 3 vjeç	Numri i shërbimeve
QKMF	1301
QMF 1	575
QMF 2	533
QMF 3 - Greme	0
QMF 4	626
QMF 8 - Dardani	13
QMF 9 - Softaj	0
AMF-të të gjitha	5
GJITHSEJT	3186

5. SHËRBIMET EMERGJENTE

Shërbimi emergjent si njësi në kuadër të QKMF-së, gjatë *dymbëdhjetë muorit Janar-Dhjetor* ka intervenuar në **6439** raste emergjente.

Tabelat në vijim përfshijnë në mënyrë të përmblëdhur rezultatet e punës në Shërbimin Emergjent Primar.

Tabela 7. Shërbimet emergjente primare

Shërbimet emergjente	Numri i rasteve
Emergjencat internistike	347
Emergjencat infektive	13
Emergjencat kirurgjike	60
Emergjencat pediatrike	6
Emergjencat gjinekologjike	8
Emergjenca toksikologjike	57
Emergjencat neurologjike	469
Emergjencat psikiatrike	317
Emergjencat geriatrike	1794
Dhimbje akute	1320
Trauma në komunikacion	750
Trauma të tjera	83
Djegje, mërdhitje, mbytje në ujë	0
Vetëvrasje me armë	1
Vetëvrasje me mjete kimike	3
Verifikim i vdekjes	347
Sëmundje malinje	773
Emergjencat ortopedike	91
GJITHSEJ	6439

Pacientët tek të cilët intervenohet jo gjithherë vazhdojnë trajtimin në QKMF, një numër i tyre dërgohen edhe nëpër institucionet e tjera brenda ose jashtë qytetit, varësisht nga gjendja e tyre shëndetësore dhe mjekimi që duhet t'u ofrohet. Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat lidhur me vazhdimin e mëtejme të trajtimit të tyre.

Tabela 8. Trajtimi i pacientëve pas ndihmës emergjente

Të trajtuar në:	
QKMF	298
Shtëpi	4001
Aksident komunikacioni	750
Të transportuar në:	
Spital – Ferizaj	788
QKUK	29
Polici	198

Tabela në vijim paraqet shërbimet e tjera që ofrohen në objektin e SHEP.

Tabela 9. Shërbimet e tjera në SHEP

Shërbimet e tjera	Numri
Vizita mjekësore	1137
EKG	1424
Therje intramuskulare	1564
Therje intravenoze	0
Infuzione	19834
Lidhtore	1896
Kateterizime	149
Reanimime	157
Matja e glikemisë	417
Rriqna	39
Totali	26617

6. KUJDESI SHTËPIAK PALIATIV

Në kuadër të kujdesit shtëpiak si njësi që funksionon në katër QMF-të, realizohen **vizitat shtëpiake** paliative me një staf të përgatitur mirë që tregojnë suksese në përmbushjen e obligimeve të punës, përkundër faktit që kjo punë bëhet nëpër shtëpitë e pacientëve të cilët janë në gjendje shumë të rëndë dhe të palëvizshëm. Gjatë *dymbëdhjetë mujorit Janar-Dhjetor* janë kryer gjithsej **8142** vizita shtëpiake.

1.

Tabela 10. Shërbimet e Kujdesit shtëpiak

Kujdesi shtëpiak	Numri i shërbimeve
QKMF	2684
QMF 1	1717
QMF 2	1563
QMF 4	2178
GJITHSEJ	8142

7. KUJDESI SHËNDETËSOR ANTENATAL (KAN)

Kujdesi shëndetësor antenatal realizohet në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare, ku gjinden dhomat për Kujdesin antenatal (KAN) të cilat udhëhiqen nga infermieret e trajnuara për këtë qëllim, që bashkë me mjekun, përcjellin tek pacientet periudhën e shtatzënisë dhe lehonisë. Raporti i këtij shërbimi për *dymbëdhjetë mujorin Janar-Dhjetor* është **4169** vizita.

Tabela 11. Shërbimet e Kujdesit Antenatal

Kujdesi Antenatal	Numri i shërbimeve
QKMF	666
QMF 1	46
QMF 2	283
QMF 4	3171
AMF	3
GJITHSEJ	4169

8.AMBULANCAT E MJEKËSISË FAMILJARE

Në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare funksionojnë katër Ambulanca të Mjekësisë Familjare në fshatrat: Mirash, Varosh, Gaçkë, dhe Talinoc, kurse AMF në Llojza aktualisht është pasive, ndërsa në Greme, Komogllavë, Pleshinë, Neredime, Dardani, Softaj dhe Prelez të Muhaxherëve funksionojnë QMF 3, QMF 5, QMF 6, QMF 7, QMF 8 dhe QMF 9 dhe QMF 10, ndërsa AMF në fshatin Mirosalë është jofunksionale për shkak të dëmtimeve që ka pësuar objekti nga zjarri.

Gjatë dymbëdhjetë mujorit Janar-Dhjetor, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të stafit ka funksionuar vetëm AMF –Mirash, numri i përgjithshëm i shërbimeve është 1165, prej të cilave 463 janë vizita mjekësore, dhe 702 shërbime infermierike.

9. NJËSIA E FARMACISË

Njësia e farmacisë gjatë *dymbëdhjetë mujorit janar-dhjetor* ka vazhduar punën e saj në distribuimin dhe disperzimin e barnave dhe materialit medicinal. Depoja qendrore pranë QKMF - së furnizohet nga: Ministria e Shëndetësisë - Divizioni i Farmacisë; operatori ekonomik dhe donacionet.

AKTIVITETE:

- Distribuim dhe disperzim i barnave ,materialit medicinal ,materialit mbrojtës;
- Distribuim i mirë në këto pika furnizuese: Barnatorja pranë QKMF-së dhe në të gjitha njësit tjera punuese të saj dhe në të gjitha institucionet të cilat janë pjesë e Komunës së Ferizajt.

VËREJTJE:

Furnizimet në tremujorin e parë të vitit 2025 për kategorinë e insulinmarrësve janë plotësuar në plotni.

Furnizimi në tremujorin e parë të vitit 2025 me terapi orale ka qenë pjesërisht i mirë.

Furnizimi në tremujorin e parë të vitit 2025 me terapi ampullare nuk ka qenë i mjaftueshëm, po ashtu mbulimi me terapi nga grupi i barnave antituberkulare është i mirë.

TË ARRITURAT:

Prill, Maj, Qershor (Furnizimi nga M.Sh. për këtë vit kalendarik bëhet një

herë në tre muaj) Furnizim i rregullt nga MSH për QKMF-Ferizaj

VËREJTJE:

Furnizimet në tremujorin e tretë të vitit 2025 për kategorinë e insulinmarrësve janë plotësuar në plotni.

Furnizimi në tremujorin e tretë të vitit 2025 me terapi orale ka qenë pjesërisht i mirë.

Furnizimi në tremujorin e tretë të vitit 2025 me terapi ampullare nuk ka qenë i mjaftueshëm, po ashtu mbulimi me terapi nga grupi i barnave antituberkulare është i mirë.

TË ARRITURAT:

Tetor, Nëntor, Dhjetor (Furnizimi nga M.Sh. për këtë vit kalendarik bëhet një herë në tre muaj)
Furnizim i rregullt nga MSH për QKMF-Ferizaj

VËREJTJE:

Furnizimet në tremujorin e katërt të vitit 2025 për kategorinë e insulinmarrësve janë plotësuar në plotni.

Furnizimi në tremujorin e katërt të vitit 2025 me terapi orale ka qenë pjesërisht i mirë.

Furnizimi në tremujorin e katërt të vitit 2025 me terapi ampullare nuk ka qenë i mjaftueshëm, po ashtu mbulimi me terapi nga grupi i barnave antituberkulare është i mirë.

II. QENDRA TRAJNUESE E MJEKËSISË FAMILJARE

2.1. Aktivitetet në QTMF

Aktivitetet e zhvillimit në QTMF-Ferizaj për *periudhën dymbëdhjetë mujore* janë të lidhura me zbatimin e programit të shkollimit specialistik në Mjekësi Familjare për gjeneratën 2024/2027 ku përshihen:

- Ushtrimet Klinike në QTMF / Ferizaj;
- Ligjëratat qendrore në QZHM / Prishtinë;
- Monitorimi i ushtrimeve klinike në repartet klinike në Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt, IKSHF- Ferizaj dhe QSHM - Ferizaj;
- Vlerësimi në mes të modulit dhe në fund të modulit në programin e Mjekësisë Familjare
- Raportimet e rregullta të implementimit dhe zbatimit dhe vijueshmërisë në MSH në Prishtinë;
- Koordinimi dhe zbatimi në implementim e programit të Mjekësisë Familjare me institucionet përgjegjëse Komunale DSHMS dhe Drejtorin e QKMF-së.

I gjithë ky aktivitet realizohet me stafin e QTMF / Ferizaj ku bëjnë pjesë koordinatori, mentorët klinikë dhe trajnerët.

2.2. Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

Në bazë të planit vjetor për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional për mjek familjar dhe të përgjithshëm, gjatë *dymbëdhjetë muorit Janar-Dhjetor* janë mbajtur këto aktivitete sipas planit vjetor të dorëzuar në Odën e Mjekëve të Kosovës:

Tabela 16. Ligjëratat dhe trajnimet e mbajtura në kuadër të ZHVP-së

Aktiviteti	Data
Punëtorja :Prezantimi i auditit klinik „Hipertensioni arterial”	06.02.2025
Ligjëratë: „Trajtimi farmakologjik i DMT2 në Kujdesin Parësor”	27.03.2025
Ligjëratë:„Hiper dhe hipotireoza-diagnostifikimi dhe trajtimi”	17.04.2025
Ligjëratë:„Dislipidemia-diagnostifikimi dhe trajtimi”	25.06.2025
Ligjëratë: „Gastroenterocolitis acuta-diagnostifikimi dhe trajtimi”	07.08.2025
Ligjëratë: „Hipertensioni Arterial sipas udhërrëfyesit nacional,auditi kl”	18.09.2025
Ligjëratë: „Raportimi i sëmundjeve kronike jo ngjitëse dhe ngjitëse”	18.09.2025
Ligjëratë: „Trajtimi bashkëkohor i Diabetit”	24.10.2025

Këto aktivitete zyra e ZHVP i ka akredituar në Odën e Mjekëve të Kosovës duke iu mundësuar mjekëve t'i realizojnë pikët e nevojshme për licencim dhe ri licencim dhe njëkohësisht të rritet niveli i cilësisë së punës në praktikën e përditshme profesionale.

2.3. Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional Infermieror

Aktivitetet për ZhVP për infermierë janë mbajtur sipas planit të hartuar paraprakisht me qëllim të arritjes së objektivave të zhvillimit profesional drejt ngritjes së cilësisë dhe plotësimit të standardeve për kujdes shëndetësor. Gjatë *dymbëdhjetë muorit Janar-Dhjetor* janë mbajtur këto aktivitete sipas planit vjetor të dorëzuar në Odën e Infermierëve të Kosovës:

Tabela 17. Ligjëratat e mbajtura në kuadër të ZHVP-së për Infermierë

Ligjëratat	Data
Dukuritë devijante në shoqëri (droga, alkooli, duhani, prostitucioni)	20.01.2025
Mbingarkesa në punë, menaxhimi i shëndetit	13.02.2025 dhe me 27.02.2025
RKP-Bazik dhe i Avancuar	13.03.2025
RKP-Bazik dhe i Avancuar	27.03.2025
Trajnimi 5 ditor për Vizita Shtëpiake për Nëna e Fëmijë	02-08.04.2025
Punëtorja “Kujdesi infermieror te rastet emergjente”	10.04.2025
Ligjëratë: “Imunizimi dhe vaksinimi”	24.04.2025
Ligjëratë: “Sterilizimi në stomatologji”	22.05.2025
Ligjëratë: “Marrja e mostrave për analiza stom.”	19.06.2025
Ligjëratë: “Përparësitë e të ushqyerit me gji”	07.08.2025
Ligjëratë: “Mamografia dhe rtg”	05.09.2025 & 25.09.2025
Ligjëratë: “Shëndeti i gjirit në duart tona-Kontrolli dhe mamografia”	12.09.2025
Ligjëratë: “Vizitat në shtëpi për nëna dhe fëmijë”	01,02.10.2025
Ligjëratë: “Rëndësia e zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit dhe vetëekzaminimi i gjirit”	03.10.2025
Ligjëratë: “Planifikimi dhe Dispensimi i Barnave”	03.10.2025
Ligjëratë: “Mbingarkesa në punë dhe menaxhimi i stresit”	03.10.2025 dhe me 16.10.2025
Ligjëratë: “Kateterizimi urinar”	06.10.2025
Ligjëratë: “Kujdesi infermieror te pacientët në kujdesin shtëpiak”	27.11.2025
Ligjëratë: “Procedurat dhe teknikat e larjes së veshit dhe syrit”	18.12.2025
Ligjëratë: “Etika, parimet etike dhe legjislacioni në infermieri”	18.12.2025

III. SEKTORI I STOMATOLOGJISË

Sektori i Stomatologjisë në kuadër të QKMF – së në Ferizaj organizon punën në tri shtylla kryesore:

1. Shërbimet stomatologjike primare - shtrihet përveç QKMF – së edhe nëpër QMF-të në qytet dhe disa fshatra
2. Shërbimet stomatologjike sekondare - në QKMF dhe
3. Laboratori dentar - vetëm në QKMF.

Numri i shërbimeve të ofruara në këtë sektor gjatë *dymbëdhjetë muorit Janar-Dhjetor* është paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela 8. Shërbimet stomatologjike :

Llojet e shërbimeve	Me pagesë	Pa pagesë	Totali
Vizita specialistike	254	1893	2147
Vizita stomatologjike	2514	12561	15075
Nxjerrje me anestezion	977	1983	2960
Nxjerrje pa anestezion	40	1642	1682
Aplikim i barit me anestezion	21	52	73
Drenazhë	400	2702	3102
Aplikim i barit	234	4249	4483
Ekstirpim vital me mbushje	7	50	57
Ekstirpim mortal	105	400	505
Mbushje e kanalit	105	355	460
Amalgam pllombë	162	285	447
Helio pllombë	435	977	1412
Largimi i shtresave të buta	36	88	124
Pastrimi i dhëmbëve	68	213	281
Përpunimi i xhepit paradontal	4	30	34
Incizioni	39	113	152
Alveoliti	11	41	52
Ndalja e gjakderdhjes	6	31	37
Kiretazha	42	107	149
Rindërtimi me vidë	1	4	5
Heqja e urës	1	9	10
Cementimi i urës	5	8	13
Proteza parciale	10	25	35
Proteza totale	56	105	161
Kurora porcelani	0	0	0
Cementimi i kurorës	2	0	2
Reparatura	46	109	155
Korrektura e protezës	3	206	209

Ribazimi i protezës	0	9	9
Vendosja e dhëmbit në protezë	12	67	79
Apikotomia	1	3	4
Amputimi i rrënjës	4	6	10
Frenotomia	0	1	1
Florizimi	0	19	19
Vulosja e fisurave	0	30	30
Vizita sistematike	0	74	74
Totali	5605	28456	34044

Ndërsa, numri i shërbimeve të ofruara gjatë *dymbëdhjetë muorit Janar-Dhjetor* në secilën njësi të Sektorit të Stomatologjisë është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 9. Shërbimet stomatologjike sipas qendrave

Qendra	Numri i pacientëve	Numri i shërbimeve
QKMF	9088	14508
QMF 1	1335	2222
QMF 2	636	1147
QMF 3	689	1202
QMF 4	2142	3488
QMF 5	172	248
QMF 6	399	678
QMF 7	281	533
QMF 8	229	424
QMF 9	359	612
QMF 10	369	640
Kujdestaria e te shtunave	438	788
Kujdestaria e natës	3505	6045
Kujdestaria e të dielave	802	1509
Gjithsej	20444	34044

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmblëdhur rezultatet e të gjitha shërbimeve mjekësore, infermierike dhe të tjera të ofruara në të gjitha qendrat dhe njësitë gjatë *dymbëdhjetë muorit Janar-Dhjetor, 2025*.

Tabela20. Të gjitha shërbimet e ofruara në QKMF gjatë dymbëdhjetë muorit Janar-Dhjetor 2025

QKMF - FERIZAJ		RAPORTI I PËRGJITHSHËM JANAR-SHTATOR 2025		
REKAPITULIM I SHËRBIMEVE NË QKMF-FERIZAJ				GJITHSEJ
	VIZITA MJEKËSORE	Vizita nga MF dhe MP	200660	217259
		Vizita të përsëritura	11065	
		Vizita specialiste	5534	
SHËRBIMET INFERMIERIKE DHE TË TJERA	SHËRBIMI EMERGJENT PRIMAR		33572	643880
	KAN-Edukim		4169	
	THERRJE I.M.		61397	
	THERRJE I.V.		2370	
	INFUZONE		20734	
	LIDHTORE		15375	
	TRIAZHIME		118342	
	INHALIME		1019	
	VIZITA SHTËPIAKE PALIATIVE		8142	
	VIZITA SHTËPIAKE PËR NËNA DHE FËMIJË		3186	
	KËSHILLA		121442	
	KATETERIZIM		492	
	LABORATORI	ANALIZA URINE	12524	
		ANALIZA GJAKU	129696	
	EKG		4349	
	SHËRBIMI PODIATRIK		487	
	KËSHILLA PËR GRA SHTATZËNA		116	
	PSIKOLOGU		998	
	MATJA E GLIKEMISË		640	
	VAKSINA		29273	
	RTG		11888	
	LOGOPEDI		857	
	GRUPET VETPËRKRAHËSE PËR DIABETIKË		0	
	SHPËRLARJA E VESHIT		431	
	CERTEFIKATA MJEKËSORE		31	
	SHËRBIME NË FARMACI		54330	
	OKSIGJENOTERAPIA		2	
	SHPËRLARJA E SYRIT		44	
	DEBRIDMAN I THOIT		9	
	MAMOGRAFIA		2208	
	SHËRBIME ANTITUBERKULARE		1477	
	PPD		475	
	ECHO		199	
	FIZIOTERAPI		2470	
	SHËRBIME PATRONAZHI		1136	
	SHËRBIME STOMATOLOGJIKE		34044	
GJITHSEJ SHËRBIME NË QKMF				895183

IV. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Raport pune Janar-Dhjetor 2025

Departamenti i administratës qysh në fillim të janarit listoi mbi 65 objektiva për vitin 2025.

U organizuan takime javore, mujore me personelin e administratës për problemet, sfidat dhe objektivat në kuadër të këtij viti, më pastaj u organizua takim me mirëmbajtëse, takim me shoferë, takim me inkasantë, takim me IT e QKM-së, takim me IT e OIK-ut.

4.1. ZYRA PËR SHËRBIME JURIDIKE

Në këtë shërbim aktualisht mbahet dosja personale për **318 punëtorë**, të cilët në intervale të ndryshme marrin pushime pa pagesë, pushime të lehonisë, pensionohen etj.

Gjatë periudhës *dymbëdhjetë mujore Janar-Dhjetor* përmes arkivit të këtij shërbimi kanë kaluar **2409** shkresa.

Tabela 22. Shkresat e protokolluara në arkiv

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Kërkesa	31	27	38	38	44	61	73	132	63	135	40	76	757
Vërtetime	36	26	20	34	59	8	19	7	13	6	16	25	269
Raporte	2	3	1	2	3	3	2	6	1	3	4	1	31
Njoftime	2	2	2	1	11	12	3	3	2	3	1	4	47
Vendime	11	32	22	20	52	37	42	58	27	59	23	63	446
Të tjera	92	110	86	68	29	40	107	84	71	84	40	48	859
Totali	174	200	169	163	198	161	246	290	177	290	124	217	2409

4.1.1. Shërbimi teknik dhe i mirëmbajtjes

Përveç obligimeve të përditshme punëtorët e këtij shërbimi kanë kryer edhe punë të tjera, si: rregullimin e pajisjeve të ndryshme, punët e zdrukthëtarisë, ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik, mirëmbajtjen e oborrit si në QKMF ashtu edhe në objektet e qendrave të tjera (QMF) brenda qytetit dhe në AMF-të dhe QMF-të nëpër fshatra, objektin e SHEP, QTMF dhe DAT-it. Gjatë *dymbëdhjetë mujërit Janar-Dhjetor* punëtorët e këtij shërbimi kanë mbikëqyrur sistemin e ngrohjes në të gjitha objektet, kanë ndezur kaldajat me pelet, ato me dru dhe naftë duke i mirëmbajtur dhe furnizuar me lëndë djegëse në vazhdimësi. Gjithashtu, personeli i shërbimit teknik është marrë edhe me riparimin e defekteve në sistemin e tubave të ujësjellësit, defektet në rrjetin elektrik, riparimin dhe mirëmbajtjen e dyerve etj. Është bërë furnizimi me gaz dhe oksigjen i QMF-ve dhe AMF-ve. Personeli i mirëmbajtjes çdo ditë është marrë me pastrimin e hapësirave të punës në të gjitha objektet, si dhe rregullisht është bërë larja dhe hekurosja e manteleve për tërë stafin dhe çarçafëve për shtretërit e pacientëve.

4.1.2. Shërbimi i Autoambulancave dhe Servisimit

Autoparku është i pajisur me autoambulanca prej të cilave disa janë të reja e disa në gjendje jo të mirë, madje mund të thuhet se janë ende në qarkullim falë angazhimit të punëtorëve rreth mirëmbajtjes dhe servisimit të rregullt.

Raporti i autoparkut dhe servisimit përbëhet nga:

1. Raporti për qarkullimin e autoambulancave, relacioni i tyre dhe
2. Raporti për harxhimet e derivateve dhe kilometrat e kaluara

Tabela 23. Relacionet e qarkullimit të veturave

Nr.	Relacioni	Arsyeja	Numri i përgjithshëm
1	Prishtinë	Zyrtarisht, seminare, trajnime, barna, BK-ja- rentgen Bocat Oksigjen_-servisimet Automjetet	91
2	Prishtinë	Raste - Spitali	132
3	Punktet	Vizita Zyrtarisht	219
4	Lokal +Komune	Dalje Zyrtare	179
5	QMF – I – edhe QMF –II-	Vizita - Shtëpiake	534
6	QMF – IV -	Vizita - Shtëpiake	317
7	QKMF- Vizita	Vizita - Shtëpiake	339
8	Vizita Nëna dhe fëmijë	Lokal - Fshatra	901
9	Maqedonia e veriut	Raste	5
10	Vaksinimi	Terren	Sipas Orarit
11	Hemodializë	Raste sipas Orarit	Çdo ditë -3 Kombi -1Limuzin
12	Raste Lokal	Paramedik-2	345
13	Raste bartje nga Spitali në shtëpi dhe anasjelltas	Paramedik -3	137
14	Aktivitet sportive	Futball	Sipas orarit sportiv
15	Shqipëri	Raste	3
16	Gjilan	Trajnim	15

Tabela 24. Shpenzimet e automjeteve

Targa e Automjeteve	Kilometrat mëparshme	Kilometrat e tashme	Totali kilometrave të kaluara	Derivatet e harxhuara	Përqindja
05-936-AB Mercedesi	327819	330846	3027	409.33	13.52%
05-702-EB VW T5	307560	308634	1074	128	11.92%
05-835-AC Xhipi DSM	209992	210211	219	64	29.22%
05-831-AC (vaksinimi)	283501	291041	7540	730.5	9.69%
05-703-EB-VW T5	243390	243485	95	0	0.00%
05-373-BP VW T6	188550	188954	404	0	0.00%
05-389-CH VW T7	351247	372362	21115	1968,44	9.32%
05-116-CO VW T7	177006	178380	1374	176	12.81%
05-117-CO VW T6	306190	306340	150	124	82.67%
05-717-GM-Renault	524807	527106	2299	200.01	8.70%
05-311-CM VW T7	247979	259397	11418	1135.97	9.95%
05-944-DD Mitsubishi	267290	271501	4211	536.51	12.74%
05-908-DD Kia	139570	154422	14852	1264	8.51%
05-647-FJ	58629	58701	72	0	0.00%
05-104-FD (Autoambulanca)	191428	198756	7328	1212.23	16.54%
05-277-FB Kamioneta	201418	209149	7731	898.13	11.62%
05-Z-36-25	140323	142613	2290	208	9.08%
05-588-FT	28925	34928	6003	684.59	11.40%
05-Z-35-25	61200	79421	18221	1682.22	9.23%
05-150-GL	25079	36206	11127	936	8.41%
05-289-GN Citroen	45157	52647	7490	579	7.73%
08-802-FP	59190	63757	4567	394	8.63%
05-980-HK Opel	11385	38666	27281	2843.37	14.09%
05-980- HI OPEL	13040	26260	13220	1915.05	14.49%
05-740-HO KOMBI	237560	239143	1583	116.5	7.36%
05-409- FF GOLFI	326698	332663	5965	549	9.20%
OPEL MERIVA	452848	454204	1356	276	20.35%
Gjithsej:			193451	19754.85	10.21%

4.2. ZYRA PËR BUXHET DHE FINANCA

QKMF në Ferizaj gjatë këtij dymbëdhjetë mujori ka pasur në dispozicion buxhet në vlerë prej 5,392,207.68€ i cili përbëhet nga granti specifik për shëndetësi dhe të hyrat vetanake.

Buxheti është shpërndarë në këto kategori: *Paga dhe mëditje, Mallra dhe shërbime, Komunale dhe Kapitale.*

Tabela 26. Kategoritë buxhetore

Kategoritë buxhetore	Shuma	%
Pagat	3,337,687.68€	61.91%
Mallra dhe shërbime	1,499,230.76 €	27.81%
Shpenzime komunale	79,998.78 €	1.48%
Shpenzime kapitale	473,999.00 €	8.79%
Totali	5,390,916.22€	100.00%

TË ARRITURAT

Janë bërë kërkesa për inicime për shpalljen e tenderëve për plotësimin e nevojave të QKMF-së, për:

- Furnizim me pajisje stomatologjike ,laboratorike e radiologjike, „Furnizim me pajisje për mjekësi familjare”,,
- Furnizim me blloka participimi” dhe „Furnizim me material higjenik”;
- Renovimi i laboratorëve në QMF6-Pleshinë dhe QMF7-Neredime, furnizimi i tyre me pajisje laboratorike nga Projekti AQH dhe funksionalizimi i tyre.
- Furnizimi me inventarë dhe pajisje tjera të nevojshme i dhomës së Këshillimores për EPSH në QMF-1 e për pritore të pacientëve të kësaj qendre dhe në QMF-4 nga Projekti AQH;

- Vazhdimi i punimeve në objektin e ri të QKMF-së të objektit të QMF-së në fsh.,Koshare’
- Finalizimi i punimeve në objektin e ri të QMF-2 në qytet;
- Në Departamentin e Administratës së QKMF-së është bërë digjitalizimi i arkivit të QKMF-së;
- Shoqata “Qëndresa Kosovare” me sponsor nga Kuvajti, QKMF-së i dhuroi një veturë të tipit Golf 7 për transportin e ekipeve të shërbimeve shtëpiake paliative dhe atyre për Nëna e Fëmijë të QMF-1;
- Përfitimi i donacionit të një autoambulance të re nga MSH;
- Nga 8 Tetori ka filluar zbatimin e kontratës për plotësimin e nevojave të shërbimeve të
- kujdesit social, shëndetësor, shtëpiake dhe ambulator me kontratë - kornizë 24 muajshe;
- Plotësimi i të gjithë indikatorëve të SMC-së ,të 12 Blloqeve sipas Planit të Veprimit të QKMF-së në Komunën tonë, që ka mundur inicimin e mbajtjes së Simpoziumit të I-rë për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore të QKMF-ve në nivel vendi.

**SHTËPIA E KOMUNITETIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA MENDORE-
FERIZAJ**

RAPORT PUNE PËR PERIUDHËN 01/01/2025- 31/12 /2025

- *Gjendja shëndetësore e rezidentëve*
- *Furnizimi me ushqim, barna, material higjienik, ujë, rrymë etj.*
- *Donacionet*
- *Aktivitetet me rezidentë*
- *Vizitat e QPS-ve dhe familjarëve*
- *Sfidat dhe pengesat në punë*

Rezidentët momentalisht: 11 (6.M, 5.F)

Gjendja shëndetësore e rezidentëve

Periudha për të cilën po raportojmë pothuaj të gjithë rezidentët kishin shëndet të mirë dhe stabil. Gjatë muajit Mars dhe fillim të muajit Prill zakonisht në periudhën e kalimit nga sezoni i dimrit në sezonin e pranverës disa nga rezidentët shfaqin një lloj agresiviteti të pa përballueshëm ndaj stafit, ndaj rezidentëve tjerë dhe duke dëmtuar edhe inventarë apo gjësende në momentin e caktuar që ka para vetes. Ne kemi marrë masat paraprake për këto raste duke njoftuar mjekun psikiatër gjatë gjithë kohës për ta mbajtur në kontroll e më stabil gjendjen e tyre.

Vizitat e rregullta të parashikuara i realizojmë çdo herë në kohë, vizita psikiatrike, të përgjithshme dhe analizat në çdo gjashtë muaj. Stafi ynë ka qenë aktiv dhe në përkujdesje të rezidentëve gjatë gjithë kohës, ku kemi përcjellë gjendjen e tyre shëndetësore.

Furnizimi me ushqim, material higjienik, barna, ujë, rrymë, derivate etj.

Si zakonisht kompanitë e autorizuar e sjellin ushqimin nga fundi i javës së parë të muajit, ku së bashku me menaxheren e kontratave të ushqimit verifikohet që malli i sjellë të jetë sipas sasisë dhe cilësisë së kërkuar paraprakisht dhe vazhdimisht duke kompletuar dokumentacionin e nevojshëm përcjellës siç janë fletë dërgesat dhe vendimet për pranimin e çdo furnizimi.

Sa i përket furnizimit me barna dhe terapi të rregullt, jemi furnizuar sipas kërkesës dhe nevojave tona. Pas përzgjedhjes së operatorit, furnizimi është i rregullt dhe nuk kemi asnjë problem të furnizimit me barna esenciale, vlen të ceket se kemi vështirësi të barnave të paparashikuara.

Donacionet

Tek donacionet duhet cekur gjithsesi një gjest bamirësie të qytetarit B. Avdiut i cili punon në Gjermani dhe kishte shprehur dëshirën që gjatë gjithë muajit të Ramazanit të siguroj iftarin për 13 persona dhe për tri ditë festë (Bajram) ushqimin e drekës ku ka kontraktuar një gjellëtoke nga qyteti për të dërguar në institucionin tonë.

Gjithashtu një donacion i nevojshëm për veshmbathje, jorganë, çarçafë, enë për kuzhinë pranuar nga Imami Bekim Alimi.

Tjetër donacion për lehtësimin e mbarëvajtjen më të lehtë të punëve pranuar nga familjari i rezidentes, një rrobalarëse dhe një rroba tharëse. Mbështetje pothuajse për çdo festë pranojmë ëmbëlsira të ndryshme e ushqime tjera nga Shoqata Humanitare “Zgjatma Dorën”-Ferizaj.

Gjithashtu donacion shumë i nevojshëm dhe me rëndësi të veçantë është dhuruar nga Organizata Internacional Charity Organization, ku na janë ndarë 100 batanije për rezidentët tanë.

Më datë 31/12/2025, kemi pranuar donacion nga Organizata Humanitare Bereqeti, e cila na ka furnizuar me pajisje kuzhine moderne, veshmbathje për secilin rezident. Bashkëpunimi me këtë organizatë për pajisje me shtretër për rezident më të rehatshëm e më modern pritet të furnizohemi në pjesën e parë të vitin 2026. Gjithashtu edhe pajisje e gjëra tjera që janë më se të nevojshme për mirëqenie në SHBKF.

Janë siguruar 5 kondicionerë nga DSHMS për hapësirat e Shtëpisë. Kemi rregulluar muret e depove të ushqimit muret dhe pjesën e sipërme.

Kemi pasur vizitë nga organizata The Christ of Jezus Christ nga të cilët presim finalizimin për donacionet e radhës në teknikë të bardhë.

Aktivitetet e stafit me rezident

Në Shtëpinë e Komunitetit në Ferizaj asnjëherë nuk kanë munguar aktivitete të ndryshme me rezident por në muajt e fillim vitit kryesisht angazhohen në vizatime, lojëra me letra ,vallëzim etj. Rezidentët kanë gëzuar një vizitë një javore (7-ditë) në Prevallë. Gjithashtu gjatë stinës së verës i kemi dërguar disa herë në aktivitete njëditore në Neredime e Jezerc.

Vizitat e OPS-ve dhe familjarëve të rezidentëve

Vizitat e familjarëve me rezident realizohen, varësisht nga kërkesat e familjarëve.

Në këtë periudhë janë realizuar vizita nga Qendra për Punë Sociale si nga Ferizaj, Prishtina, Vitia, Malisheva.

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025 I QENDRËS PËR PUNË SOCIALE - FERIZAJ

Qendra për Punë Sociale është institucion publik profesional i nivelit komunal, kompetente për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale. Qendra për Punë Sociale ofron shërbime sociale profesionale duke u bazuar në mandatin që i japin ligjet në fuqi si Ligji Nr. 08/L-255 Për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligji Nr. 06/L-084 Për Mbrojtjen e Fëmijës, Ligji Nr. 2004/32 Për Familjen i Kosovës, Ligji Nr. 2003/15 Për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, Kodi për të Mitur në Kosovë e shumë rregullore dhe udhëzime administrative.

QPS ofron shërbime sociale profesionale për mbi 70 kategori të ndryshme sociale, për gjithë fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijë i braktisur, fëmijë jetim, fëmijë me sjellje asociale, delikuent i mitur, shkurorëzimet dhe besimin e fëmijëve, kontaktimet fëmijë – prind, të moshuarit pa përkujdesje dhe vendosja e tyre në institucione, të sëmundjes trupore ose aftësive të kufizuara fizike, të aftësive të kufizuara mendore, të sëmundjes mendore të rrezikut nga shfrytëzimi ose abuzimi, të dhunës në familje, të trafikimit të qenieve njerëzore, krimeve seksuale, fëmijët në situatë rruge, dhuna në shkollë, të varësisë nga alkooli ose drogat, të emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu, ose për ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona nevojtarë etj.

Gjithashtu QPS-të ofrojnë edhe shërbimin e ndihmës së Asistencës Sociale, ku aktualisht përfitues të Asistencës Sociale janë 633 familje të cilët për çdo muaj kanë nevojë për shërbime të QPS-së, intervenimet me pako ushqimore dhe higjienike, intervenimet në kohë krizash siç është pandemia etj.

Veprimtaria e QPS-së përfshinë ofrimin e përkujdesit dhe mirëqenies sociale për banorët e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror, përmes ofrimit dhe zbatimit të konceptit të punës sociale dhe mirëqenies sociale në kuadër të sistemit unik të përkujdesit dhe mirëqenies sociale në Kosovë.

Koncepti i përkujdesit social konsiston në atë që banorëve të Komunës t’iu ofroj dhe zbatoj përkujdes dhe mirëqenie sociale, këshillime gjithëpërfshirëse dhe efikase, të bazuar në të dhëna shoqërore: Psikologjike, punë sociale, sociologji, juridik, pedagogji, përmes caktimit të ekspertëve profesional të cilët për rastet në nevojë sociale do të jenë të domosdoshëm në sistemin e përkujdesit social dhe të mirëqenies sociale dhe njëherësh pikë referuese për specialistët konsulent në përkujdesin dhe mirëqenien sociale.

Stafi profesional i QPS-së ka mandatin kryesor në situatat e vendimmarrjes për caktimin e kujdestarit ligjor, për besimin e fëmijëve të prindërve të ndarë, për vendosjen e fëmijëve në adoptim vendor e ndërkombëtar, pëlqimin për shitjen e pasurisë së të miturve, vendimin për udhëtim jashtë vendit, vërtetimin që nuk iu është marr e drejta vepruese për armëmbajtje, që nuk është nën kujdestari, vërtetimin që nuk ka obligime të pa përmbushura, për humbjen e shtetësisë së Kosovës, kujdestar ligjor për të moshuarit pa përkujdesje familjare apo për të rriturit që iu është hequr e drejta vepruese, vendime për përfitim të SAS (Skemës së Asistencës Sociale) e shumë të tjera.

Stafi i QPS është palë në secilën procedurë kur kemi të bëjmë me fëmijë dhe të rritur pa përkujdesje familjare, në secilin intervenim në Polici brenda orarit dhe jashtë orarit të rregullt të punës, si dhe fundjavave dhe festave zyrtare. Përkujdesi dhe mirëqenia sociale në QPS-së sigurohet dhe zbatohet nga zyrtarët e shërbimeve sociale dhe të skemës sociale të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me dispozitat e ligjeve në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e punës në Kosovë.

Qendra për Pune Sociale ndahet në tre sektorë:

- Sektorin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare
- Sektorin e Asistencës Sociale dhe
- Sektorin e Administratës

RAPORTI I PUNËS SË SHËRBIMEVE SOCIALE PËR VITIN 2025

Shërbimet Sociale veprojnë sipas Ligjit të Shërbimeve Sociale dhe Familjare - Ligji nr. 08/L-255, Ligji i Familjes 2004/32, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve - Ligji Nr.06/L-084, Kodi Penal i Republikës së Kosovës - Kodi Nr. 06/L-074, Ligjit të Zyrtarëve Publik e shumë rregullore dhe udhëzime administrative.

Kategoritë mbrojtëse	Rastet e vjetra (Aktive)	Intervenimet	Rastet e reja 2025	Intervenimet
Delikuenca e të miturve	366	898	139	1112
Fëmijët me sjellje asociale	122	238	54	220
Fëmijë të keqtrajtuar fizikisht	13	59	8	95
Fëmijë të keqtrajtuar psikikisht	5	24	3	35
Fëmijë të keqtrajtuar seksualisht	20	59	7	78
Fëmijët e braktisur të porsalindur	17	30	1	10
Fëm.pa përk.pr.të strehuar tek të afërmit me pagesë	49	107	4	30
Kërkesa për fëmijë me aftësi të kufizuara	51	255	60	105
Fëmijë me aftësi të kufizuara në pagesë	211	700	45	85
Kujdestaria ndaj fëmijëve	21	81	5	55
Kërkesa për adoptim vendor	15	45	1	10
Kërkesa për adoptim ndërkombëtar	0	0	0	0
Fëmijë jetim	10	50	2	0
Rrëmbime ndërkombëtare	0	0	0	0
Vendosja ne Strehimore	16	53	9	78
Dhuna në familje	215	1075	131	1150
Viktima të krimeve seksuale	6	30	1	20
Viktima të trafikimit	0	0	4	75
Këshilla martesore	0	0	8	73
Besimi i fëmijëve	71	355	96	1000
Familje strehuese	7	20	0	0
Mbrojtja e personave të moshuar	4	35	0	0
Klientë tjerë	1520	4666	844	1550
Puna e rrezikshme	17	85	6	25
Përdoruesit e substancave narkotike	5	25	2	25
Përdoruesit e alkoolit	0	0	0	0
Martesa e të miturve	0	0	9	70
Intervenime të tjera			1930	780
Gjithsej:	2761	9845	3369	6681

Sqarim: Kategoritë e prezantuara në tabelën më lartë janë kategoritë që trajtohen nga Sektori i Shërbimeve Sociale dhe Familjare, ku në rubrikën rastet e vjetra, janë raste të cilat me vite punohet nga ky sektor që d.m.th. ende ka nevojë për ofrimin e shërbimeve sociale, ndërsa në rubrikën Rastet e reja 2025, janë rastet të cilat për herë të parë kanë kërkuar shërbime sociale në vitin 2025, ndërsa tek rubrika Intervenimet janë të gjitha shërbimet që ofrohen për klientët, sipas kategorive, përfshirë: vizitat, deklaratat, ndihmën e përgjithshme, vendosjen në strehimore, në shkolla etj.

Zyrtarët e Shërbimeve Sociale kanë prezantuar në Polici, në Prokurori, kanë marr pjesë në seanca gjyqësore, për çdo rast që janë kontaktuar nga institucionet ndërlidhëse. Janë bërë disa sanime martesore, ku kemi arritur që përmes këshillave psiko-sociale të rregullohen marrëdhëniet bashkëshortore, po ashtu tek rastet e kontakteve të fëmijëve me prindër është bërë një punë jashtëzakonisht e madhe ku kemi arritur që të realizojmë kontaktet e prindërve me fëmijët e tyre të cilët nuk janë takuar për shumë vite.

Gjithashtu punë jashtëzakonisht e madhe është bërë edhe tek kategoria e dhunës në familje ku përmes këshillave psiko-sociale dhe referimeve të rastit tek psikologët klinik është arritur që të përmirësohet shëndeti mendor i viktimave. Edhe pse numri i rasteve të dhunës është 131, QPS punon me një gamë të gjerë të anëtarëve të familjes së viktimës, siç janë fëmijët e viktimës, prindërit e tyre, vëllezërit, motrat, familjarët e bashkëshortit/es, me organizata të ndryshme për strehim të viktimave etj.

QPS ka arritur që të ketë marrëdhënie shumë të mira me institucionet që ndërlidhen me shërbime sociale, siç janë Gjykatat, Prokuroritë, Mbrojtësit e Viktimave, Policia, shkollat fillore dhe të mesme, Drejtorinë e Arsimit, me Zyrën për Komunitete, Strehimoren, me organizata të ndryshme vendore e ndërkombëtare etj.

Raporti vjetor i punës së Shërbimit të S.N.S – së (Asistencës Sociale)

Nëpunësit e S.N.S-së të Qendrës për Punë Sociale në Ferizaj kanë pranuar të gjitha kërkesat e asistencës sociale në harmoni të plotë me Ligjin 2003/15. Në vitin 2025 - numri i kërkesave që kanë aplikuar për herë të parë është :

Muaji	Aprovuar	Refuzuar	Shqyrtim	Gjithsej
Janar	6	0	0	6
Shkurt	13	0	0	13
Mars	4	0	0	4
Prill	7	0	0	7
Maj	4	0	0	4
Qershor	4	0	0	4
Korrik	2	0	0	2
Gusht	0	0	0	1
Shtator	1	0	0	1
Tetor	7	1	0	8
Nëntor	5	0	0	5
Dhjetor	5	0	0	5

Nga lista e familjeve të larguar nga pagesave për mos ri aplikim janë si më poshtë:

Muaji	Numri i familjeve
Janar	12
Shkurt	11
Mars	15
Prill	16
Maj	18
Qershor	17
Korrik	13
Gusht	15
Shtator	13
Tetor	18
Nëntor	16
Dhjetor	13

NUMRI I FAMILJEVE QË JANË VERIFIKUAR DHE RIVERIFIKUAR

Muaji	Aprovuar	Refuzuar	Totali
Janar	105	11	116
Shkurt	83	9	92
Mars	114	11	125
Prill	68	13	81
Maj	70	15	85
Qershor	64	16	80
Korrik	52	11	63
Gusht	60	4	64
Shtator	67	5	72
Tetor	68	7	75
Nëntor	69	8	79
Dhjetor	71	11	82

Gjatë riverifikimit nëpunësit e S.N.S-së kanë refuzuar - 121 - familje që nuk i plotësojnë kriteret sipas Ligjit të SAS-it, 2003/15. Prej familjeve që kemi ri verifikuar janë aprovuar 884 kërkesa të Asistencës Sociale. Nëpunësit e SNS-së mesatarisht për çdo muaj kanë realizuar përafërsisht 143 ri aplikime, këtu hyjnë edhe lëndët e vjetra edhe të reja.

Gjatë periudhës njëvjeçare: janë dërguar 304 lëndë në komision mjekësor, 286 kërkesa janë aprovuar nga komisioni mjekësor, kurse 2 kërkesa janë kthyer për kompletim të dokumentacionit mjekësor dhe njëherit nga komisioni mjekësor janë refuzuar - 16 lëndë. Numri i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit e ndihmave sociale për këtë nëntëmujorin e parë janë 7 ankesa. Nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - DNS (shkalla e dytë) janë refuzuar - 7 - ankesa, ndërsa nga DNS -ja janë aprovuar 0 ankesa, në shqyrtim janë 0 ankesa.

Janë lëshuar 406 vërtetime për familjet që janë dhe nuk janë shfrytëzues të asistencës sociale dhe për rregullimin e dokumentacionit për bursë dhe për udhëtim (mujores) si dhe për aplikim për banim.

DONATORËT

1. Organizata "Emiratet e Bashkuara Arabe" ndihmoi 150 familje me pako ushqimore
2. Donatori "Eli-Ab" ndihmoi 500 familje me pako ushqimore
3. Organizatën "Amaneti" ndihmoi 170 familje me pako ushqimore
4. Donatori Policia e Kosovës -Stacioni Policor Ferizaj, ndihmoi 16 familje me pako ushqimore
5. Organizata "International Charity Organization" ka shpërndarë 25 shporete për ngrohje me dru, njëherit ka shpërndarë 300m³ dru për ngrohje dhe nga 2 batanije për 100 familje të komunës sonë.

RAPORTI VJETOR I SHPËRNDARJES SË NDIHMAVE SOCIALE SIPAS KATEGORIVE

Muaji	Kategoria 1	Kategoria 2	Nr. i familjeve	Nr. i anëtarëve	Totali
Janar			671	2564	84,230.00 €
Shkurt			676	2580	85.100.00 €
Mars			662	2501	82,870.00 €
Prill	463	191	654	2481	81,950.00 €
Maj	470	190	660	2510	83,050.00 €
Qershor	469	188	657	2495	82,300.00 €
Korrik	473	182	655	2473	81,590.00 €
Gusht	475	178	653	2469	81,840.00 €
Shtator	467	174	651	2463	81,640.00 €
Tetor	466	182	648	2468	98,400.00 €
Nëntor	468	179	647	2461	97,788.00 €
Dhjetor	459	174	633	2407	95,220.00 €

Familjet shfrytëzuese të asistencës sociale të zëna nga ATK - ja, të cilat punojnë në firma të ndryshme dhe kanë përfituar ndihmën sociale pa bazë ligjore.

Muaji	Kateg -I-	Kateg -II -	Totali
Janar	4	0	4
Shkurt	5	0	5
Mars	7	1	8
Prill	4	0	4
Maj	6	1	6
Qershor	4	0	4
Korrik	3	0	3
Gusht	5	0	5
Shtator	4	1	5
Tetor	6	2	8
Nëntor	7	1	8
Dhjetor	4	1	5

Nga njoftimet me shkrim të DPSF/MFPT – në, në bashkëpunim me ATK-në, jemi të njoftuar se - 65 - familje si shfrytëzuese të ndihmave sociale e që kanë anëtar të familjeve të tyre të punësuar.

Gjatë konsultimit me 65 shfrytëzuesit e SNS-së të cilët janë hasur duke punuar dhe njëherit duke i njoftuar me procedurat dhe pasojat që mund t'i kenë për mos kthimin e pagesave, kemi arritur që t'i bindim për kthimin e ndihmës sociale disa prej tyre.

Raporti i Sektorit të Administratës dhe Financave

- Kemi bërë kërkesat e materialit shpenzues për nevojat e QPS (ngjyra të printerëve, letër, regjistrator, mbushja e klimave, etj.).
- Në bazë të kërkesave tona operatorët ekonomik janë përgjigjur kërkesave sipas porosive;
- Kemi bërë përpilimin e listave për vlerësim të inventarit;
- Kemi kryer edhe të gjitha punët e arkivit në QPS për dy sektorët (Sektorin e Shërbimeve Sociale ku në Sektorin e Shërbimeve Sociale janë protokolluar shkresa të ndryshme si lëndë të reja, vërtetime të ndryshme dhe lëndë në procedurë ankese, vendime etj. ku numri i lëndëve të shërbimeve sociale që janë protokolluar është 2376 lëndë, ndërsa në sektorin e asistencës sociale kemi kryer punët administrative si vulosja e kartelave, aktvendimeve pranimit të ankesave, protokollimi i vërtetimeve të asistencës sociale ku numri i protokollit ka shkuar në 539 shkresa të ndryshme.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E PRONËS, GJEODEZISË DHE KADASTRIT

RAPORT I PUNËS PËR VITIN 2025

Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit e Komunës së Ferizajt është një nga strukturat kyçe administrative për menaxhimin e tokës, pronës dhe të dhënave kadastrale në territorin e komunës. Ajo është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, mirëmbajtjen e rrjetit referues homogjen, rikonstruktimin e informatave kadastrale në formë digjitale dhe funksionalizimin e sistemit informativ për tokën dhe pronën.

Në përmbushje të misionit të saj institucional, Drejtoria është e organizuar në tre sektorë funksional:

- Sektori i Pronës,
- Sektori i Kadastrit dhe
- Sektori i Gjeodezisë.

Më poshtë i gjeni të dhënat lidhur me lëndët e pranuar dhe të administruara nga tre sektorët e Drejtorisë.

I. SEKTORI I KADASTRIT

Sektori i Kadastrit është përgjegjës për regjistrimin dhe administrimin e pasurive të paluajtshme, duke përfshirë:

- Përpilimi i aktvendimet për ndërrime kadastrale;
- Përpilimi i aktvendimet për regjistrimin e hipotekave;
- Përpilimi i aktvendimet për regjistrimin e banesave dhe lokaleve;
- Përpilimi i aktvendimeve për ç 'regjistrimin e hipotekave;
- Përpilimi i aktvendimeve për regjistrimin dhe ç 'regjistrimin e ndalesave gjyqësore, barrëve tatimore, barrës së tatimit në pronë dhe ngarkesave tjera;
- Përpilimi i historiateve për lëndët sipas kërkesës së palëve dhe institucioneve tjera publike;
- Lëshon njoftime për plotësimin e lëndës;
- Regjistrimi i lëndëve në librat e ndërrimeve kadastrale në RDPP dhe azhurnimi në KCLIS;
- Regjistrimi i Hipotekave në librat kadastrale në RDPP dhe azhurnimi në KCLIS;
- Ç 'regjistrimi i Hipotekave në librat kadastrale në RDPP dhe azhurnimi në KCLIS;
- Regjistrimi i nën-ndarjeve të parcelave në librat kadastrale në RDPP dhe azhurnimi në KCLIS;
- Regjistrimi i bashkimit të parcelave në librat kadastrale në RDPP dhe azhurnimi në KCLIS;
- Lëshimi i vërtetimeve për ndihmë sociale, nevoja personale dhe Administratën Tatimore të Kosovës (ATK);
- Regjistrimi i ngarkesave tjera në librat kadastrale në RDPP dhe azhurnimi në KCLIS;
- Dhënia e informatave për parcelat gjeodetëve të licencuar;
- Dhënia e informatave për parcelat palëve.

1.1 Në sektorin e Kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:

Nr.	Lloji i lëndës	Numri i lëndëve
1	Bartje e posedimit-Blerje	2543
2	Bartje e posedimit-Dhurim	1610
3	Bartje e posedimit-Trashëgimi	416
4	Fshirje e hipotekës	190
5	Regjistrim i hipotekës	328
6	Bartje e posedimit-Ndarje fizike	111
7	Bartje e posedimit-Aktgjykim	66
8	Bartje e posedimit-Këmbim	68
9	Bartje e posedimit-Ndërtim kompensim	24
10	Fshirje e vërejtjes	84
11	Regjistrimi i vërejtjes	93
12	Fshirje e ngarkesave tatimore	110
13	Regjistrim i ngarkesave tatimore	123
14	Bartje e posedimit- Shpronësim	6
15	Regjistrim i servitutit	6
16	Shërbimi i të dhënave - Nxjerrja e Certifikatave	9268
17	Shërbimi i të dhënave- Vërtetim që nuk posedon pronë	314
18	Numri i lëndëve të refuzuara	106
	Totali	15466

Totali i kërkesave ose lëndëve të pranuar në Sektorin e Kadastrit (RDPP-së), gjatë vitit 2025 ka qenë 15,466 kërkesa, të përfunduara janë 13006 kërkesa, në procedurë janë 2460 kërkesa.

II. SEKTORI I GJEODEZISË

Sektori i Gjeodezisë është përgjegjës për:

- Zhvillimin e kapaciteteve gjeodezike;
- Mirëmbajtjen e rrjetit referues;
- Përpunimin dhe rikonstruktimin digjital të të dhënave kadastrale;
- Përcaktimin e saktë të pozicioneve të objekteve dhe parcelave.

Ky sektor është bazë teknike për funksionimin e kadastrit dhe për realizimin e projekteve zhvillimore në territorin e komunës.

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Aktivitetet kryesore kanë përfshirë:

- Identifikime,
- Modifikime kadastrale,
- Bashkime parcelash,

- Rregullime kufijsh dhe copëtime,
- Regjistrime objektsh dhe legalizime,
- Produkte kadastrale dhe shërbime të tjera profesionale

Kërkesat e pranuar në Sektorin e Gjeodezisë gjatë vitit 2025	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Të pezulluara	Të tërhequra
Identifikime	25	25			
Modifikime	3	3	/	/	/
Shpronësimet	/	/	/	/	/
Kërkesa për bashkim të parcelave	99	99	/	/	/
Rregullim kufiri dhe regjistrim copëtimi	61	61	/	/	/
Kërkesa për ndërrim kulture	57	57	/	/	/
Bashkim dhe regjistrim i copëtimit	230	230		8	
Regjistrim i copëtimit	994	965	11	10	2
Regjistrim i objekteve etazhe	35	35			
Regjistrimi i objektit - legalizim	143	143	/	/	/
Ri-regjistrim i pjesës grafike	72	72	/	/	/
Produkte kadastrale	1463	1462	/	/	1
Të ndryshme	2	2	/	/	
TOTALI	3184	3155	11	18	3

Totali i kërkesave ose lëndëve të pranuar në Sektorin e Gjeodezisë, gjatë vitit 2025 ka qenë 3184. Të përfunduara janë 3155 kërkesa, të pezulluara janë 18 kërkesa, janë refuzuar për arsye të ndryshme 11 kërkesa, janë tërhequr 3 kërkesa.

III. SEKTORI I PRONËS

Sektori i Pronës është përgjegjës për:

- Menaxhimin e pronave komunale,
- Mbajtjen e evidencave për tokën dhe objektet komunale,
- Zhvillimin e procedurave të shpronësimit dhe këmbimit të pronave,
- Trajtimin e uzurpimeve dhe procedurave administrative përkatëse.

Ky sektor luan rol strategjik në mbrojtjen e interesit publik dhe planifikimin e zhvillimit komunal.

1. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA -

1.1 Në Sektorin e Pronës janë pranuar kërkesat në vijim:

Kërkesat e pranuar në Sektorin e Pronës gjatë vitit 2025	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë
Uzurpime	24	16		8
Destinime dhe përgjigje në kërkesa	286	233		53
Shpronësime dhe Këmbimeve	17	5		12
Totali	327	254		73

NË LËMINË E UZURPIMEVE bëjnë pjesë: incizimet gjeodezike dhe caktimet e kufijve të rrugëve, lumenjve, objekteve shkollore, objekteve shëndetësore, zyrave të gjendjes civile, institucioneve fetare etj., të gjitha ato të cilat janë të poshtëshënuara.

1. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 3448-9 ZK. Ferizaj;
2. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 535-6 ZK. Talinoc i Jerlive;
3. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 86-2 ZK. Manastirc;
4. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 3480-0 ZK. Jezerc;
5. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 589-0 ZK. Jezerc;
6. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 166-0 ZK. Rahovicë;
7. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 2221-0, 2181-0,180-0,178-0, 177-0 dhe 182 ZK. Rahovicë;
8. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 280-0 ZK. Zllatar;
9. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 2229-4 ZK. Tankosiq;
10. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 760-6 ZK. Muhoc;
11. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 462-0, 461-0 ZK. Pojatë;
12. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 222-0, 238-0, 285-0 ZK. Fshati i Vjetër;
13. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 453-0 ZK. Pojatë;
14. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 451-12 ZK. Pojatë;
15. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 173-12 ZK. Zaskok;
16. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 3598-0 ZK. Komogllavë;
17. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 555-0 ZK. Balaj;
18. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 571-0, 576-0 ZK. Ferizaj;
19. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 503-1 ZK. Bablak;
20. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 1968-1, 169-0, 1970-0 ZK. Ferizaj;
21. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 2938-0 ZK. Ferizaj;
22. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 964-0 ZK. Prelez i Jerlive;
23. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 3448-9 ZK. Ferizaj;
24. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 1141-1 ZK. Kosinë;
25. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 1329-1 ZK. Gaçkë;
26. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 690-6 ZK. Talinoc i Jerlive;

27. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 1712-0 ZK. Varosh;
28. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 1056-2 ZK. Prelez i Jerlive;
29. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 131-1 ZK. Sojevë;
30. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 2182-0, 2181-0, 2180-0, 2179-0, 2178-0, 2177-0 ZK. Rahovicë;
31. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 807-2 ZK. Burrnik;
32. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 870-0 ZK. Prelez i Jerlive;
33. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 1053-3 ZK. Tankosiq;
34. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 2671-0 ZK. Komogllavë;
35. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 299-23,299-25, ZK. Ferizaj;
36. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 231-0 ZK. Mirosalë;
37. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 2483-0, 2425-0, 2430-0, 2431-0 ZK. Mirosalë;
38. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 710-0 ZK. Talinoc i Muhaxherëve;
39. Incizimi i ngastrës kadastrale me numër 1379-0 ZK. Sojevë;

NË LËMINË E DESTINIMEVE bëjnë pjesë: propozim-vendimet për shpalljen e interesit të përgjithshëm, propozim-vendimet për këmbimin e pronave komunale me pronat private, propozim-vendimet për destinimin e pronave komunale, propozim-vendimet për dhënien në shfrytëzim etj.

Po ashtu përfshihen kërkesat drejtuar Ministrisë së Financave – Departamentit të Tatimit në Pronë (ZVPP) për parcelat që janë në fazën e vlerësimit të tokave, si në fushën e shpronësimit ashtu edhe në fushën e këmbimit të pronave; përgjigjet në kërkesat e ushtruara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit për parcelat që janë në fazën e likuidimit; kërkesat e qytetarëve për ri-regjistrimin e parcelave; kërkesat e qytetarëve për faljen e paluajtshmërive të tyre për rrugë, varreza etj.; si dhe kërkesat brenda sektorëve drejtuar kadastrit dhe gjeodezisë për zbatimin e vendimeve në RDPP, lëshimin e certifikatave të pronës, produkteve kadastrale dhe kërkesave për copëtime etj.

PROPOZIM-VENDIME PËR KUVEND

1. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për zgjerimin e varrezave të fshatit Cërnillë.
2. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të fshatit Sojevë.
3. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Shtatores së Dëshmorit Zejnullah Zejna në fshatin Sojevë.
4. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e banorëve të fshatit Talinoc i Muhaxherëve.
5. Propozimi-Vendim për ndryshimin e destinimit të njësisë kadastrale 690-6 ZK. Talinoc i Jerlive.
6. Propozim-Vendim për aprovimin e kërkesave për blerjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e parablerjes.
7. Propozim-Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale 2262-0 ZK. Rahovicë, pronë e Komunës së Ferizajt.

8. Propozim-Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm të ngastrave kadastrale 1059-7 dhe 1059-8 ZK. Prelez i Jerlive, pronë e Kombinatit Bujqësor Industrial me qëllim të zgjerimit të varrezave në fshatin Prelez i Jerlive.
9. Propozim-Vendim për këmbimin e ngastrës kadastrale 2435-1 dhe 2435-2 ZK. Ferizaj, prone private me pjesën e ngastrës kadastrale 180-10 ZK. Talinoc i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt.
10. Propozim-Vendim për dhënien e pëlqimit NPL “Ambienti” SH.A për dhënien në shfrytëzim të njërive kadastrale 2025-0, 1038-0 dhe 1039-2 ZK. Ferizaj.
11. Propozim-Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit me nr.24 të datës 25.03.2021 i plotësuar me vendimin 01.Nr.68 të datës 31.03.2022 për parcelat të cilat gjenden në ZK. Sazli.
12. Propozim-Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale 777-15 dhe 776-6 me ng.kad. 736-0 ZK. Dremjak.
13. Propozim- Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pjesës së ngastrës kadastrale 719-0 dhe ngastrave kadastrale 715-2,715-3, 704-0, 708-0 dhe 714-0 ZK. Cërnillë.
14. Propozim-Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale 721-0 ZK. Nikadin me sipërfaqe prej 1426 m².
15. Propozim-Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale 3536-0, 3093-0 dhe 1023-9 ZK. Ferizaj, pronë private me qëllim të këmbimit të pjesës së ngastrës kadastrale 180-10 ZK. Talinoc i Jerlive, pronë e Komunës se Ferizajt.
16. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit, për vendosjen –ndërtimin e përkohshëm të zyrave të Organizatës “Miq të familjes Biden”-Ferizaj.
17. Propozim-Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale 835-0 dhe 834-0 ZK. Neredime e Ulët, pronë private.
18. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Lapidarit të Dëshmorit Gëzim Sahiti në fshatin Pojatë.
19. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të fshatit Slivovë.
20. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e bustit të Dëshmorit Hysni Kajtazi.
21. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e pllakës përkujtimore për të zhdukurin e luftës, Rustem Rustemi.
22. Propozim-Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale 555-0 ZK. Balaj, pronë private.
23. Propozim- Vendim për pezullimin e vendimeve 48, 49, 50, 51, 52, 53, 56 të datës 30.05.2025.
24. Propozim- Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit me nr.109 të datës 30.09.2019.

NË LËMINË E SHPRONËSIMEVE bëjnë pjesë lëndët të cilat janë në Gjykatën Themelore në Ferizaj kundër vendimeve përfundimtare të shpronësimit, respektivisht për rritjen e shpërblimit për tokat e shpronësuara, si dhe lëndët të cilat janë në proces vlerësimi në Ministrinë e Financave (MF).

DEKLARATA PËR FALJE

1. Deklaratë për falje nga Mehmet Sejdiu nga fsh. Jezerc e fal ngastrën kadastrale 333-3 ZK. Papaz me sip. 33 m².
2. Deklaratë për falje nga Nehat Rekaj etj. nga Fshati i Vjetër ZK. Fshati i Vjetër me sip. 103 m², ng.kad. 546-8 ZK. Fshati i Vjetër me sip. 831 m², ng.kad. 545-2 ZK. Fshati i Vjetër me sip. 13 m², ng.kad. 546-6 ZK. Fshati i Vjetër me sip. 89 m².
3. Deklaratë për falje nga Sokol Jetullahi nga fsh. Rahovicë e fal ngastrën kadastrale 232-2 ZK. Rahovicë me sip. 338 m².
4. Deklaratë për falje nga Hysen Meha etj. nga fsh. Lloshkobare e fal ngastrën kadastrale 816-14 ZK. Lloshkobare me sip. 1678 m².
5. Deklaratë për falje nga Flamur Sadiku Ferizaj e fal pjesën e ngastrës kadastrale 418-3 ZK. Rahovic me sip. 7 m².
6. Deklaratë për falje nga Afrim Selimi nga fsh. Burrnik e fal ngastrën kadastrale 694-11 ZK. Burrnik me sip. 436 m².
7. Deklaratë për falje nga Fatmir Kuqi me autorizim, Afet Kuqi, Tushe Kuqi dhe Haki Hasani nga Ferizaj e falin ngastrat kadastrale 24-23 ZK. Fshati Vjetër me sip. 140 m², dhe 24-26 ZK. Fshati Vjetër me sip. 142 m²,
8. Deklaratë për falje nga Faton Nuredini dhe Jeton Nuredini nga fsh. Komogllavë e falin ngastrën kadastrale 1627-5 ZK. Papaz me sip. 68 m².
9. Deklaratë për falje nga Shefki Hajdini nga fsh. Prelez i Jerlivee fal ngastrën kadastrale 227-2 ZK. Papaz me sip. 119 m².
10. Deklaratë për falje nga Arben Xhema dhe Elfete Xhema nga fsh. Tërrn e fal ngastrën kadastrale 3575-14 ZK. Jezerc me sip. 70 m².
11. Deklaratë për falje nga Fadil Kurtaliqui, etj. nga fsh. Pleshinë e fal ngastrën kadastrale 1187-2 ZK. Pleshinë me sip. 22 m² dhe ng.kad. 2211-3 ZK. Pleshinë 23 m².
12. Deklaratë për falje nga Fazli Osmani nga fsh. Jezerc e fal ngastrën kadastrale 922-5 ZK. Jezerc me sip. 418 m².
13. Deklaratë për falje nga Nexhat Misini nga fsh. Rahovicë e fal ngastrën kadastrale 2316-7 ZK. Rahovicë me sip. 330 m².
14. Deklaratë për falje nga Elmi Ramusholli etj nga fsh. Manastirc e fal ngastrën kadastrale 23-10 ZK. Manastirc me sip. 228 m², dhe ng.kad 24-2 ZK. Manastirc me sip 290 m².
15. Deklaratë për falje nga Izet Meha etj nga fsh. Lloshkobare e fal ngastrën kadastrale 826-1 ZK. Lloshkobare me sip. 101 m².
16. Deklaratë për falje nga Ilaz Berisha nga fsh. Mirosalë e fal ngastrën kadastrale 756-3 ZK. Mirosalë me sip. 432 m².
17. Deklaratë për falje nga Resul Lika nga Fshati i Vjetër e fal ngastrën kadastrale 680-32 ZK. Papaz me sip. 1993 m².
18. Deklaratë për falje nga Selim Ajeti nga fsh. Burrnik e fal ngastrën kadastrale 223-7 ZK. Burrnik me sip. 164 m².
19. Deklaratë për falje nga Besim Mehmeti nga fsh. Jezerc e fal ngastrën kadastrale 3600-10 ZK. Jezerc me sip. 440 m².
20. Deklaratë për falje nga Nazmi Hajdari nga fsh. Jezerc e fal ngastrën kadastrale 3589-5 ZK. Jezerc me sip. 274 m².
21. Deklaratë për falje nga Nazmi Hajdari etj nga fsh. Jezerc i falin pjesët e ngastrave kadastrale 3797-6 me sip. 470 m², 3797-1 me sip 363 m², 2890-0 me sip. 810 m², 3676-3

- me sip. 2540 m², 2914-1 me sip. 417 m², 3676-13 me sip. 297 m², 3676-14 me sip. 271 m², 3676-5 me sip. 81 m², 3676-6 me sip. 19 m², 3676-4 me sip. 376 m², 3676-1 me sip. 761 m² dhe 3697-8 me sip. 862 m² ZK. Jezerc.
22. Deklaratë për falje nga Isa Hasani etj. nga fsh. Ferizaj e fal ngastrën kadastrale 894-9 ZK. Ferizaj me sip. 85 m².
23. Deklaratë për falje nga Afrim Matoshi nga fsh. Nikadin e fal ngastrën kadastrale 130-14 ZK. Nikadin me sip. 199 m².
24. Deklaratë për falje nga Bahri Xhemajli nga fsh. Talinoc i Jerlive e fal ngastrën kadastrale 1002-1 ZK. T i Jerlive me sip. 242 m².
25. Deklaratë për falje nga Shaban Omura etj nga fsh. Greme i falin pjesët e ngastrave kadastrale 1544-1 me sip. 84 m², 1544-2 me sip.80 m², 1544-3 me sip. 70 m², 1579-0 me sip. 4 m², 1760-1 me sip. 24 m², 1760-2 me sip. 24 m², 1761-0 me sip. 19 m², 1762-0 me sip. 29 m², 1763-0 me sip. 27 m², 1543-0 me sip. 42 m², 1542-0 me sip. 62 m², 1540-1 me sip. 219 m², 1541-1 me sip. 308 ZK. Greme.
26. Deklaratë për falje nga Ajete Veliu etj. nga fsh. Burtnik e fal ngastrën kadastrale 498-2 me sip. 193 m², 552-2 me sip. 251 m², 484-10 me sip. 155 m², 827-4 me sip. 33 m², 827-5 me sip. 183 m², 553-2 me sip. 161 m², 828-12 me sip. 55 m², 828-14 me sip. 119 m², 828-16 me sip. 104 m², 828-18 me sip. 74 m², 829-6 me sip. 26 m², 829-8 me sip. 66 m² dhe 829-10 me sip. 422 m² ZK. Burtnik.
27. Deklaratë për falje nga Egzon Fetahu nga fsh. Talinoc i Muhaxherëve e fal ngastrën kadastrale 416-1 ZK. Rahovicë me sip. 61 m².
28. Deklaratë për falje nga Valdrin Bajrami nga fsh. Zaskok e fal ngastrën kadastrale 30-1 ZK. Zaskok me sip. 561 m².
29. Deklaratë për falje nga Luan Zenku etj nga fsh. Nikadin e fal ngastrën kadastrale 575-14 me sip. 346 dhe ng.kad. 952-6 me sip. 346 m² ZK. Nikadin.
30. Deklaratë për falje nga Rexhep Spahiu nga fsh. Dardani e fal ngastrën kadastrale 2226-2 ZK. Tankosiq me sip. 582 m².
31. Deklaratë për falje nga Rrahim Tahiri nga fsh. Lloshkobare e fal ngastrën kadastrale 905-10 ZK. Lloshkobare me sip. 176 m².
32. Deklaratë për falje nga Shaban Sejdiu etj. nga fsh. Pojatë e fal ngastrën kadastrale 10-7 ZK. Pojatë me sip. 376 m².
33. Deklaratë për falje nga Gojart Neziri nga fsh. Burtnik e fal ngastrën kadastrale 820-7 ZK. Burtnik me sip. 16 m².
34. Deklaratë për falje nga Izjadin Shala nga fsh. Mirosalë e fal ngastrën kadastrale 2192-9 ZK. Mirosalë me sip. 413 m².
35. Deklaratë për falje nga Faruk Xhemajli nga fsh. T. i Jerlive e fal ngastrën kadastrale 14-7 ZK. T. i Jerlive me sip. 65 m².
36. Deklaratë për falje nga Bekim Fetahu nga fsh. T. i Muhaxherëve e fal ngastrën kadastrale 175-1 ZK. T i Muhaxherëve me sip. 1442 m².
37. Deklaratë për falje nga Banush Neziri nga fsh. Muhoc e fal ngastrën kadastrale 772-1 ZK. Muhoc me sip. 340 m².
38. Deklaratë për falje nga Fadil Obrazhda etj. nga fsh. Sojevë i falin pjesët e ngastrave kadastrale 29-0 me sip. 256, ng.kad 30-0 me sip. 434 m², ng.kad. 31-0 me sip. 444 m², ng.kad 28-0 me sip. 140 m², ng.kad. 40-0 me sip. 182 m², ng.kad 46-1 me sip. 292 m², 23-1 me sip. 379 m², 2033-1 me sip. 73 m², 2033-2 me sip. 90 m², ng.kad 2051-5 me sip. 53 m², 2033-3 me sip. 77 m², 39-2 me sip. 41 m², ng.kad.34-0 me sip. 378 m², 2051-1 me sip. 107 m², 46-2 me sip.580 m² ZK. Sojevë.

39. Deklaratë për falje nga Avni Kosumi nga fsh. Burrnik e fal ngastrën kadastrale 23-2 ZK. Burrnik me sip. 1373 m².
40. Deklaratë për falje nga Shaban Murati nga fsh. Talinoc i Muhaxherëve e fal ngastrën kadastrale 904-0 ZK. T. i Muhaxherëve me sip. 578 m².
41. Deklaratë për falje nga Valon Varoshi nga Ferizaj e fal ngastrën kadastrale 27-8 ZK. Burrnik me sip. 435 m².
42. Deklaratë për falje nga Lirim Bislimi nga fsh. Muhoc e fal ngastrën kadastrale 774-3 ZK. Muhoc me sip. 776 m².
43. Deklaratë për falje nga Nagjije Sylejmani nga fsh. Rahovicë e fal ngastrën kadastrale 1950-2 ZK. Rahovicë me sip. 225 m².
44. Deklaratë për falje nga Nexhmedin Salihu nga fsh. Zaskok e fal ngastrën kadastrale 97-0 ZK. Zaskok me sip. 435 m².
45. Deklaratë për falje nga Blerim Çerkini nga fsh. Zaskok e fal ngastrën kadastrale 32-1 ZK. Zaskok me sip. 134 m² dhe 33-1 ZK. Zaskok me sip. 343 m².
46. Deklaratë për falje nga Hamdi Tershana nga Ferizaj e fal ngastrën kadastrale 929-12 ZK. Ferizaj me sip. 198 m².

Gjatë periudhës së vitit 2025 pronarët e paluajtshmërive kanë falur për rrugë gjithsej sipërfaqet prej: **32195 m² ose (3.21.95. ha).**

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Numri
1	Aktvendime për lirimin e pronave komunale	5
2	Përfaqësime në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në cilësinë e përfaqësuesit juridik	24
3	Përgjigje në padi të ushtruara në Gjykatë lidhur me shpronësime	6
4	Ankesa të ushtruara në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Ferizaj	3
5	Punë në terren me Komisionin për Dhënien e Pronave Komunale në Shfrytëzim për bizneset që operojnë në ZK Babush dhe Prelez i Muhaxherëve (raport i veçantë për këto biznese)	
6	Ankesa të shqyrtuara nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave ndaj vendimeve të Inspektoratit Komunal	8
7	Njoftime për bankë	13
8	Kontrata për blerjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e parablerjes	11
9	Deklarata-pëlqim të pronarëve se nuk kërkojnë kompensim, shpronësim apo këmbim për asfaltim të pronës	19



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E BUJQËSISË

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

Drejtoria e Bujqësisë gjatë periudhës raportuese në vazhdimësi ka zbatuar politikat sektoriale sipas:

- Strategjive zhvillimore,
- Planit të punës së drejtorisë të hartuar për vitin 2025,
- Planit Zhvillimor Komunal,
- Vendimeve të Kuvendit të Komunës dhe
- Sipas kërkesave të qytetarëve.

Ky raport ka për qëllim paraqitjen e aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Drejtoria e Bujqësisë gjatë periudhës së raportimit.

Aktivitetet e Drejtorisë gjatë kësaj periudhe janë fokusuar kryesisht në realizimin e subvencioneve dhe projekteve që kanë për qëllim mbështetjen e fermerëve, menaxhimin e tokave bujqësore, zhvillimin e blegtorisë dhe bimësisë, promovimin e produkteve vendore, trajnime dhe aktivitete informuese.

Drejtoria e Bujqësisë gjatë vitit 2025 ka zhvilluar këto aktivitete:

- 1. Furnizimi i fermerëve me serra** –Drejtoria e Bujqësisë ka zbatuar aktivitetin e furnizimit të fermerëve me serra, me qëllim rritjen e prodhimit, zgjatjen e sezonit të kultivimit dhe përmirësimin e të ardhurave të fermerëve. Me realizimin e këtij projekti janë ngritur 312 serra me sipërfaqe 50m² , në këtë projekt është përfshirë konstruksioni i serrës, folija, transporti, punët rreth vendosjes së serrës dhe sistemi i ujitjes. Interesimi i fermerëve ka qenë shumë i madh për këtë projekt. Drejtoria ka ndjekur procesin e shpërndarjes dhe instalimit të serrave, si dhe ka ofruar këshillim teknik për përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Ky aktivitet ka pasur ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonave rurale dhe në forcimin e kapaciteteve prodhuese të fermerëve.
- 2. Furnizimi i fermerëve me fidane të mjedrës, folie dhe sistem të ujitjes-** Është realizuar aktiviteti i i furnizimit të fermerëve me fidane të mjedrës, foli dhe sistem të ujitjes, me qëllim nxitjen e kultivimit të kulturave me vlerë të shtuar dhe rritjen e prodhimit bujqësor. Këtë vit Drejtoria e Bujqësisë ka përkrahur 8 fermerë me nga 0.25 ha për ngritjen e pemishteve me mjedra, foli dhe sistem të ujitjes. Furnizimi me fidanë cilësor të mjedrës ka ndikuar në krijimin e plantacioneve të reja ndërsa përdorimi i folisë dhe sistemit të ujitjes ka ndihmuar në rritjen e rendimentit të prodhimit, uljen e kostove të prodhimit, përmirësimin e cilësisë së produktit dhe përdorimin racional të ujit.

3. Furnizimi me pajisje i fermerëve kultivues të pemëve - Gjatë periudhës së raportimit, Drejtoria e Bujqësisë ka realizuar aktivitetin e furnizimit të fermerëve kultivues të pemëve me mulçera dhe spërkatëse profesionale, me qëllim rritjen e efikasitetit të punimeve bujqësore, përmirësimin e menaxhimit të sipërfaqeve të kultivuara dhe garantimin e trajtimeve fitosanitare cilësore. Përdorimi i mulçerave ka ndihmuar në mirëmbajtjen e sipërfaqeve ndërmjet rreshtave, përmirësimin e strukturës së tokës, uljen e barërave të këqija dhe kostove të punës, ndërsa furnizimi me spërkatëse profesionale ka kontribuar në aplikimin e saktë dhe të kontrolluar të produkteve fitosanitare, rritjen e sigurisë ushqimore, mbrojtjen e shëndetit të fermerëve dhe mjedisit. Me këtë projekt janë furnizuar 23 fermerë me spërkatëse profesionale dhe 33 fermerë me mulçera.

4. Furnizimi i fermerëve me mekanizëm për ngritjen e kapaciteteve funksionale të tyre

Drejtoria e Bujqësisë ka realizuar aktivitetin e furnizimit të fermerëve me mekanizëm dhe mjete të specializuara, me qëllim ngritjen e kapaciteteve funksionale të tyre dhe përmirësimin e efijencës në prodhimin bujqësor. Ky aktivitet ka synuar modernizimin e mënyrës së punës dhe reduktimin e kostove operative, rritjen e produktivitetit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore si dhe përmirësimin e menaxhimit të sipërfaqeve bujqësore dhe burimeve të përdorura. Me realizimin e këtij projekti janë përfitues 66 fermerë me këto pajisje: 1. Atomizerë, 2. Mihëse të misrit, 3. Makinë mbjellëse të grurit me frezim, 4. Freza me sensorë për pemishte. Ky aktivitet ka kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të fermerëve dhe rritjen e kapaciteteve funksionale të tyre në sektorin bujqësor.

5. Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor – Ky projekt është zhvilluar në kuadër të mbështetjes për fermerët me qëllim rritjen e kapaciteteve prodhuese, modernizimin e praktikave bujqësore dhe përmirësimin e efijencës së punës në fermë. Këto pajisje kanë kontribuar në rritjen e rendimentit bujqësor, uljen e kostove operative për fermerë, përmirësimin e menaxhimit të tokës dhe resurseve natyrore. Janë furnizuar 185 fermerë me këto pajisje: 1. Freza 1.6, 2. Spërkatëse 3. Pllugj 2 rendësh, 4. Roto kosa, 5. Shpërndarëse plehu, 6. Nxjerrëse të patateve dy rendore, 7. Mbjellëse dy rendore të patateve, 8. Grabuja diellore, 9. Trina 4 krahëshe.

6. Furnizimi i tetë pikave me ushqim dhe ujë të pijes për qentë endacak – Ky aktivitet ka për qëllim përmirësimin e mirëqenies së qenve endacak dhe reduktimin e rrezikut për shëndetin publik. Përmes furnizimit të rregullt, u siguroi që kafshët të kenë qasje të vazhdueshme në ushqim dhe ujë të pastër. Ky aktivitet që realizohet në tetë pika ushqyese ka pasur ndikim pozitiv në përmirësimin e mirëqenies së qenve endacak, zvogëlimin e rrezikut për shëndetin e qytetarëve.

- 7. Fushatë vetëdijësuese sjellja dhe kujdesi ndaj qenve endacak** - Është iniciativë shumë e rëndësishme për përmirësimin e kushteve të jetesës së këtyre kafshëve dhe për promovimin e një shoqërie më humane dhe përgjegjëse. Duke e parë rrezikun e qenve endacak që paraqesin për jetën e qytetarëve e sidomos fëmijëve që shkojnë në shkollë, Drejtoria e Bujqësisë ka realizuar këtë projekt duke dhënë këshilla në shkollat e Komunës së Ferizajt dhe ka bërë përgatitjen dhe shpërndarjen e fletushkave se si të sillemi me qentë endacak.
- 8. Organizimi i trajnimeve për fermerët në lëmi të ndryshme** – Është hap i rëndësishëm për përmirësimin e aftësive dhe njohurive të fermerëve që mund të ndikojnë pozitivisht në rritjen e rendimentit dhe qëndrueshmërinë e bujqësisë. Gjatë implementimit të këtij projekti janë organizuar trajnime në lëmi të ndryshme të bujqësisë, janë mbajtur trajnime teorike, praktike dhe vizita në terren.
- 9. Mbarësimi artificial i lopëve qumështore dhe mështjerrave, rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrrave tek lopët qumështore, vaksinimi i gjedheve dhe bagëtive të imëta kundër sëmundjeve clostridiale si dhe repelimi i gjedheve dhe bagëtive të imëta** – Ky projekt ka për qëllim përmirësimin e shëndetit dhe rendimentit të lopëve qumështore dhe bagëtive të imëta përmes praktikave të avancuara të mbarësisit artificial, kujdesit për thundrat, vaksinimit kundër sëmundjeve clostridiale dhe përdorimit të repelentëve për parandalimin e infeksioneve nga parazitët dhe insektet. Që ferma të jetë rentabile, përveç ushqimit të mirë, patjetër që duhet të investohet në përzgjedhjen e drejtë të racës së kafshës me këtë mundësohet kontrolli i sëmundjeve infektive dhe trajtimi i problemit të fertilitetit të ulët. Me material gjenetik janë mbarësuar 10302 lopë dhe mështjerra. Vaksinimi i fondit blegtoral është bërë në fermat komerciale dhe gjysmë komerciale si masë preventive kundër sëmundjeve infektive (sëmundjeve clostridiale), është bërë tek gjedhet, delet dhe dhitë. Janë vaksinuar 3748 krerë gjedhe (lopë qumështore, mështjerra dhe viqa) dhe 10974 bagëti të imëta (dele, qingja, dhi e keca).
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrave tek lopët qumështore - Sëmundjet e thundrave ndikojnë në shëndetin dhe prodhimtarinë blegtorale ku vjen deri te rënia e prodhimtarisë e njëherit edhe te humbjet ekonomike në ferma. Është bërë rregullimi i thundrave në 2140 krerë lopë qumështore dhe mështjerra.
- 10. Trajtimi i qenve endacak** - Drejtoria e Bujqësisë u angazhua në një iniciativë për trajtimin e qenve endacak përmes metodës KSVL, kjo metodë ka për qëllim të kontrolloj numrin e qenve endacak në mënyrë humane, duke parandaluar rritjen e popullatës së tyre dhe duke ofruar kushte më të mira për mirëqenien e kafshëve. Ky projekt është duke u realizuar duke pasur parasysh kërkesat e shumta nga ana e qytetarëve për qentë endacak dhe rrezikun që paraqesin për jetën e qytetarëve e sidomos fëmijëve që shkojnë në shkollë. Drejtoria e Bujqësisë përmes KSVL-së do të bëjë 600 trajtime të qenve endacak në bazë të kontratës së nënshkruar.

11. Furnizimi i fermerëve kultivues të pemëve apo perimeve me gypa dhe pajisje përcjellëse për ujitje– Ky projekt ka për qëllim përmirësimin e eficiencës së përdorimit të ujit dhe në fermat bujqësore. Përdorimi i sistemeve të ujitjes me gypa dhe pajisjeve të tjera përkatëse mundëson një menaxhim më të mirë të burimeve ujore, duke ulur humbjet dhe duke rritur rendimentin e kultivimeve. Me këtë projekt u përkrahen fermerët kultivues të pemëve apo perimeve me gypa dhe pajisje përcjellëse për ujitje. U përkrahën gjithsej 29 fermerë, 12 prej tyre përfituan pompë uji që furnizohen nga lumi dhe gyp përcjellës 3350 metër gjatësi dhe 17 fermerë përfituan pompë zhytëse që furnizohen nga puset dhe gyp përcjellës 5250 metër gjatësi.

12. Furnizimi i fermerëve me pajisje për mbjelljen e farave të perimeve ose luleve – Ky projekt ka për qëllim të rris efikasitetin dhe prodhimin e kulturave të perimeve dhe luleve përmes përdorimit të pajisjeve moderne që mundësojnë mbjellje më të shpejt, më të saktë dhe me shpenzime më të ulëta, duke minimizuar gabimet dhe humbjet. Përfitues të këtij projekti janë 8 fermerë me nga një pajisje për mbjelljen e farave të perimeve ose luleve, pajisje kjo që do t’ua lehtësoj veprimtarinë e tyre.

13. Furnizimi i bletarëve me bletë, ushqyese dhe pajisje mbrojtëse nga kafshët e egra – Ky projekt ka për qëllim mbështetjen e bletarëve për të përmirësuar prodhimin e mjaltit dhe rritjen e qëndrueshmërisë së bletishteve, duke siguruar materialet dhe mjetet e nevojshme për mbrojtjen e bletëve dhe përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës. Janë përkrahur 20 bletarë me pajisje si masë e rëndësishme e mbrojtjes së bletishteve nga kafshët e egra si dhe 40 bletarë kanë përfituar koshere me bletë dhe ushqyese.

14. Furnizimi bletarëve me pajisje për bletë – Ky projekt ka kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e procesit të punës dhe në rritjen e prodhimit të mjaltës, sepse çdo pajisje ka rol të rëndësishëm në procesin e mirëmbajtjes së bletëve dhe në përpunimin higjienik të mjaltit. Në këtë projekt kanë përfituar 73 bletarë bazamente plastike për koshere dhe 13 bletarë kanë përfituar pajisje speciale për shkrirjen e dyllit.

15. Marrëveshje Bashkëpunimi me NPL Ambienti Sh.A

Gjatë vitit 2025, NPL “Ambienti”, në kuadër të kësaj marrëveshje prej Drejtorisë së Bujqësisë ka përfituar: 2 Traktora Ivol 50HP, mulçerë hidraulike, cisternë të ujit 3000l, makinë vetëlëvizëse e rrugës, 4 pajisje automatike për ushqim të qenve, kositëse me traktor me 4 rrota, 2 rimorkio 4 ton.

Përveç projekteve të cekura në Drejtorinë e Bujqësisë janë kryer edhe këto aktivitete:

- Aplikimi i fermerëve për subvencione nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ky aplikim është kryer në zyrat e Drejtorisë së Bujqësisë, ishte një punë shumë voluminoze ku ishte angazhuar i tërë stafi i Drejtorisë së Bujqësisë në kryerjen e këtyre punëve:

- Shpallja e njoftimeve për aplikim për subvencione,
- Kontrollimi dhe pranimi i dokumenteve,
- Regjistrimi në Regjistrin e Fermës,
- Digjitalizimi i parcelave në ELPIS,
- Aplikimi online për të gjitha subvencionet në EFR.

Gjatë vitit 2025 për subvencionet nga MBPZHR në Drejtorinë e Bujqësisë kanë aplikuar gjithsej 1230 fermerë për këto subvencione: lopë 1979 krerë, mëshqerra 197, dele 8977 krerë, dhi 540 krerë, pula 107500 copë, bletë 10135, grurë 4699.88 ha, misër 2276.07 ha, elbi 17.01 ha, thekra 23.51 ha, molla 38.65 ha, kumbulla, 17.01 ha, aronija 2.89 ha, mjedra 4.2 ha, arra 80.32 ha, vishnje 2.38 ha, lajthia 33.77 ha, patate 22.75 ha, kunguj 19.52 ha, qepë 10.87 ha, shalqin 7.47 ha, lakra 9.41 ha, tërshërë 82.15 ha, kunguj të misirit 5.68 ha, dredhëza 0.22 ha, fasule 91.48 ha, marulla 1.61 ha, speci 16.02 ha, dardha 0.5 ha, bimë mjekësore dhe aromatike 12.96 ha, perime në serra 3.6 ha, qershia 6.61 ha, material fidanor 534080 copë, dhe luledielli 129.59 ha.

Në Drejtorinë e Bujqësisë janë bërë:

- Pagesat për të gjitha subvencionet dhe projektet e realizuara,
- Pagesat për të gjitha kategoritë e shërbimeve dhe mallrave,
- Janë bërë raportet mujore dhe gjashtëmujore për faturat e papaguara,
- Planet dhe raportet e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore,
- Janë bërë përgatitjet për korrje-shirje dhe raportet e korrje shirjeve,
- Kemi bërë edhe vlerësimin e dëmeve sipas kërkesave të fermerëve që kompensohen nga Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave,
- Janë organizuar trajnime të rregullta me fermerë në bashkëpunim me MBPZHR – Departamentin e Shërbimeve Këshillimore.
- Jemi të përfshirë në komisionin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,
- Janë pajisur fermerët me vërtetime si prodhues bujqësor për nevoja të tyre personale,
- Të gjitha kërkesat që i janë drejtuar kësaj Drejtorie janë shqyrtuar dhe janë zgjedhur konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2025

1. HYRJE

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në kuadër të fushë veprimtarisë së vetë ka sektorin e shërbimeve publike dhe sektorin e emergjencave.

Sektori i shërbimeve publike mbulon aktivitete që ndërlidhen me mirëmbajtjen e hapësirave publike si mirëmbajtja e rrugëve me asfalt, me zhavorr, riparimin e trotuareve, pastaj mirëmbajtja e rrugëve me shenja të komunikacionit si ato horizontale dhe vertikale, mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara si sheshet, menaxhimi i mbeturinave, parqet, drunjtë dekorativ, mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik si dhe zgjerimin e tij aty ku paraqiten nevojat sipas mundësive buxhetore, pastaj mbarëvajtjen e komunikacionit rrugor dhe atij të mallrave, mirëmbajtjen e infrastrukturës nëntokësore si rrjeti i kanalizimit atmosferik dhe atij fekal, rrjetin e ujësjellësit etj., çdo herë në koordinim edhe me ndërmarrjet publike për detyrat dhe obligimet që ato i kanë ndaj qytetarëve të përcaktuara me ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në të cilin përcaktohen dhe rregullohen detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, Komuna në territorin e saj organizon mbrojtjen nga zjarri, kujdeset për zbatimin, përparimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore si vërshimet, rrëshqitjet e dheut apo erërat, si dhe fatkeqësi tjera natyrore që mund të ndodhin në Komunën e Ferizajt.

Në të njëjtën kohë, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë zhvillon aktivitete për shënimin e datave të rëndësishme mjedisore si dhe dekorimin e qytetit për festat e fund vitit dhe festave tjera zyrtare.

Gjatë vitit 2025 janë pranuar 1434 kërkesa nga zyra pritëse të adresuara nga qytetarët për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, pas shqyrtimeve të gjitha janë shpërndarë tek zyrtarët përkatës të Drejtorisë të cilat pas verifikimeve në terren disa prej tyre janë miratuar disa janë refuzuar e disa janë në proces.

Kërkesa të pranuar	Kërkesa të miratuara	Kërkesa të refuzuara, anuluar	Kërkesa në proces, pezulluara, ceduar
1434	1188	236	10

2.SEKTORI I EMERGJENCAVE

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në të cilin përcaktohen dhe rregullohen detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore, stafi i sektorit të emergjencave është munduar që të përmbush këto obligime që dalin nga ligji duke kryer këto detyra në terren që lidhen me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve.

- Gjatë këtij viti kemi pranuar kërkesa të natyrave të ndryshme, ku të gjitha janë shqyrtuar.
- Mbikëqyrja e kryerjes së punëve në pastrimin e rrugëve të qytetit dhe fshatrave gjatë sezonit dimëror dhe veror ku për këtë qëllim të kontraktuara janë operatorë ekonomik privat dhe publik.
- Vendosja, si dhe mirëmbajtja e hidrantëve mbitokësore dhe nëntokësore nëpër lokacione të ndryshme si në zona të ndryshme të qytetit po ashtu edhe në zona të ndryshme të fshatrave.
- Menaxhimi-shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore si reshjet e shiut, borës, erërave dhe rastet e zjarreve në bashkëpunim me Policinë, zjarrfikësit, kompanitë publike.

2.1 Hapja dhe pastrimi i kanaleve ujore dhe shtretërve të lumenjve

Me qëllim mirëmbajtjen e shtretërve të lumenjve, kanaleve ujore dhe rregullimi i argjinaturave për të eliminuar vërshimet gjatë reshjeve janë hapur 1.433m¹ gjatësi të kanaleve dhe shtretërve të lumenjve dhe janë eliminuar 20m³ të shkurreve dhe drunjve.

Me qëllim të eliminimit të vërshimeve është intervenuar në këto fshatra: Nikadin, Varosh, Gaçkë, Tërrn, Koshare, Fshat i Vjetër, Sojevë.

2.2 Raste zjarri, shiu, vërshime, erëra, për të cilat qytetarët kanë bërë kërkesa për dalje në vendngjarje

Në bazë të kërkesave të qytetarëve që i janë shkaktuar dëme nga të reshurat e shiut, breshëri, si dhe erërat e forta që kanë ndodhur gjatë vitit 2025 janë: njëzet e gjashtë raste (26) kërkesa për kompensim të dëmeve në ekonomitë familjare dhe biznese. Vendet që më së shumti pësuan dëme si pasojë e reshjeve të dendura të shiut janë: Ferizaj – qytet, fshatrat: Nikadin, Koshare, Sojevë, Prelez i Jerlive, Muhoc, Fshat i Vjetër etj.

Duhet potencuar se stafi i emergjencave në kuadër të Drejtorisë, pas pranimi të kërkesave nga qytetarët për dalje në vendngjarje për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri ka verifikuar duke dalë në teren – në vendin e ngjarjes, ku gjatë vitit 2025 kemi pasur 10 raste nga zjarri, duke përfshirë: raste zjarri në ekonomi familjare dhe në biznese të ndryshme, po ashtu kemi pasur 3 raste të kërkesave nga qytetarët për konstatime të gjendjes të krijuar nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera.

2.3 Ndërtimi i hidrantëve dhe mirëmbajtja e tyre

Në bazë të planifikimeve për këtë vit, kemi realizuar këto projekte në ndërtimin e hidrantëve dhe testimi i tyre, riparimi dhe mirëmbajtja e hidrantëve ekzistues, janë testuar dhe riparuar nëpër qytet dhe fshatra të Komunës së Ferizajt.

3. SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në kuadër të shërbimeve publike janë zhvilluar një numër i madh aktiviteteve të cilat drejtpërdrejt kanë prekur interesat e qytetarëve si në riparimin e kanalizimeve, ujësjellësve, mirëmbajtjen e rrugëve me zhavorr, asfalt dhe mirëmbajtjen e trotuareve.

Duke u nisur edhe nga kërkesat e qytetarëve dhe gjendjes në terren janë realizuar këto punë dhe aktivitete.

Gjatë vitit 2025, kemi pranuar kërkesa të ndryshme kryesisht nga pjesët rurale dhe nga pjesa urbane të cilat kanë të bëjnë më së shumti me riparime të rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza, dhe kyçje të reja, si dhe meremetimin-mirëmbajtjen e rrugëve me zhavorr.

Gjatë vitit 2025 kemi kryer shumë raste aty ku ka pas mundësi për de bllokime në bashkëpunim me kompaninë KRU „Bifurkacioni” kemi bërë de bllokimin e rrjeteve, kurse pjesët ku ka qenë nevoja për ndërrimin e gypave dhe kyçje të reja i kemi kryer si në shënimet në vijim:

3.1 Riparimi i rrjetit të kanalizimit

Gjatë vitit 2025 kemi pranuar një numër të madh të kërkesave dhe ankesave që lidhen me rrjetin e kanalizimeve atmosferike dhe fekale, andaj pas verifikimit të tyre në terren dhe konstatimit se janë jashtë funksionit për të cilin janë të dedikuara kemi ndërmarr masa për të riparuar apo edhe instaluar në gjatësi të caktuara rrjet të kanalizimit fekale në zonat urbane dhe rurale të komunës.

Gjatësia e riparimeve dhe instalimeve të këtij rrjeti të kanalizimeve arrin 8,632m¹.

Gjatësia e riparimeve të rrjetit të ujësjellësit arrin 392m¹.

3.2 Riparimi i rrugëve me asfalt dhe zhavorr, riparimi i trotuareve

Gjithashtu për të përmirësuar infrastrukturën rrugore sektori i shërbimeve publike ka kryer një numër të madh të aktiviteteve duke u nisur nga gjendja në terren dhe kërkesat e qytetarëve. Pas daljes në terren dhe verifikimit të gjendjes nga zyrtarët e shërbimeve publike e duke u dhënë prioritet rasteve më emergjente si dhe duke pasur parasysh kufizimet buxhetore janë riparuar, mbi 257.34m² të trotuareve me kubëza, si dhe 52,340m² të rrugëve me zhavorr, riparimi me rrugëve me asfalt 15,230.00m².

3.3 Rregullimi i pusetave të kanalizimit fekal, dhe pastrimi i gypave të ujërave atmosferik

Gjatë vitit 2025 kemi pranuar një numër të madh të kërkesave dhe ankesave që lidhen me rrjetin e ujërave atmosferik dhe rregullimin e pusetave të kanalizimit fekal, andaj pas verifikimit të tyre në terren dhe konstatimit se janë jashtë funksionit për të cilin janë të dedikuar kemi ndërmarr masa për të riparuar apo edhe pastruar gypat e ujërave atmosferike, në gjatësi dhe rregullimin e pusetave të kanalizimit fekal, në zonat urbane dhe rurale të komunës.

Gjatësia e pastrimit të gypave të kanalizimit atmosferik të gjitha profileve, arrin 399 m¹

Pastrimi i pusetave të kanalizimit atmosferik, janë në sasi prej 21 copë

Pastrimi i ujëmbledhësve, janë në sasi prej 29 copë

Montimi i kapakëve të metalit, janë në sasi prej 17 copë

Montimi i kapakëve me grila për ujëmbledhës, janë në sasi prej 1 copë.

4 NJËSIA E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE DHE AMBIENTIT

Me qëllim të krijimit dhe ruajtjes së një ambienti sa më të pastër dhe të shëndetshëm, si dhe largimit sistematik të mbeturinave nga hapësirat publike, janë realizuar një numër i konsiderueshëm aktiviteteve të ndryshme në funksion të mbrojtjes, mirëmbajtjes dhe pastrimit të mjedisit. Këto aktivitete janë zhvilluar si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, duke synuar përfshirjen e gjerë të komunitetit dhe ngritjen e vetëdijes qytetare për rëndësinë e ruajtjes së ambientit.

Në kuadër të këtyre angazhimeve është realizuar gjithashtu mirëmbajtja e rregullt e hapësirave gjelbëruese, mbjellja dhe mirëmbajtja e drunjve dekorativ, si dhe mbjellja dhe përkujdesja për lulet pranverore dhe vjeshtore, me qëllim të përmirësimit të estetikës urbane dhe cilësisë së jetesës.

Po ashtu, janë shënuar data të rëndësishme që lidhen me mjedisin, ambientin dhe pastrimin, përmes aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe edukative.

Njëkohësisht, është punuar në zhvillimin e kapaciteteve në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave, me synim forcimin e mekanizmave institucional dhe rritjen e efikasitetit në trajtimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve. Këto veprime përfaqësojnë një qasje të koordinuar dhe afatgjatë drejt përmirësimit të kushteve mjedisore dhe promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

4.1 Identifikimi dhe largimi i deponive ilegale

Gjatë periudhës raportuese është realizuar identifikimi sistematik i deponive ilegale të mbeturinave, duke përfshirë mbeturinat nga amvisëria, mbeturinat ndërtimore/inerte, mbeturinat industriale dhe të rrezikshme, mbeturinat e vëllimshme, si dhe mbeturinat e përziera. Në lokacione të ndryshme urbane të qytetit janë ndërmarrë veprime të vazhdueshme për largimin e mbeturinave të vëllimshme, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e pamjes, funksionalitetit dhe sigurisë së hapësirave publike përreth.

4.2 Shënimi i datave me rëndësi mjedisore

Në funksion të rritjes së vetëdijes qytetare dhe promovimit të mbrojtjes së mjedisit, janë organizuar aktivitete me rastin e shënimit të datave me rëndësi mjedisore dhe ekologjike, si: Dita e Pranverës, Dita e Tokës, Dita Botërore e Mjedisit, Dita e Pastrimit, si dhe data të tjera relevante në fushën e mbrojtjes së ambientit.

4.3 Plani për Menaxhimin e Integruar Ndër komunal të Mbeturinave

Në bashkëpunim me GIZ-in gjerman është përfunduar hartimi i Planit për Menaxhimin e Integruar Ndër komunal të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt. Dokumenti është prezantuar dhe miratuar në Kuvendin e Komunës, ndërsa më pas është proceduar për miratim në ministrinë përkatëse. Aktualisht, plani ndodhet në proces të shqyrtimit dhe miratimit nga niveli qendror.

4.4 Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe institucionale

Ndërmarrja Publike Lokale “Ambienti” ka realizuar mirëmbajtjen e rregullt të hapësirave në institucionet publike në qytet dhe fshatra, duke përfshirë: oborret e zyrave të gjendjes civile, qendrat e mjekësisë familjare dhe ambulancat, parqet, kopshtet e fëmijëve, bibliotekat, fushat sportive, si dhe hapësirat publike të banesave kolektive. Gjithashtu, janë ndërmarrë masa për prerjen dhe largimin e drunjve që paraqesin rrezik për sigurinë publike, rregullimin dhe mirëmbajtjen e ulëseve dhe shportave të mbeturinave, si dhe vendosjen dhe zëvendësimin e flamujve në hapësira publike.

4.5 Pastrimi, gjelbërimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike

Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastërtia”, si dhe kontraktori privat, kanë realizuar pastrimin, larjen dhe mirëmbajtjen e rregullt të rrugëve, rreth rrotullimeve, nënkalimeve për automjete dhe këmbësorë, trotuareve, shtigjeve për biçikleta, parqeve dhe shesheve publike. Gjithashtu, është kryer mirëmbajtja e hapësirës së Varrezave të Dëshmorëve. Në kuadër të këtyre aktiviteteve është realizuar edhe mirëmbajtja e lapidarëve, si dhe zëvendësimi i flamujve në lokacionet përkatëse.

Po ashtu, janë zhvilluar aktivitete të rregullta të krasitjes së drunjve dekorativ, zëvendësimit të drunjve të dëmtuar dhe mbjelljes së drunjve të rinj. Me qëllim të përmirësimit të estetikës urbane dhe ngritjes së cilësisë së hapësirave publike në qytetin e Ferizajt, është realizuar edhe mbjellja e luleve pranverore dhe vjeshtore në lokacione të ndryshme të qytetit.

4.6 Mirëmbajtja e varrezave të qytetit

Gjatë vitit 2025 ka vazhduar bashkëpunimi me operatorin ekonomik për pastrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të qytetit për të gjitha komunitetet fetare (myslimane, katolike dhe ortodokse). Gjithashtu, në varrezat e qytetit në Fshatin e Vjetër është realizuar vendosja e gurëve të varreve nga materiali mermer, në përputhje me standardet dhe kriteret e përcaktuara.

4.7 Bashkëpunimi me KFOR-in Amerikan për largimin e deponive ilegale

Në bashkëpunim me KFOR-in Amerikan është realizuar identifikimi i tre deponive ilegale të mbeturinave. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Komuna ka përfituar donacion për largimin e tre deponive të mbeturinave inerte. Fillimi i aksionit për sanimin dhe rehabilitimin e këtyre deponive është planifikuar për fillimin e vitit 2026.

4.8 Ngritja e kapaciteteve profesionale

Gjatë vitit raportues është siguruar pjesëmarrja në trajnime të organizuara nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) dhe GIZ-i gjerman në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave. Trajnimet janë zhvilluar brenda dhe jashtë vendit, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale në këtë sektor strategjik.

5. NJËSIA E TRANSPORTIT DHE TRAFIKUT RRUGOR

Nga përshkrimi i detyrave zyrtare të cilat rrjedhin nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, zyrtari i lartë për komunikacion rrugor gjatë periudhës një vjeçare sipas planit të parashikuar, për këtë vit ka realizuar këto punë:

1. Transporti rrugor i udhëtarëve dhe mallrave

Transporti i udhëtarëve me autobus dhe taksi është duke u zhvilluar në një nivel të kënaqshëm, ku nga 45 fshatra sa ka Komuna e Ferizajt, 34 prej këtyre fshatrave janë të përfshira direkt në transportin e rregullt urban-periferik, kurse 9 fshatra e shfrytëzojnë transportin ndër-urban dhe një fshat është përfshirë në transportin urban, ndërsa një fshat nuk ka qasje në transport publik të udhëtarëve.

Duke pasur parasysh dinamikën e zhvillimit të Komunës në përgjithësi si dhe zhvendosjen e Stacionit të Autobusëve në një lokacion tjetër nga ai ekzistues, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë ka zhvilluar procedurën për hartimin dhe inicimin e katër linjave urbane në transportin publik të udhëtarëve dhe më datë 13.06.2025 është lëshuar në operim transporti urban në këto linja sipas këtij itinerari:

1. Linja A përfshin segmentin rrugor nga lokacioni i ri i Stacionit të Autobusëve, vazhdon nëpërmjet rrugëve “Brahim Ademi”, “Ahmet Kaçiku”, “Rexhep Bislimi” dhe rrugës nacionale (N2) dhe si destinacion përfundimtar prapë është Stacioni i Autobusëve.
2. Linja A1 përfshin segmentin rrugor nga lokacioni i ri i Stacionit të Autobusëve, vazhdon nëpërmjet rrugës nacionale (N2) Prishtinë-Ferizaj dhe rrugëve “Rexhep Bislimi”, “Ahmet Kaçiku”, “Brahim Ademi” dhe si destinacion përfundimtar prapë është Stacioni i Autobusëve.
3. Linja B përfshin segmentin rrugor nga rruga “Brahim Ademi” (Parku i Lirisë) vazhdon rrugës “Ramadan Rexhepi”, “Nënkalimi” dhe rruga “Vëllezërit Gërvalla” (te rrethi HIB) dhe anasjelltas.

4. Linja C përfshin segmentin rrugor nga rruga “Brigada 161” (Rrethi me Shqiponjë) vazhdon rrugës “Ahmet Kaçiku” dhe rrugës “Gursel dhe Bajram Sylejmani” deri te rruga e Qiraxhive dhe anasjelltas.

Në fushën e transportit urban-periferik edhe këtë vit kemi vazhduar me ndërtimin e vendndaljeve për autobusë dhe pritoreve për pritje të udhëtarëve në fshatrat Komogllavë, Balaj, Manastirc, Neredime dhe Jezerc.

2. Trafiku rrugor

Në këtë pikë është paraparë rregullimi teknik i qarkullimit në trafik, ku së bashku me njësinë e trafikut të policisë dhe komunitetin kemi analizuar disa rrugë dhe trotuare të qytetit dhe kemi bërë disa ndërhyrje dhe ndryshime konkrete të cilat janë realizuar me qëllim të lehtësimit dhe krijimit të një ambienti më të sigurt dhe më të kënaqshëm për të gjithë pjesëmarrësit në trafikun rrugor.

2.1. Nyejt (udhëkryqet) në trafik

Në këtë fushë në bashkëpunim me Drejtorin e Infrastrukturës kemi filluar realizimin e dy projekteve të përbashkëta që kanë për qëllim lehtësimin dhe sigurinë në nyejt e trafikut, praktikisht në fshatin Muhoc kemi filluar zbatimin e projektit të rregullimit të udhëkryqit që lidh rrugët “Ramadan Haziri”, “Avdulla Rexha” dhe “Hamdi Rexhepi”, nga një kryqëzim i pa-rregullt do të rregullohet në një kryqëzim ku rrjedha e qarkullimit në trafik do të zhvillohet në një rreth-rrotullim të veçantë, kurse në rreth-rrotullimin ekzistues që lidh rrugët “Naim Beka” dhe “Epopeja e Jezercit” kemi filluar një rikonstruktim të rrethit, ku në kuadër të këtij projekti është paraparë edhe ndërhyrja komplet në segmentin e rrugës deri te kryqëzimi me rrugën “Arsim Rexhepi” (rregullimi i trotuarit, një shtresë e re e asfaltit, sinjalizim komplet dhe ndriçimi), ndërsa edhe në kryqëzimin e rrugëve urbane “Driton Islami” dhe Cen Dugolli” nga një kryqëzim i pa-rregullt është rregulluar në kryqëzim, ku rrjedha e qarkullimit në trafik do të zhvillohet në rreth-rrotullim si dhe një segment i rrugës urbane “Driton Islami” është bërë ndarja fizike me skajor e shiritave të trafikut.

2.2. Shenjat e komunikacionit

Në bazë të planifikimeve për këtë vit, kemi realizuar edhe këto projekte në sinjalizimin e rrugëve me shenja horizontale dhe shenja vertikale trafikut, me qëllim të përmirësimit dhe krijimit të një ambienti më të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor.

2.2.1. Shenjat vertikale të komunikacionit:

Në rrugët e qytetit dhe fshatrave kemi bërë mirëmbajtjen dhe vendosjen e shenjave vertikale të rrezikut, urdhrave të prera dhe shenjat e lajmërimit, ku me prioritet i kemi vendosur shenjat para institucioneve arsimore dhe janë përfshirë vendosja e shenjave për kufizimin e shpejtësisë dhe atyre të paralajmërimit të prezencës së fëmijëve në ato segmente rrugore.

Udhëtreguesit në komunikacion janë vendosur thuajse në të gjithë territorin e Komunës së Ferizajt, ku rëndësi të veçantë i kemi kushtuar unazës së brendshme dhe të jashtme të qytetit, ku vlen të potencohet se me vendosjen e këtyre udhëtregueseve kemi pasur përmirësim në orientim shumë ma të mirë të qarkullimit të trafikut, meqenëse pjesëmarrësit janë paralajmëruar saktë dhe me kohë për mundësitë që i kanë për destinacionet e dëshiruara.

2.2.2. Shenjat horizontale të komunikacionit.

Gjatë vitit 2025 kemi shënuar me shenja horizontale këto rrugë urbane qytetit dhe rrugët në fshatra:

5. Rruga urbane “Driton Islami”,
6. Rruga urbane “Cen Dugolli”,
7. Rruga urbane “Brigada 161”,
8. Parkingu i tregut të kafshëve,
9. Parkingu dhe peronat në Stacionin e Autobusëve,
10. Rruga urbane “Ahmet Kaçiku”,
11. Të gjitha rrugët e asfaltuara brenda fshatit Varosh,
12. Rruga urbane “Faton Vebihu” në fshatin Prelez i Jerlive,
13. Rruga urbane “Tahir Sinani” dhe rrugë tjera.

Në këto rrugë janë aplikuar këto shënime horizontale të komunikacionit:

- Vijat gjatësore dhe tërthore,
- Vendkalimet e këmbësorëve,
- Shtigjet e biçikletave,
- Shigjetat orientuese,
- Vend-parkingjet për taksi,
- Sipërfaqe të ndryshme orientuese dhe
- Mbishkrime në rrugë (afër institucioneve arsimore).

2.2.3. Pengesat rrugore për qetësimin e komunikacionit

Në kuadër të kësaj fushe kemi bërë vendosjen e pengesave rrugore për qetësimin e komunikacionit në disa rrugë urbane të qytetit dhe në fshatra, ku prioritet i kemi dhanë rrugëve në afërsi të institucioneve edukative si dhe në ato rrugë ku ka frekuentim më të madh të fëmijëve duke analizuar edhe infrastrukturën përcjellëse.

2.2.4. Tabelat e emërtimeve të rrugëve.

Në këtë pikë, me kërkesë të Zyrës së Sistemit të Adresave kemi bërë vendosjen e të gjitha tabelave të emërimit të rrugëve në fshatrat : Burrnik, Gaçkë, Greme, Doganaj, Rakaj, Varosh dhe Nikadin si dhe në disa rrugë në zonën urbane të qytetit.

2.2.5. Vendosja e shtyllave dinamike dhe statike anti-parking sistem.

Ky projekt është paraparë të realizohet në pjesën urbane të qytetit, konkretisht në sheshin e qytetit të Ferizajt, pikërisht në çdo hyrje në sheshe të kufizohet me shtylla anti-parking sistem, me qëllim të parandalimit të lëvizjes së automjeteve të pa autorizuar. Qëllimi i realizimit i këtij projekti është siguria e përgjithshme e qytetarëve.

Në vitin 2025 janë vendosur në katër pozicione shtyllat dinamike dhe statike anti-parking sistem, praktikisht në rrugën urbane “Hamëz Jashari” para objektit të Komunës, në rrugën urbane “Shkëlzen Haradinaj”, në rrugë urbane “Wesley Clark” dhe në rrugën urbane “Tahir Sinani” te Xhamia e Madhe.

2.2.6. Vendosja e monitorëve digjital

Monitorët digjital (tabela elektronike rrugore) janë pajisje LED që përdoren për të dhënë **njoftime në kohë reale**, paralajmërime dhe **tregues orientimi** për drejtuesit e automjeteve, përdoren edhe për të dhënë mesazhe urimi apo dhe mesazhe sensibilizuese.

Në vitin 2025 kemi bërë vendosjen dhe montimin e monitorëve digjital në rrugën “Enver Topalli” dhe në rrugën “Epopeja e Jezercit”.

2.2.7. Panelet ndriçuese të trafikut për vend-kalime të këmbësorëve.

Gjatë vitit 2025 kemi bërë vendosjen dhe montimin e paneleve ndriçuese të trafikut për vend-kalime të këmbësorëve në rrugët urbane “Driton Islami”, “Ahmet Kaçiku”, “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, “Gjon Serreçi”, “Enver Topalli”, “Uran Tinova”, “Ramadan Rexhepi” si dhe në fshatin Talinoc dhe Doganaj.

3. Plotësimi i akteve ligjore

Në vitin 2025 është hartuar Rregullorja për Organizimin e Transportit Publik të Udhëtarëve me Taksi, në pajtueshmëri me Ligjin e Transportit.

6.NJËSIA E SHËRBIMIT TË ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT

Në vitin 2025 Shërbimi Zjarrfikës dhe Shpëtimit ka pasur **gjithsej 1143 dalje** të ndara në kategori intervenimesh të cilat janë paraqitura në pjesën e dytë të raportit pjesa grafike e intervenimeve.

Si sfida më të mëdha përpos intervenimeve të ndryshme që kemi marrë pjesë nga më të ndryshmet shërbimi ynë sfidë serioze që ka ndikuar drejtpërdrejt në punën tonë ka qenë numri i pamjaftueshëm i zjarrfikësve profesional.

Po ashtu, çështje me prioritet në zhvillim dhe ndikim në Shërbimin Zjarrfikës është aktivizimi i njësisë varëse zjarrfikëse në rr. “Enver Topalli”.

Realizimi i përgjithshëm i zjarreve dhe intervenime tjera nga viti 2024-2025	
NJËSIA PROFESIONALE E ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT - FERIZAJ	
Viti 2024	Viti 2025
897	1143

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera , për periudhën kohore: Janar – Dhjetor 2025 – Komuna e Ferizajt

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenime të tjera Janar-Dhjetor 2025														
2025	Nr. i përgj. i daljeve	Nr. i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr. i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar			Të vdekur			Gjithsej
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt .	Tot	
Janar	67	40	13	12	2	0	0	0	0	0	0	0	0	67
Shkurt	44	39	4	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	44
Mars	73	65	5	2	1	0	0	0	0	0	0	0	0	73
Prill	60	35	2	20	2	1	0	0	0	0	0	0	0	60
Maj	50	36	3	11	0	0	0	0	0	0	0	0	0	50
Qershor	73	52	7	13	1	0	0	0	0	0	0	1	0	73
Korrik	271	241	10	15	5	0	0	0	0	0	0	0	0	271
Gusht	189	168	14	3	4	0	0	0	0	0	0	0	0	189
Shtator	125	110	7	6	1	0	1	0	0	0	0	0	0	125
Tetor	47	21	10	7	1	8	0	0	0	0	0	0	0	47
Nëntor	79	44	10	4	3	18	0	0	0	0	0	0	0	79
Dhjetor	65	46	4	14	1	0	0	0	0	0	0	0	0	65
Gjithsej														1143